



**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT DHE KONFLIKTIT TË
INTERESIT 2021–2025
për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2025**

Shkup, mars 2026

1. Hyrje.....	5
2. Rezyme ekzekutive	6
3. FUSHA Përmbajtja	
HORIZONTALE PROKURIME PUBLIKE.....	11
4. FUSHA HORIZONTALE PUNËSIMI	17
5. SEKTORI SISTEM POLITIK	26
6. SEKTORI I GJYQËSORIT	34
7. SEKTORI ORGANET PËR ZBATIMIN E LIGJIT.....	41
8. SEKTORI I SHËNDETËSISË	51
9. SEKTORI I ARSIMIT.....	64
10. SEKTORI PËR PUNË DHE POLITIKË SOCIALE	78
11. SEKTORI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR	85
12. SEKTORI I MJEDISIT JETËSORË.....	89
13. SEKTORI I BUJQËSISË	93
14. SEKTORI I SPORTIT.....	102
15. SEKTORI PËR EKONOMI DHE BIZNES	110
16. SEKTORI I NP DHE SHA NË PRONËSI TË SHTETIT DHE NJVL.....	119
17. SEKTORI PËR MEDIA DHE SHOQËRI CIVILE	125
18. KONSTATIME PËRFUNDIMTARE.....	132
19. REKOMANDIME	140

Lista e shkurtesave

Shkurtesa	Emërtimi i plotë
AKP	Agjencia për Kadastër të Patundshmërive
AMFBZHR	Agjencia e Mbështetjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural
ACAL	Agjencia për Cilësi në Arsimin e Lartë
MALMED	Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
ARS	Agjencia për Rini dhe Sport
MS	Ministria e Sporteve
AQLI	Agjencia e Mbrojtjes të së Drejtës për Qasje të lirë në Informata me Karakter Publik
APN	Agjencia për Përkrahjen e Ndërmarrësisë
AGJPP	Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publik
BPP	Byroja për Prokurime Publike
BZHA	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
QRMV	Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
ISHB	Inspektorati Shtetërorë për Bujqësi
ISHA	Inspektorati Shtetëror i Arsimit
ISHA	Inspektorati Shtetëror Administrativ
NJVL	Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale
SHGM	Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
SHPB	Shoqata e prokurorëve publik
PPRMV	Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut
MPB	Ministria për Punë të Brendëshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MBPEU	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave
ME	Ministria e Ekonomisë
MEP	Ministria e Ekonomisë dhe Punës
MEMLP	Ministria e Energjisë, Minerave dhe Lëndëve të Para
MSHIA	Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës
MAP	Ministria e Administratës Publike
MTD	Ministria e Transformimit Dixhital
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MD	Ministria e Drejtësisë
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
MPSDR	Ministria e Politikës Sociale, e Demografisë dhe e të Rinjve
MF	Ministria e Financave
MTL	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve
MT	Ministria e Transportit
SK 2021-2025/Strategjia	Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2021-2025
Kuvendi	Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut
KEMM	Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni
DPF	Drejtorja e Policisë Financiare
DIF	Drejtorja për Intelejgencë Financiare

FSSH	Fondi i Sigurimit Shëndetësor
FSPIRMV	Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut
DD	Drejtoria e Doganave
LPKKI	Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
UGD	Universiteti “Goce Delçev” Shtip
UKLO	Universiteti “Shën Klimenti i Ohrit” – Manastir
UNT	Universiteti “Nën Tereza” në Shkup
USHIT	Universiteti për Shkenca Informatike dhe Teknologji “Shën Apostul Pali” – Ohër
KI	Këshilli i Inspektorëve
LOFOASH	Ligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Organeve të Administratës Shtetërore

1. Hyrje

Strategjia kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit 2021-2025

Në janar të vitit 2019, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Ligjin aktual për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit (në vijim: LPKKI), qëllimi kryesor i të cilit është rregullimi i masave dhe aktiviteteve për:

- parandalimin e korrupsionit gjatë ushtrimit të pushtetit, autorizimeve publike, detyrës zyrtare dhe politikës,
- parandalimin e konfliktit të interesit dhe
- parandalimin e korrupsionit gjatë kryerjes së veprimtarive me interes publik nga personat juridikë të lidhur me ushtrimin e autorizimeve publike.

Sipas LPKKI-së, institucioni kompetent për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të lidhura me parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit është Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: KSHPK), të cilit me ligj i garantohet pavarësi dhe autonomi e plotë në ushtrimin e kompetencave të tij. Brenda fushëveprimit të vet, KSHPK miraton një strategji kombëtare pesëvjeçare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, së bashku me një plan veprimi për zbatimin e tij. Strategjia kombëtare i paraqitet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në vijim: Kuvendi) për miratim.

Strategjia aktuale Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit (në vijim: Strategjia) është miratuar më 10 dhjetor 2020 për periudhën 2021–2025 dhe bazohet në një analizë paraprake të rreziqeve nga korrupsioni. Ajo është përgatitur përmes një procesi të gjerë konsultimesh, gjithëpërfshirës dhe transparent, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga sektori publik dhe privat, mediat, shoqatat dhe fondacionet qytetare, ekspertë dhe përfaqësues të organizatave relevante ndërkombëtare. Strategjia është miratuar nga Kuvendi në prill të vitit 2021. Pjesë përbërëse e Strategjisë është plani i veprimit, në të cilin janë të detajuara masat e identifikuar sipas aktiviteteve dhe indikatorëve.

Problemet dhe masat në Strategji janë sistematizuar në 2 fusha horizontale dhe 13 sektorë të cënueshëm, dhe atë:

1. Prokurimet publike – fushë horizontale
2. Punësime – fushë horizontale
3. Sistemi politik
4. Gjyqësori
5. Organet për zbatimin e ligjit
6. Shëndetësi
7. Arsimi
8. Punë dhe politikë sociale
9. Urbanizëm dhe planifikim hapësinor
10. Mjedisi jetësor
11. Bujqësi
12. Sport
13. Ekonomi dhe biznes

14. Ndërmarrje publike dhe shoqëri aksionare në pronësi të shtetit dhe të vetëqeverisjes lokale
15. Mediat dhe shoqëria civile

Sipas nenit 18 paragrafi (6) të LPKKI-së, KSHPK është e detyruar të monitorojë zbatimin e masave nga Strategjia dhe të përgatisë raporte vjetore dhe një raport përfundimtar për zbatimin e strategjisë kombëtare, dhe t'i dorëzojë ato në Kuvend jo më vonë se 31 marsi i vitit aktual për vitin paraprak.

Duke marrë parasysh faktin se Strategjia i referohet periudhës së vitetve 2021–2025, ky dokument përfaqëson Raportin përfundimtar për zbatimin e masave të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2021–2025, për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025. Raportet vjetore për të gjitha periudhat paraprake të raportimit nga miratimi i Strategjisë janë miratuar nga ana KSHPK-së dhe i janë dorëzuar Kuvendit brenda afateve ligjore dhe janë të disponueshme publikisht në faqen e internetit të KSHPK-së.

Ky raport përmban gjithsej 19 pjesë, përkatësisht: Hyrjen, Përmbledhjen ekzekutive, dy pjesë që i referohen fushave horizontale, 13 pjesë që i referohen secilit prej sektorëve të përfshirë në Strategji, si dhe nga një pjesë për përfundime dhe rekomandime. Në secilën prej këtyre pjesëve prezantohen gjetjet lidhur me realizimin e aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimt, me paraqitje të të dhënave statistikore për numrin e aktiviteteve të realizuara, si dhe analizën e tyre, së bashku me rekomandime për tejkalimin e problemeve të identifikuara.

Metodologjia

Raportet vjetore, si dhe Raporti përfundimtar për zbatimin e Strategjisë, janë përgatitur në bazë të informatave të marra nga institucionet kompetente, të cilat për çdo periudhë vlerësimi, përmes një zgjidhjeje softuerike – aplikacion ueb, dorëzonin raporte vjetore për nivelin e realizimit të aktiviteteve për të cilat ato janë caktuar si bartës të aktivitetit. Pas mbledhjes së raporteve vjetore, KSHPK ka kryer analizë dhe vlerësim të të dhënave të dorëzuara nga institucionet, pas së cilës ka përcaktuar statusin përfundimtar të të gjitha aktiviteteve të Strategjisë (të realizuara, në zhvillim e sipër ose të porealizuara).

Objekt i vlerësimit përfundimtar ishin të gjitha aktivitetet e parapara për realizim nga viti 2021 deri në vitin 2025, me një analizë gjithëpërfshirëse të aktiviteteve të vazhdueshme, të cilat janë objekt vlerësimi çdo vit nga momenti i afatit të tyre. Numri i përgjithshëm i aktiviteteve të vlerësuara për gjithë periudhën pesëvjeçare është 318.

Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 121/24) solli ndryshime në strukturën institucionale, kompetencat e organeve të administratës shtetërore dhe emërtimet e një pjese të institucioneve kompetente.

2. Rezume ekzekutive

Në kuadër të Strategjisë janë identifikuar 54 probleme kyçe, për tejkalimin e të cilave janë paraparë 111 masa dhe 191 aktivitete konkrete. Nga numri i përgjithshëm i aktiviteteve, 34 janë shënuar për realizim në kontinuitet (27 aktivitete janë shënuar me afat realizimi nga viti 2021 dhe në kontinuitet, gjashtë aktivitete nga viti 2022 dhe në kontinuitet dhe një aktivitet nga

viti 2024 dhe në kontinuitet), që do të thotë se realizimi i tyre është objekt vlerësimi çdo vit pas maturimit të afatit, përkatësisht se për periudhën e përmendur pesëvjeçare janë vlerësuar gjithsej 318 aktivitete.


Shpërndarja e **problemeve, masave dhe aktiviteteve** është si vijon:

Nr. r	Fusha/Sektori	Problemet	Masat	Aktivitete të njëherëshme	Shuma e aktiviteteve në kontinuitet	Gjithsej aktivitete të vlerësuara
1.	Prokurime publike	2	2	2	10	12
2.	Punësim	3	8	10	15	25
3.	Sistem politik	6	7	7	5	12
4.	Gjyqësorë	3	7	10	20	30
5.	Organe për zbatimin e ligjit	7	13	20	5	25
6.	Shëndetësi	5	18	25	4	29
7.	Arsim	8	18	27	34	61
8.	Punë dhe politikë sociale	1	5	8	10	18
9.	Urbanizëm dhe planifikim hapsinor	1	1	0	4	4
10.	Mjedis jetësor	1	1	2	0	2
11.	Bujqësi	5	9	15	5	20
12.	Sport	2	6	11	19	30
13.	Ekonomi dhe biznes	4	8	8	23	31
14.	NP dhe SHA	3	3	5	2	7
15.	Media dhe shoqëri civile	3	5	7	5	12
Gjithsej		54	111	157	161	318

Tabela1: Paraqitja tabelare e numrit të përgjithshëm të problemeve, masave dhe aktiviteteve sipas fushave/sektorëve në Strategji.

Numri i problemeve të identifikuar, si dhe masat dhe aktivitetet e përcaktuara sipas sektorëve, varet para së gjithash nga niveli i rrezikut të identifikuar nga korrupsioni në secilën prej fushave/sektorëve. Për më tepër, një rol të rëndësishëm në përcaktimin e masave kishte edhe përfshirja dhe kontributi i institucioneve brenda secilit sektor gjatë procesit të përgatitjes së Strategjisë në vitin 2019.


Problemet sipas **fushave/sektorëve**:



Fotografia 1: Numri i problemeve, masave dhe aktiviteteve sipas fushave/sectorëve

Rreth 40% e të gjitha masave dhe aktiviteteve i përkasin sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe organeve për zbatimin e ligjit.

Shpërndarja e **aktiviteteve sipas viteve** është si vijon:



Fotografia 2: Shpërndarja në përqindje e aktiviteteve sipas viteve

Shpërndarja e aktiviteteve sipas viteve tregon se numri më i madh i aktiviteteve për zbatim janë paraparë në vitin e parë të Strategjisë.

Shpërndarja në përqindje e aktiviteteve sipas viteve:

- 110 aktivitete (58%) ishin paraparë për vitin 2021, nga të cilat 27 janë në kontinuitet;
- 70 aktivitete (36%) ishin paraparë për vitin 2022, nga të cilat gjashtë janë në kontinuitet;
- 9 aktivitete (5%) ishin paraparë për vitin 2023;
- 2 aktivitete (1%) janë paraparë për vitin 2024, nga të cilat një është në kontinuitet; dhe
- për vitin 2025 nuk është paraparë asnjë aktivitet i ri.

Gjatë përcaktimit të afateve për realizimin e aktiviteteve, një rol të rëndësishëm patën vetë institucionet dhe pjesëmarrësit nga sektorët relevantë.

Pas kryerjes së analizës së të gjitha vlerësimeve vjetore për zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë, pasqyra sipas **fushave/sectorëve për statusin e përgjithshëm të realizimit të aktiviteteve për periudhën 2021–2025** është si vijon:

Fusha/ sektori	Aktivitete realizuara	të	Aktivitete parealizuara	të	Në zhvillim e sipër
Prokurime publike	3		3		6
Punësim	4		13		8
Sistem politik	2		6		4
Gjyqësor	21		4		5
Organe për zbatimin e ligjit	11		8		6
Shëndetësi	18		4		7
Arsim	25		14		22
Punë dhe politikë sociale	6		8		4
Urbanizëm dhe planifikim hapsinor	1		0		3
Mjedis jetësor	0		0		2
Bujqësi	6		13		1
Sport	2		18		10
Ekonomi dhe biznes	11		11		9
NP dhe SHA	1		5		1
Media dhe shoqëri civile	7		2		3
Gjithsej	118		109		91

Tabela 2: Pasqyra e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara, si dhe aktiviteteve në zhvillim e sipër në periudhën 2021-2025 sipas fushave/sectorëve



Fotografia 1. Shkalla e realizimit për periudhën 2021-2025

Shkalla e realizimit të aktiviteteve për periudhën 2021–2025. Nga gjithsej 318 aktivitete të vlerësuara në periudhën 2021–2025, 118 aktivitete janë realizuar (37%), 109 aktivitete janë të përpiluara (34%), ndërsa 91 aktivitete janë në zhvillim e sipër (29%).

3. FUSHA HORIZONTALE PROKURIME PUBLIKE

Përshkrim i fushës horizontale

Problemet prioritare në fushën horizontale prokurime publike janë:

- 1) Numër i pamjaftueshëm i personave me kualifikime adekuate dhe njohuri për standardet gjatë përcaktimit të specifikimeve teknike, si dhe kriterëve për vlerësimin e aftësisë së operatorëve ekonomikë; dhe
- 2) Transparencë e pamjaftueshme e institucioneve dhe nivel i ulët i integritetit të personave të përfshirë në zbatimin e prokurimeve publike.

Institucionet kompetente për realizimin e masave dhe aktiviteteve për tejkalimin e problemeve në fushën e prokurimeve publike janë:

- 1) Byroja për Prokurime Publike (në vijim: BPP),
- 2) Ministria e Financave (në vijim: MF) dhe
- 3) Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionin me Karakter Publik (në vijim: AQLI).

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në fushë.

Në fushën horizontale të prokurimeve publike, për tejkalimin e dy problemeve prioritare janë paraparë 2 masa dhe 4 aktivitete, nga të cilat 2 aktivitete janë njëherëshe, ndërsa 2 aktivitete janë shënuar të zbatohen në kontinuitet nga viti 2021 deri në vitin 2025, me ç'rast numri i përgjithshëm i aktiviteteve të vlerësuara për periudhën pesëvjeçare është 12. Në bazë të analizës së raporteve vjetore të zbatuara, gjendja e realizimit të aktiviteteve është si vijon:

Problemi 1: Numër i pamjaftueshëm i personave me kualifikime adekuate dhe njohuri për standardet gjatë përcaktimit të specifikimeve teknike, si dhe kriterëve për vlerësimin e aftësisë së operatorëve ekonomikë

Masaa	Aktiviteti	Institucion i përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Forcimi i kapaciteteve të personave që përgatisin dokumentacionin e tenderit	1.1. Krijimi dhe zbatimi i trajnimeve për zbatimin e standardeve gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike dhe kriterëve për vlerësimin e aftësisë, me pjesëmarrjen e Institutit për Standardizim.	BPP Institutit për Standardizim	Gjysma e dytë e vitit 2021 – në kontinuitet	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	E realizuar	E realizuar

Problemi 2: Transparencë e pamjaftueshme e institucioneve dhe nivel i ulët i integritetit të personave të përfshirë në zbatimin e prokurimeve publike

Masaa	Aktiviteti	Institucion i përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Rritja e integritetit institucional dhe transparencës në prokurimet publike.	1.1 Ndryshimi i Ligjit për prokurimet publike për përcaktimin e nënshkrimit të detyrueshëm të një deklarate për konfidencialitet nga personat që marrin pjesë në përgatitjen e specifikimit teknik.	MF BPP	Gjysma e parë e vitit 2023	E Pamaturuar	E Pamaturuar	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	1.2. Në modelet e dokumentacionit të tenderit që përgatit BPP, të përcaktohen detyrimisht personat e autorizuar për pranimin e paraqitjeve për mbrojtje të brendshme dhe të jashtme nga sinjalizuesit, në lidhje me korrupsionin në prokurimet publike.	BPP	Gjysma e dytë e vitit 2020	E realizuar	/	/	/	/

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

	1.3. Forcimi i mbikëqyrjes në lidhje me publikimin e informacioneve për prokurimet publike në përputhje me nenin 10 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik	AQLI	Gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet	E perealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
--	---	------	---	--------------------------	--------------------------------	--------------------------------	--------------------------------	--------------------------------

Për realizimin e **Problemit 1: Numër i pamjaftueshëm i personave me kualifikime të përshtatshme dhe njohuri të standardeve gjatë përcaktimit të specifikimeve teknike, si dhe të kriterëve për vlerësimin e aftësisë së operatorëve ekonomikë**, është paraparë **Masa 1: Forcimi i kapaciteteve të personave që përgatisin dokumentacionin e tenderit dhe Aktiviteti 1.1: Krijimi dhe zbatimi i trajnimeve për aplikimin e standardeve gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike dhe kriterëve për përcaktimin e aftësisë, me pjesëmarrjen e Institutit për Standardizim**, për të cilin afati i realizimit është gjysma e dytë e vitit 2021 dhe në **kontinuitet**, ndërsa institucioni përgjegjës është **BPP**. E njëjta është realizuar për vitet 2024 dhe 2025. Konkretisht, komunikimi i vendosur ndërmjet Byrosë për Prokurime Publike dhe Institutit për Standardizim në lidhje me aktivitetin e përbashkët vazhdon, pa ndryshime shtesë në politikat e standardizimit në fushën e prokurimeve publike. KSHPK rekomandon që ky bashkëpunim i vazhdueshëm ndërmjet Byrosë për Prokurime Publike dhe Institutit për Standardizim të vazhdojë edhe në të ardhmen, me qëllim ndjekjen e trendeve dhe avancimin e standardeve gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike dhe kriterëve për përcaktimin e aftësisë së operatorëve ekonomikë.

Në lidhje me **Problemin 2: Transparencë e pamjaftueshme e institucioneve dhe nivel i ulët i integritetit të personave të përfshirë në zbatimin e prokurimeve publike**, është paraparë **Masa 1: Rritja e integritetit institucional dhe transparencës në prokurimet publike**, me tre aktivitete, përkatësisht:


Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i Ligjit për Prokurime Publike për të përcaktuar nënshkrimin e detyrueshëm të një deklarate konfidencialiteti nga personat që marrin pjesë në përgatitjen e specifikimit teknik, për të cilin afati i realizimit është gjysma e parë e vitit 2023, ndërsa bartës është MF. Në vitin 2025, MF informon se ky aktivitet është “**në zhvillim e sipër**”, duke pasur parasysh se Byroja për Prokurime Publike ka ndërmarrë aktivitete në drejtim të analizës dhe identifikimit të dispozitave të Ligjit për Prokurime Publike që duhet të ndryshohen. Njëkohësisht, është ndërmarrë edhe përgatitja e formës së Deklaratës përkatëse të konfidencialitetit, e cila duhet të parashihet me ndryshimet. Rrjedhimisht, ky aktivitet ka status përfundimtar “**në zhvillim e sipër**”.

Aktiviteti 1.2: Në modelet e dokumentacionit të tenderit që i përgatit Byroja për Prokurime Publike (BPP) të përcaktohen detyrimisht personat e autorizuar për pranimin e paraqitjeve për raportim të mbrojtur të brendshëm dhe të jashtëm nga sinjalizuesit, në lidhje me korrupsionin në prokurimet publike, me afat në gjysmën e dytë të vitit 2020 dhe institucion përgjegjës BPP. Ky aktivitet është “**realizuar**” në vitin 2021, duke pasur parasysh se modeli i dokumentacionit të tenderit për procedurë të thjeshtuar të hapur është përditësuar. Konkretisht, në modelet e dokumentacioneve të tenderimit është shtuar një pjesë ku organet kontraktuese duhet të specifikojnë se cili person në institucion, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, është i autorizuar për pranimin e paraqitjeve për raportim të mbrojtur të brendshëm dhe të jashtëm nga sinjalizuesit.

Aktiviteti 1.3: Forcimi i mbikëqyrjes në lidhje me publikimin e informacionit për prokurimet publike në përputhje me nenin 10 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik. Afati për realizimin e këtij aktiviteti është **gjysma e parë e vitit 2021 në kontinuitet**, ndërsa bartës i aktivitetit është **AQLI**.


Ky aktivitet në vitin 2021 ka qenë “**i përealizuar**”, ndërsa në periudhën 2022–2025 ka status “**në zhvillim e sipër**”, për shkak se një nga tre indikatorët për përmbushjen e këtij aktiviteti ka të bëjë me numrin e sanksioneve kundërvajtëse të shqiptuara për mos publikimin e të dhënave nga neni 10 i Ligjit për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik, për të cilin AQLI vlerëson se nuk është në kompetencë të saj. Për këtë arsye, aktiviteti nuk mund të konsiderohet si plotësisht i realizuar. Konkretisht, AQLI informon se në Ligjin për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik nuk janë parashikuar dispozita kundërvajtëse për zbatimin e sanksioneve për mos publikimin e të dhënave të specifikuara në këtë aktivitet. Ndërkohë, KSHPK vlerëson se Ligji për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik përmban

dispozita kundërvajtëse që sanksionojnë mos publikimin e informacionit lidhur me prokurimet publike në përputhje me nenin 10 të ligjit. Në nenin 10 janë përcaktuar informacionet që mbajtësit e informacionit janë të detyruar t'i publikojnë në faqen e tyre të internetit, ndërsa në alinenë 18 është përcaktuar detyrimi për publikimin e të gjithë dokumentacionit për prokurimet publike, koncesionet dhe kontratat për partneritet publik-privat. Me dispozitat e nenit 39, alinea 2, është përcaktuar se gjobë në shumën prej 250 eurosh në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit zyrtar tek mbajtësi i informacionit për kundërvajtje, nëse nuk e mban dhe nuk e përditëson rregullisht listën e informacioneve që disponon dhe nuk e publikon atë në mënyrën e duhur, të qasshme për kërkuesin, në përputhje me nenin 9. Nga sa u përmend më sipër, është e qartë se ekzistojnë pengesa që kufizojnë shqiptimin e gjobave për mos publikimin e të dhënave, dhe të njëjtat duhet të tejkalohen.




Fotografia 4: Shkalla e përgjithshme e realizimit të fushës

Nga gjithsej 4 aktivitete të parashikuara për këtë fushë, dy aktivitete janë planifikuar të realizohen njëheri, ndërsa 2 aktivitete janë planifikuar të realizohen në kontinuitet për periudhën 2021–2025, që do të thotë se për periudhën pesëvjeçare të përmendur janë vlerësuar gjithsej 12 aktivitete. Prej tyre, tre aktivitete janë realizuar (25%), tre nuk janë realizuar (25%), ndërsa gjashtë kanë qenë në zhvillim e sipër (50%).



Fotografia 5: Statusi i realizimit të aktiviteteve sipas viteve



Fotografia 6: Statusi i aktiviteteve sipas institucioneve

BPP është bartës i 6 aktiviteteve, nga të cilat tre janë realizuar, dy janë të përealizuara dhe një është në zhvillim e sipër.

AQLI është bartës i 5 aktiviteteve, nga të cilat një është i përealizuar, ndërsa katër janë në zhvillim e sipër.

MF është bartës i një aktiviteti, i cili është në zhvillim e sipër.

4. FUSHA HORIZONTALE PUNËSIMI

Përshkrimi i fushës horizontale të punësimit

Problemet prioritare në fushën horizontale të punësimit janë:

- 1) Mospërputhje e një numri të madh të ligjeve që rregullojnë punësimin, gjë që mundëson ndikime të llojllojshme: ndikim partiak, nepotizëm, kronizëm dhe klientelizëm.
- 2) Menaxhim, udhëheqje dhe mbikëqyrje joefikase në disa organe të administratës, agjenci, ndërmarrje publike dhe shoqëri aksionare në pronësi shtetërore dhe
- 3) Rregullativa ligjore nuk ka vendosur një sistem të qartë për vlerësimin e kriterëve të përzgjedhjes në procesin e punësimit dhe avancimit në sektorin publik.

Institucionet përgjegjëse për realizimin e masave dhe aktiviteteve për tejkalimin e problemeve në fushën e punësimit janë:

- 1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në vijim: Qeveria),
- 2) Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit,
- 3) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (në vijim: MSHIA)
- 4) Ministria e Ekonomisë (në vijim: ME),
- 5) Ministria e Vetëqeverisjes Lokale (në vijim: MVL),
- 6) Ministria e Shëndetësisë (në vijim: MSH),
- 7) Ministria e Arsimit dhe Shkencës (në vijim: MASH)
- 8) Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (në vijim: MPPS),
- 9) Ministria e Kulturës (në vijim: MK),
- 10) Ministrinë e tjera (në vijim: ministrinë)
- 11) Komunat dhe Qyteti i Shkupit (në vijim: NJVL), dhe
- 12) Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik (në vijim: AQLI).

Niveli i realizimit të aktiviteteve në fushë

Në fushën horizontale punësim, për tejkalimin e tre problemeve prioritare janë parashikuar 8 masa dhe 25 aktivitete, nga të cilat 10 aktivitete janë njëherëshe, ndërsa 3 aktivitete janë përcaktuar të zbatohen në kontinuitet për periudhën 2021–2025, me çka numri i përgjithshëm i aktiviteteve të vlerësuara për periudhën pesëvjeçare arrin në 25. Në bazë të analizës së kryer të raporteve vjetore, gjendja e realizimit të aktiviteteve është si vijon:

Problemi 1: Mospërputhje e një numri të madh të ligjeve që rregullojnë punësimin, gjë që mundëson lloje të ndryshme ndikimesh: ndikim partiak, nepotizëm, kronizëm dhe klientelizëm.								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Heqja e mundësisë për punësim përmes agjencive për punësim të përkohshëm, si dhe e mundësisë që punësimet e përkohshme të transformohen në punësim me kohë të pacaktuar pa procedurë të rregullt të punësimit.	1.1. Ndryshimi i Ligjit për të punësuarit në sektorin publik me qëllim heqjen e mundësisë për punësim përmes agjencive për punësim të përkohshëm dhe për transformimin e marrëdhënies së punës pa procedurë të rregullt të punësimit.	MAP	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
	2.1. Hartimi i analizës funksionale në subjektet e sektorit publik.	MAP Ministritë NJVL	Gjysma e dytë e vitit 2021-në kontinuitet	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E realizuar	E realizuar
	2.2. Publikimi i analizës funksionale në faqet e internetit të institucioneve.	MAP Ministritë NJVL	Gjysma e dytë e vitit 2021-në kontinuitet	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
2. Vlerësimi i nevojave reale për numrin e të punësuarve dhe kualifikimet e tyre profesionale në subjektet e sektorit publik.	2.3. Analiza e nevojës për vendosjen e një vlerësimi vjetor për vëllimin e punës në subjektet e sektorit publik.	MAP	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
	3.1. Ndryshimi i “Rregullores për përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes së akteve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, si dhe përmbajtjen e analizës funksionale të institucioneve të sektorit publik”.	MAP ME NJVL	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
	3.2. Përcaktimi i duhur i llojit të arsimit për vendin konkret të punës në aktet për sistematizimin e vendeve të punës.							

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

4. Rritja e transparencës gjatë punësimeve në sektorin publik.	4.1. Forcimi i mbikëqyrjes në lidhje me publikimin e akteve për organizimin dhe sistematizimin, si dhe punësimet, në përputhje me nenin 10 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik.	AQLI	Gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet.	E perealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
Problemi 2: Menaxhim, drejtim dhe mbikëqyrje joefikase në disa organe të administratës, agjenci, ndërmarrje publike dhe shoqëri aksionare (SHA) në pronësi shtetërore.								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Të optimizohet numri i anëtarëve në bordet mbikëqyrëse dhe drejtuese në NP dhe SH.A.	1.1. Përcaktimi i kriterëve (kompetencat, të hyrat/shpenzimet, numri i të punësuarve) në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare në lidhje me optimizimin e numrit të anëtarëve në organet drejtuese.	ME MAP MVL	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
	1.2. Harmonizimi i statuteve të NP dhe SH.A. në përputhje me ndryshimet në ligje.	Qeveria dhe NJVL	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
2. Vendosja e kriterëve për llojin e arsimit dhe kompetencave gjatë përzgjedhjes së drejtorëve dhe emërimit të anëtarëve të bordeve drejtuese dhe mbikëqyrëse.	2.1. Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare në drejtim të: - përcaktim të një detyrimi ligjor që me Statut të parashihet lloji i nevojshëm i arsimit për personat udhëheqës dhe për anëtarët e organeve drejtuese; - përcaktim të një procedure për emërimin në kohë të numrit ligjor të anëtarëve të bordeve mbikëqyrëse dhe drejtuese; - përcaktim të gjobave për kundërvajtje për themeluesin në rast të	ME MAP	Gjysma e dytë e 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E perealizuar	E perealizuar	Në zhvillim e sipër

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

	mos-emërimit me kohë të anëtarëve ose përzgjedhjes së paligjshme të një personi udhëheqës.							
	2.2. Harmonizimi i statuteve dhe akteve të brendshme me ndryshimet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin për Ndërmarrjet Publike nga organet e administratës, NP dhe SH.A.	Qeveria e RMV-së NJVL	Gjysma e dytë e 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
Problemi 3: Rregullativa ligjore nuk ka vendosur një sistem të qartë për vlerësimin e kritereve të përzgjedhjes në procesin e punësimit dhe avancimit në sektorin publik								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosja e një procesi të qartë dhe transparent për vlerësimin e kritereve për punësimet dhe avancimet në shëndetësi, arsim, kulturë, mbrojtje sociale dhe shoqëri aksionare në pronësi shtetërore.	1.1 Përcaktimi i akteve nënligjore për vendosjen e kritereve objektive dhe të procesit të vlerësimit për punësim dhe avancim, në varësi të nevojave specifike të çdo sektori veç e veç.	Ministria e Shëndetësisë MK ME MAP MPPS MASH	Gjysma e parë e 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër
2. Kufizimi i së drejtës diskrecionale të personit përgjegjës në procesin e punësimit.	2.1. Analizë e rregullativës ligjore që mundëson të drejtën diskrecionare të personit përgjegjës gjatë punësimeve.	KSHPK	Gjysma e parë e 2021	E realizuar	/	/	/	/
	2.2. Zbatimi i gjetjeve nga analiza e përgatitur.	MAP MSH MPPS MK ME	Gjysma e dytë e 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar

Për realizimin e **Problemit 1: Mospërputhja e një numri të madh të ligjeve që rregullojnë punësimin, me ç'rast mundësohen lloje të ndryshme ndikimesh si: ndikim partiak, nepotizëm, kronizëm dhe klientelizëm**, është parashikuar **Masa 1: Heqja e mundësisë për punësim përmes agjencive për punësime të përkohshme dhe heqja e mundësisë që punësimet e përkohshme të shndërrohen në punësim me kohë të pacaktuar pa procedurë të rregullt punësimi dhe Aktiviteti 1.1.: Ndryshimi i Ligjit për të punësuarit në sektorin publik me qëllim heqjen e mundësisë për punësim përmes agjencive për punësime të përkohshme dhe për transformimin e marrëdhënies së punës pa procedurë të rregullt punësimi**. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa institucioni përgjegjës është **MAP**. Aktiviteti për të gjitha pesë vitet mbetet **“i pareaalizuar”**. Sipas raportit të dorëzuar nga MAP për vitin 2025, është miratuar Ligji i ri për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 144/25), por sipas dispozitave të ndryshuara me Ligjin e ri për të punësuarit në sektorin publik nuk shfuqizohet mundësia e punësimit përmes Agjencive për punësime të përkohshme. Për më tepër, edhe kufizimi fillestar i numrit të personave që gjatë vitit mund të punësohen përmes Agjencive për punësime të përkohshme, me ndryshimet e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik të datës 16.12.2025, është shfuqizuar. Sa i përket pjesës së dytë të aktivitetit, e cila lidhet me heqjen e mundësisë për transformimin e marrëdhënies së punës pa procedurë të rregullt punësimi, në Ligjin e ri për të punësuarit në sektorin publik, ndryshe nga ai i mëparshmi, nuk është përcaktuar në mënyrë taksative nëse mund të ketë transformim të marrëdhënies së punës. Megjithatë, mundësia për transformimin e marrëdhënies së punës nga me kohë të caktuar në me kohë të pacaktuar është çështje e rregulluar nga dispozitat e përgjithshme për marrëdhëniet e punës dhe, për rrjedhojë, mungesa e një dispozite taksative për mundësinë e transformimit të marrëdhënies së punës pa procedurë të rregullt punësimi në Ligjin e ri për të punësuarit në sektorin publik nuk nënkupton se kjo është e ndaluar, përkatësisht e shfuqizuar si mundësi. Për këtë arsye, aktiviteti nuk mund të konsiderohet i realizuar.

Për realizimin e **Masës 2: Vlerësimi i nevojave reale për numrin e të punësuarve dhe kualifikimet e tyre në subjektet e sektorit publik** janë parashikuar tre aktivitete, nga të cilat dy me afat realizimi në **gjysmën e dytë të vitit 2021 dhe në kontinuitet**, ndërsa një aktivitet me afat realiziminë **gjysmën e dytë të vitit 2021**. Për të gjitha tre aktivitetet, institucioni përgjegjës është **MAP**. **Për Aktivitetin 2.1: Përgatitja e analizës funksionale në subjektet e sektorit publik**, për të cilën MAP raporton se institucionet detyrimisht dorëzojnë analizë funksionale të realizuar me qëllim marrjen e pëlqimit për Rregulloret e përgatitura për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, e njëjta është **“e realizuar”** në vitet 2024 dhe 2025.

Aktiviteti 2.2: Publikimi i analizës funksionale në ueb faqet e institucioneve për pesë vite radhazi është **“i pareaalizuar”**. Konkretisht, MAP njofton se nuk ka kompetencë të ushtrojë kontroll mbi dokumentet e publikuara në faqet e internetit të institucioneve dhe se institucionet i publikojnë vetë aktet e tyre për sistematizim, për organizimin e brendshëm dhe analizat funksionale në faqet e tyre të internetit.

Aktiviteti 2.3: Analiza e nevojës për vendosjen e një vlerësimi vjetor të vëllimit të punës në subjektet e sektorit publik, me afat realizimi në gjysmën e dytë të vitit 2021, përfundimisht me vitin 2025 mbetet **“i pareaalizuar”**, për arsye se edhe për këtë aktivitet MAP njofton se, në bazë të LNSH, nuk ka kompetencë të kryejë analizë të vlerësimit vjetor të vëllimit të punës në subjektet e sektorit publik.

Për realizimin e **Masës 3: Përcaktimi i duhur i llojit të arsimit për një vend konkret pune në aktet për sistematizimin e vendeve të punës**, është paraparë **Aktiviteti 3.1. Ndryshim i “Rregullores për përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes së akteve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e**

*vendeve të punës, si dhe përmbajtjen e analizës funksionale të institucioneve të sektorit publik”, me qëllim që lloji i arsimit të lartë të përcaktohet përmes fushave shkencore, dhe jo disiplinave shkencore, në përputhje me klasifikimin Frascati të fushave shkencore gjatë përcaktimit të llojit të arsimit në aktet e sistematizimit. Afati për realizimin e kësaj veprimtarie ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, institucioni përgjegjës është MAP, ndërsa aktiviteti është **“i parealizuar”**. Edhe pse MAP njofton se Rregullorja për përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes së akteve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, si dhe përmbajtjen e analizës funksionale të institucioneve të sektorit publik është ndryshuar, përkatësisht se aktiviteti është realizuar, pas shqyrtimit të Rregullores konstatohet se ajo nuk i përmbush udhëzimet e parashikuara nga ky aktivitet, pasi që lloji i arsimit të lartë për vendin e punës nuk përcaktohet përmes fushave shkencore, por përsëri përcaktohet duke përmendur një fushë kërkimore-shkencore ose një nënfushë kërkimore-shkencore, duke specifikuar një, e më së shumti tre fusha kërkimore-shkencore, të cilat përputhen me përshkrimin e vendit të punës.*

Për realizimin e **Masës 4: Rritja e transparencës gjatë punësimeve në sektorin publik, është paraparë Aktiviteti 4.1: Forcimi i mbikëqyrjes në lidhje me publikimin e akteve për organizim dhe sistematizim, si dhe punësimet, në përputhje me nenin 10 të Ligjit për qasje të lirë në informacionet me karakter publik**, më afat realizimi në **gjysmën e parë të vitit 2021 – në kontinuitet**, ndërsa institucioni përgjegjës është AQLI. Në vitin 2021 aktiviteti ka qenë i parealizuar, ndërsa nga viti 2022 deri në vitin 2025 AQLI ka ndërmarrë aktivitete dhe ka kryer monitorim të faqeve të internetit të disa institucioneve, për çka aktiviteti është konsideruar se është **“në zhvillim e sipër”**. Edhe në këtë rast, ekzistojnë pengesa që e kufizojnë shqiptimin e gjobave për mospublikimin e të dhënave dhe ato duhet të tejkalohen.

Për tejkalimin e **Problemit 2: Menaxhimi, udhëheqja dhe mbikëqyrja joefikase në disa organe të administratës, agjenci, ndërmarrje publike dhe shoqëri aksionare në pronësi shtetërore, është paraparë Masa 1: Optimizimi i numrit të anëtarëve në bordet mbikëqyrëse dhe drejtuese në ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare**, si dhe dy aktivitete.

- **Aktiviteti 1.1: Përcaktimi i kriterëve (kompetencat, të ardhurat/shpenzimet, numri i të punësuarve) në Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare në lidhje me optimizimin e numrit të anëtarëve në organet e menaxhimit (bordet mbikëqyrëse dhe drejtuese)**, më afat realizimi në **gjysmën e dytë të vitit 2021, ndërsa institucioni përgjegjës është ME (MEP)**. Në vitet 2021, 2022 dhe 2023 aktiviteti ka qenë **“në zhvillim e sipër”**, sepse u miratuan ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për ndërmarrjet publike, por jo edhe ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për shoqëritë tregtare. Ky aktivitet është **“realizuar”** në vitin 2024 me miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e LNT (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 272/24), me të cilin u zvogëluar numri i anëtarëve në Bordet Drejtuese dhe Mbikëqyrëse të shoqërive në pronësi dominuese ose të plotë të shtetit (Bordi Mbikëqyrës mund të ketë më së shumti 5, ndërsa Bordi Drejtues më së shumti 7 anëtarë).
- **Aktiviteti 1.2: Harmonizimi i statuteve të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare në përputhje me ndryshimet e ligjeve**, më afat realizimi **gjysma e dytë e vitit 2022**, me institucion përgjegjës **Qeverinë**, është **“në zhvillim e sipër”**, pasi që 13 nga gjithsej 15 ndërmarrje publike të themeluara nga Qeveria tashmë i kanë harmonizuar statutet e tyre, ndërsa 2 ndërmarrje publike janë në procedurë për marrjen e pëlqimit nga Qeveria. Në vitin 2024 është ndryshuar edhe Ligji për shoqëritë tregtare, me të cilin rregullohen të drejtat, obligimet dhe kushtet që duhet t'i plotësojnë anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, anëtarët joekzekutivë të Bordit të Drejtorëve në shoqëritë aksionare me pronësi dominuese ose të plotë shtetërore, Bordi i Drejtorëve dhe anëtarët


e Bordit Drejtues në shoqëritë me pronësi dominuese ose të plotë shtetërore. Shoqëritë tregtare në pronësi shtetërore ende nuk i kanë harmonizuar statutet në përputhje me ndryshimet e dispozitave të këtij ligji.

Për realizimin e **Masës 2: Vendosja e kriterëve për llojin e arsimit dhe kompetencat gjatë përzgjedhjes së drejtorëve dhe emërimit të anëtarëve të bordeve drejtuese dhe mbikëqyrëse**, janë paraparë dy aktivitete.

- **Aktiviteti 2.1: Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare në drejtim të mosparashikimit të obligimit ligjor që me Statut të përcaktohet lloji i nevojshëm i arsimit për personat udhëheqës dhe anëtarët e organeve drejtuese, parashikimit të procedurës për emërimin në kohë të numrit të përcaktuar ligjor të anëtarëve të bordeve mbikëqyrëse dhe drejtuese, si dhe parashikimit të gjobave kundërvajtëse për themeluesin për mosemërim në kohë të anëtarëve ose zgjedhje të paligjshme të personit udhëheqës.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa institucioni përgjegjës **MEP**. Aktiviteti është “**në zhvillim e sipër**”, duke pasur parasysh se ndryshimet dhe plotësimet e lartpërmendura në Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare janë miratuar, përveç pjesës që ka të bëjë me parashikimin e gjobave kundërvajtëse për themeluesin për mosemërim në kohë të anëtarëve ose përzgjedhje të paligjshme të personit udhëheqës.
- **Aktiviteti 2.2: Harmonizimi i statuteve dhe akteve të brendshme me ndryshimet në Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare**, më afat realizimi në **gjysmën e dytë të vitit 2022**, me institucion përgjegjës **Qeverinë**, është “**në zhvillim e sipër**”. Konkretisht, nga gjithsej 15 ndërmarrje publike të themeluara nga Qeveria, 13 i kanë harmonizuar statutet e tyre me ndryshimet në Ligjin për ndërmarrjet publike, ndërsa 2 janë në procedurë për marrjen e pëlqimit nga Qeveria. Në lidhje me ndryshimet në Ligjin për shoqëritë tregtare (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 272/2024), të cilat kanë filluar të zbatohen nga 7 janari 2025, shoqëritë tregtare në pronësi shtetërore ende nuk i kanë harmonizuar statutet e tyre.


Për Problemin 3: Legjislacioni nuk ka vendosur një sistem të qartë për vlerësimin e kriterëve të përzgjedhjes në procesin e punësimit dhe avancimit në sektorin publik, është paraparë **Masa 1: Vendosja e një procesi të qartë dhe transparent të vlerësimit të kriterëve për punësim dhe avancim në shëndetësi, arsim, kulturë, mbrojtje sociale dhe shoqëri aksionare në pronësi shtetërore**, si dhe **Aktiviteti 1.1: Përcaktimi i akteve nënligjore për vendosjen e kriterëve objektive dhe procesit të vlerësimit për punësim dhe avancim në varësi të nevojave specifike të secilit sektor veç e veç**, me afat realizimi në **gjysmën e parë të vitit 2022**, ndërsa institucionet përgjegjëse janë **ministratë** përkatëse, me status “**në zhvillim e sipër**” nga aspekti i aktiviteteve të ndërmarra nga **Ministria e Shëndetësisë**. Konkretisht, është formuar një grup pune i cili ka përgatitur draft-ndryshime të Ligjit për mbrojtjen shëndetësore me qëllim rritjen e transparencës në punësimin e punonjësve shëndetësorë, përmes publikimit të shpalljeve publike, renditjes së kandidatëve sipas kriterëve të përcaktuara dhe heqjes së të drejtës diskrecionale të drejtorit gjatë përzgjedhjes së kandidatit.

Për realizimin e **Masës 2: Kufizimi i diskrecionit të personit përgjegjës në procesin e punësimit**, janë paraparë dy aktivitete. **Aktiviteti 2.1: Analiza e legjislacionit që mundëson diskrecionin e personit përgjegjës gjatë punësimeve**, për të cilin afati ishte gjysma e parë e vitit 2021, me institucion përgjegjës **KSHPK**, është “**realizuar**” brenda afatit të parashikuar. **Aktiviteti 2.2: Zbatimi i gjetjeve nga analiza e përgatitur, e cili duhej të realizohej në gjysmën e dytë të vitit 2022 nga MAP**, është “**i parealizuar**”. Konkretisht, edhe pse KSHPK ka përgatitur Analizën e legjislacionit që mundëson diskrecionin e personit përgjegjës gjatë punësimeve, ende nuk ka informacion për zbatimin e gjetjeve të saj.




Fotografia 7: Shkalla e përgjithshme e realizimit në fushë përkatëse

Nga gjithsej 13 aktivitete të parashikuara për këtë fushë, 10 aktivitete janë parashikuar të realizohen njëheri, ndërsa 3 aktivitete janë planifikuar të realizohen në kontinuitet për periudhën 2021–2025, që do të thotë se për periudhën pesëvjeçare të përmendur janë vlerësuar gjithsej 25 aktivitete. Prej tyre, 4 aktivitete janë realizuar (16%), 13 janë të përealizuara (52%), ndërsa 8 janë në zhvillim e sipër (32%).



Fotografia 8: Statusi i realizimit të aktiviteteve sipas viteve



Fotografia 9: Statusi i aktiviteteve sipas institucioneve

- Për MAP janë parashikuar 14 aktivitete, nga të cilat dy janë realizuar, ndërsa 12 janë të parealizuara.
- Qeveria ka 2 aktivitete në zhvillim e sipër.
- AQLI ka 5 aktivitete, nga të cilat një është i parealizuar, ndërsa 4 janë në zhvillim e sipër.
- MEP ka 2 aktivitete, nga të cilat një është i realizuar, ndërsa tjetra është në zhvillim e sipër.
- MSH ka një aktivitet në zhvillim e sipër.
- KSHPK ka një aktivitet të realizuar në vitin 2021.

5. SEKTORI SISTEM POLITIK

Përshkrim i sektorit

Në lidhje me sektorin sistem politik, në Strategji janë përcaktuar këto gjashtë probleme prioritare:

- 1) Miratimi i një numri të madh ligjesh në procedurë të shkurtuar pa arsyetim të duhur për justifikimin e këtij lloji procedure;
- 2) Përgatitja, propozimi dhe miratimi i rregullativës pa analiza paraprake të mjaftueshme dhe cilësore, vlerësim të ndikimeve dhe procese konsultuese në funksion të mbrojtjes së interesit publik;
- 3) Mosndëshkimi i refuzimit për dorëzimin e deklaratës së gjendjes pronësore dhe interesave nga personat që kanë një detyrim të tillë;
- 4) Rregullim i pamjaftueshëm i ndërveprimit midis lobistëve dhe përfaqësuesve të organeve të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, si dhe funksionarëve të pushtetit lokal;
- 5) Përfshirje e pamjaftueshme e funksionarëve të nivelit më të lartë në programe edukative nga fusha e etikës dhe integritetit;
- 6) Nuk ekziston një mekanizëm, si dhe ndonjë organ për ndjekje efikase të prezantimit mediatik të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore përmes portaleve të internetit.

Për tejkalimin e këtyre problemeve, me Planin e Veprimit të Strategjisë janë parashikuar shtatë masa dhe tetë aktivitete, ndërsa për realizimin e këtyre aktiviteteve përgjegjëse janë:

- 7) Kuvendi,
- 8) Qeveria,
- 9) KSHPK,
- 10) MSHIA dhe
- 11) Ministria e Drejtësisë (në tekstin e mëtejshëm: MD).

Shkalla e relizimit të aktiviteteve në sektor

Në sektorin e Sistemit Politik, për tejkalimin e gjashtë problemeve prioritare janë parashikuar 7 masa dhe 12 aktivitete, nga të cilat 7 aktivitete janë njëherëshe, ndërsa një aktivitet është parashikuar të zbatohet në kontinuitet për periudhën 2021–2025, me ç'rast numri i përgjithshëm i aktiviteteve të vlerësuara për periudhën pesëvjeçare është 12. Në bazë të analizës së raporteve vjetore të realizuara, gjendja e zbatimit të aktiviteteve është si vijon:

Problemi 1: Miratimi i një numri të madh ligjesh në procedurë të shkurtuar pa arsyetim të duhur për justifikimin e këtij lloji procedure								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Përcaktimi në rregulloren e punës i një definicioni për kompleksitetin dhe vëllimin e propozim-ligjeve.	1.1. Ndryshimi i Rregullores së Punës së Kuvendit të RMV-së.	Kuvendi i RMV-së	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 2: Përgatitja, propozimi dhe miratimi i rregulloreve shpesh kryhen pa analiza cilësore të realizuara paraprakisht në mënyrë të duhur, pa vlerësim të ndikimeve dhe pa procese konsultative në funksion të mbrojtjes së interesit publik								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Rregullimi i procesit të VNR-së, në drejtim të bërjes së tij të detyrueshëm.	1.1. Miratimi i një Metodologjie të re për VNR, me bashkim të proceseve për vlerësimin e zbatimit të rregullativës dhe kontrollin antikorruption të legjislacionit.	MAP Qeveria	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 3: Mosndëshkimi i refuzimit për dorëzimin e deklaratës për gjendjen pasurore dhe interesat nga personat që kanë një detyrim të tillë								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Përcaktimi i gjendjes së “refuzimit për deklarin e gjendjes pasurore dhe interesave” nga personat që kanë një detyrim të tillë ligjor.	1.1. Ndryshimi i LPKKI-së.	MD	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
2. Vendosja e masave për përcaktimin e përgjegjësisë së personave që refuzojnë të dorëzojnë deklaratën për gjendjen pasurore dhe interesat.	2.1. Ndryshimi i LPKKI-së.	MD	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
Problemi 4: Ndërveprim i parregulluar ndërmjet lobistëve dhe përfaqësuesve të organeve të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, si dhe funksionarëve të pushtetit lokal								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosja e rregullave për rregullimin e ndërveprimit midis lobistëve dhe përfaqësuesve të pushtetit.	1.1. Miratimi i një ligji të ri për lobim.	MD	Gjysma e parë e vitit 2022	E realizuar	/	/	/	/
Problemi 5: Përfshirje e pamjaftueshme e bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë në programe edukative në fushën e etikës dhe integritetit								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

1. Forcimi i sistemit të integritetit të bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë.	1.1. Miratimi i një programi për ngritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e integritetit të bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë.	KSHPK Qeveria	Gjysma e parë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar
	1.2. Zbatimi i programit për trajnime.	KSHPK	Gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	E parealizuar
Problemi 6: Nuk ekziston mekanizëm, as organ për monitorimin efektiv të prezantimit mediatik të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore përmes portaleve në internet								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Kompensimi për reklamimin në portalet e internetit të mos jetë në ngarkim të Buxhetit të RMV-së.	1.1. Ndryshim i Kodit Zgjedhor në drejtim të përjashtimit të portaleve të internetit nga kompensimi i shpenzimeve për reklamimin e pjesëmarrësve në fushatat zgjedhore, deri në miratimin e një kornize ligjore për rregullimin e tyre.	MD	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër

Për tejkalimin e **Problemit 1: Miratimi i një numri të madh ligjesh në procedurë të shkurtuar pa arsytim të duhur për justifikimin e këtij lloji procedure**, është paraparë **Masa 1: Përcaktimi në rregullore i definicionit për kompleksitetin dhe vëllimin e propozim-ligjeve dhe Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i Rregullores së Punës së Kuvendit të RMV-së**. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ishte gjysma e dytë e vitit 2021, ndërsa institucioni përgjegjës **Kuvendi**. Statusi përfundimtar i këtij aktiviteti është **“i parealizuar”**, për arsye se, edhe pse Kuvendi në vitin 2023 miratoi Rregulloren e re të Punës, në të nuk është përcaktuar definicioni për kompleksitetin dhe vëllimin e propozim-ligjeve.

Për tejkalimin e **Problemit 2: Përgatitja, propozimi dhe miratimi i rregullativës shpesh bëhet pa analiza paraprake të mjaftueshme dhe cilësore, vlerësim të ndikimeve dhe procese konsultuese në funksion të mbrojtjes së interesit publik**, është paraparë **Masa 1: Rregullimi i procesit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës (VNR), në drejtim të bërjes së tij të detyrueshëm, dhe Aktiviteti 1.1: Miratimi i një Metodologjie të re për VNR-në, me bashkimin e proceseve të vlerësimit të zbatimit të rregullativës dhe kontrollit antikorrupsion të legjislacionit**, me afat realizimi gjysma e dytë e vitit 2021, ndërsa bartës është **MSHIA (MAP)**, e cila nuk ka ndërmarrë aktivitete konkrete në drejtim të realizimit të këtij aktiviteti, dhe i njëjti konsiderohet **“i parealizuar”**.

Në lidhje me **Problemin 3: Mosndëshkimi i refuzimit për dorëzimin e deklaratës së gjendjes pasurore dhe interesave nga personat që kanë një detyrim të tillë, janë paraparë dy masa. Masa 1: Përcaktimi i gjendjes së “refuzimit të deklarimit të gjendjes pasurore dhe interesave” nga personat që kanë një obligim ligjor të tillë dhe Aktiviteti 1.1: Ndryshime dhe plotësime të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit**. Afati për realizimin e këtij ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa bartës Ministria e Drejtësisë. Ky aktivitet është **“në zvillim e sipër”**, ndërsa Ministria e Drejtësisë njofton se Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit është në procedurë qeveritare.


Për **Masën 2: Vendosja e masave për përcaktimin e përgjegjësisë së personave që refuzojnë të dorëzojnë deklaratën e gjendjes pasurore dhe interesave**, është paraparë **Aktiviteti 2.1: Ndryshime dhe plotësime të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit**, me afat realizimi gjysma e parë e vitit 2022, ndërsa bartës është Ministria e Drejtësisë. Ky aktivitet gjithashtu është **“në zhvillim e sipër”** dhe është përfshirë në Propozim-ligjin e lartpërmendur për ndryshimin dhe plotësimin e LPKKI-së.

Për tejkalimin e **Problemit 4: Ndërveprimi i parregulluar midis lobistëve dhe përfaqësuesve të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, si dhe funksionarëve të pushtetit lokal**, është paraparë **Masa 1: Vendosja e rregullave për rregullimin e ndërveprimit midis lobistëve dhe përfaqësuesve të pushtetit**, me **Aktivitetin 1.1: Miratimi i një ligji të ri për lobimin**. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021**, ndërsa bartës është Ministria e Drejtësisë. Aktiviteti është **“i realizuar”** brenda afatit të parashikuar.

Për **Problemin 5: Përfshirja e pamjaftueshme e bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë në programe edukative nga fusha e etikës dhe integritetit**, është paraparë **Masa 1: Forcimi i sistemit të integritetit të bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë**, e cila ka dy aktivitete.


- **Aktiviteti 1.1: Miratimi i programit për ngritjen e vetëdijes dhe forcimin e integritetit të bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë**, me afat realizimi **gjysma e parë e vitit 2021**, institucioni përgjegjës është KSHPK, ndërsa aktiviteti është **“i përealizuar”**. Konkretisht, në kuadër të përcaktimit strategjik për forcimin e integritetit dhe llogaridhënies në sektorin publik, KSHPK gjatë vitit 2024 identifikoi nevojën për avancim sistematik dhe të vazhdueshëm të përgjegjësisë politike të bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë. Kjo rrjedh nga vlerësimet se parandalimi i korrupsionit dhe menaxhimi i konfliktit të interesit nuk mund të jenë të qëndrueshme pa një demonstrim të qartë të vullnetit politik dhe shembullit personal nga maja e ekzekutivit. Në këtë drejtim, u iniciuan disa cikle trajnimesh, punëtori tematike dhe tryeza të rrumbullakëta me persona të emëruar sipas Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, me fokus të veçantë të kryetarët e komunave dhe bartësit e funksioneve në vetëqeverisjen lokale (me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup) dhe personat e emëruar në pushtetin qendror (me mbështetjen e projektit “Partneriteti kundër korrupsionit”, i financuar nga USAID). Këto aktivitete kishin për qëllim ngritjen e vetëdijes për përgjegjësinë personale, menaxhimin e rreziqeve të konfliktit të interesit, transparencën në vendimmarrje dhe rolin e integritetit si parakusht për besimin publik. Megjithatë, gjatë vitit 2025 nuk u siguroi vazhdimësia e zbatimit të këtyre aktiviteteve, kryesisht për shkak të ndryshimit të prioritetëve në kuadër të mbështetjes donatore dhe përfundimit të aktiviteteve të projekteve. Bashkëpunimi me OSBE-në në këtë periudhë u orientua drejt punës së drejtpërdrejtë me personat e integritetit në institucione, ndërsa projekti i mbështetur nga USAID u mbyll, duke rezultuar në ulje të mbështetjes institucionale dhe financiare për aktivitetet e drejtuara ndaj bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë. Prandaj, përvoja e vitit 2024 dhe mungesa e vazhdimësisë në vitin 2025 e konfirmojnë nevojën që këto aktivitete të institucionalizohen përmes miratimit formal të një programi të veçantë për ngritjen e vetëdijes dhe forcimin e integritetit të bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë, në vend që të zbatohen vetëm mbi bazë projektësh. Krijimi i një programi të tillë do të sigurojë: qasje sistematike në vend të aktiviteteve ad-hoc, komponentë të rregullt dhe të detyrueshëm edukativ, lidhje të qartë me objektivat strategjike për rritjen e përgjegjësisë politike dhe demonstrim të dukshëm të vullnetit politik për forcimin e integritetit.
- **Aktiviteti 1.2: Zbatimi i programit të trajnimeve**, me afat realizimi **gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet**, ndërsa institucioni përgjegjës është KSHPK, konsiderohet **“i përealizuar”**. I njëjti është realizuar vetëm në vitin 2024. Gjatë vitit 2025 nuk janë zhvilluar trajnime të dedikuara ekskluzivisht për bartësit e pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë, për shkak të mungesës së një programi të institucionalizuar dhe ndërprerjes së mbështetjes me projekte, e cila në periudhën e mëparshme mundësonte organizimin e këtyre aktiviteteve. Ky fakt e thekson më tej nevojën për vendosjen e një programi formal dhe parashikimin e burimeve buxhetore dhe organizative për realizimin e tij të vazhdueshëm. Në periudhën raportuese nuk janë regjistruar funksionarë të nivelit më të lartë të pushtetit ekzekutiv të përfshirë në ndonjë program të veçantë trajnimi nga fusha e integritetit dhe etikës. Përvojat e viteve të mëparshme tregojnë se interesi dhe përfshirja në aktivitete të tilla janë dukshëm më të larta kur ekziston një kornizë e qartë institucionale, mbështetje politike dhe obligim i formalizuar për pjesëmarrje. Prandaj, në periudhën e ardhshme strategjike është e domosdoshme të vendoset një mekanizëm që siguron përfshirje sistematike dhe të matshme të funksionarëve të nivelit më të lartë.

Për Problemin 6: Nuk ekziston një mekanizëm dhe organ për ndjekje efikase të prezantimit mediatik të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore përmes portaleve të internetit, është paraparë Masa 1: Pagesa për reklamim në portalet e internetit të mos jetë barrë e Buxhetit të RMV-së, me Aktivitetin 1.1: Ndryshimi i Kodit Zgjedhor në drejtim të përjashtimit të portaleve të internetit nga kompensimi i shpenzimeve për reklamimin e pjesëmarrësve në fushatat zgjedhore, deri në miratimin e një kornize ligjore për rregullimin e tyre. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ishte **gjysma e dytë e vitit 2021**, institucioni përgjegjës Ministria e Drejtësisë, ndërsa statusi i tij është **“në zhvillim e sipër”**. Ministria e Drejtësisë ka njoftuar se në vitin 2025 ka përgatitur ndryshime në Kodin Zgjedhor, në të cilat janë inkuorporuar një pjesë e rekomandimeve të OSBE/ODIHR. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë ka njoftuar se në gjysmën e dytë të janarit 2026 do të formojë një grup pune për nevojën e rregullimit sistematik dhe gjithëpërfshirës të Kodit Zgjedhor, në kuadër të të cilit do të shqyrtohen të gjitha çështjet aktuale dhe rekomandimet nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë edhe masat e parashikuara me Strategjinë.




Fotografia 10: Shkalla e përgjithshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 12 aktivitete në Strategjinë për sektorin e sistemit politik (është parashikuar që një aktivitet të zbatohet në kontinuitet nga viti 2021 deri në vitin 2025), 2 aktivitete janë realizuar (17%), 6 aktivitete janë të përealizuara (50%), ndërsa 4 aktivitete janë në zhvillim e sipër (33%).



Fotografia 11: Statusi i realizimit të aktiviteteve sipas viteve



Fotografia 12: Statusi i realizimit të aktiviteteve sipas institucioneve

- Për MAP është parashikuar një aktivitet, i cili është i përealizuar.
- Kuvendi i RMV-së ka një aktivitet të përealizuar.
- MD ka 4 aktivitete, nga të cilat një është realizuar, ndërsa tre janë në zhvillim e sipër.
- KSHPK ka 6 aktivitete, nga të cilat një është i realizuar, katër janë të përealizuara, ndërsa një është në zhvillim e sipër.

6. SEKTORI I GJYQËSORIT

Përshkrim i sektorit

Problemet prioritare në sektorin e gjyqësorit janë:

- 1) Sistem i pamjaftueshëm efikas për forcimin e integritetit në gjyqësor dhe në prokurorinë publike;
- 2) Burime materiale dhe njerëzore të pamjaftueshme, mungesë e një sistemi të automatizuar për shpërndarjen dhe ndjekjen e lëndëve në prokurorinë publike dhe transparencë e pamjaftueshme në punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë;
- 3) Efikasitet dhe transparencë e pamjaftueshme në punën e Avokaturës Shtetërore.

Institucionet përgjegjëse për realizimin e masave dhe aktiviteteve për tejkalimin e problemeve në sektorin e drejtësisë janë:

- 4) MD
- 5) MF
- 6) Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme PP RMV)
- 7) Avokatura Shtetërore (në tekstin e mëtejme ASh)
- 8) Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë (në tekstin e mëtejme AGJPP)
- 9) Shoqata e Prokurorëve Publikë

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në sektorin përkatës

Në sektorin e Gjyqësorit, për tejkalimin e tre problemeve prioritare janë parashikuar 7 masa dhe 14 aktivitete, nga të cilat 10 aktivitete janë njëherëshe, ndërsa 4 aktivitete janë parashikuar të zbatohen në kontinuitet nga viti 2021 deri në vitin 2025, me ç'rast numri i përgjithshëm i aktiviteteve të vlerësuara për periudhën pesëvjeçare është 30. Në bazë të analizës së raporteve vjetore të zbatuara, gjendja e realizimit të aktiviteteve është si vijon:

Problemi 1: Sistem i pamjaftueshëm efikas për forcimin e integritetit në gjyqësor dhe në prokurorinë publike								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Plotësimi i Kodit të prokurorëve publikë me komente dhe shembuj.	1.1. Propozimi i komenteve dhe shembujve për Kodin nga Shoqata e Prokurorëve Publikë.	Shoqata e Prokurorëve Publikë	Gjysma e dytë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
	1.2. Miratimi i plotësimit të Kodit të prokurorëve publikë.	PPRMV	Gjysma e dytë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
2. Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme për gjyqtarët dhe prokurorët publikë për të siguruar implementimin e kodeve të sjelljes profesionale.	2.1. Miratimi i programeve për trajnime të detyrueshme mbi sjelljen profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve.	AGJPP	Gjysma e dytë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
	2.2. Zbatimi i trajnimeve nga Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë.	AGJPP	Gjysma e dytë e vitit 2021 – në kontinuitet	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar
3. Zbatimi i vlerësimit të rreziqeve të korrupsionit në sistemin e gjyqësorit.	3.1. Formimi i një grupi pune ekspertësh për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në sistemin e gjyqësorit.	KSHPK	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E realizuar	/	/	/
	3.2. Përgatitja e një analize të thelluar dhe vlerësimi i faktorëve që	KSHPK	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/	/

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

	gjenerojnë korrupsion në sistemin e drejtësisë.							
Problemi 2: Resurse të pamjaftueshme materiale dhe kadrovike, mungesë e sistemit të automatizuar për shpërndarjen dhe ndjekjen e lëndëve në prokurorinë publike dhe transparencë e pamjaftueshme në punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Ekipim kadrovik të prokurorive publike në përputhje me sistematizimet ekzistuese të vendeve të punës.	1.1. Rritja e mjeteve buxhetore për Prokurorinë Publike për punësim të reja.	MF	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar
	1.2. Zbatimi i trajnimeve për prokurorët e rinj publikë.	AGJPP	2021, Në kontinuitet	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar
2. Formimi i qendrave hetimore brenda prokurorive publike.	2.1. Sigurimi i mjeteve buxhetore për qendrat hetimore.	MF	2021, Në kontinuitet	Në zhvillim e sipër	E realizuar	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar
	2.2. Marrja e vendimit për formimin e qendrave hetimore.	PPRMV	2021, Në kontinuitet	Në zhvillim e sipër	E realizuar	E realizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar
3. Vendosija e një sistemi të automatizuar për shpërndarjen dhe ndjekjen e lëndëve në prokurorinë publike.	3.1. Analizë e procesit të menaxhimit të lëndëve në Prokurorinë Publike të RMV-së.	PPRMV	Gjysma e parë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
	3.2. Prokurimi i një sistemi të automatizuar për shpërndarjen dhe ndjekjen e lëndëve.	PPRMV	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	3.3. Trajnimi i stafit për përdorimin e tij.	PPRMV	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 3: Efikasiteti i pamjaftueshëm dhe transparencë e pamjaftueshme në punën e Avokaturës Shtetërore								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Rritja e efikasitetit dhe transparencës në punën e Avokaturës Shtetërore.	1.1. Miratimi i një ligji të ri për Avokaturën Shtetërore	MD	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër

Për tejkalimin e **Problemit 1: Sistem i pamjaftueshëm efikas për forcimin e integritetit në gjyqësor dhe në prokurorinë publike, Masa 1: Plotësimi i Kodit të Prokurorëve Publikë me komente dhe shembuj, përfshin dy aktivitete:**

- **Aktiviteti 1.1: Propozimi i komenteve dhe shembujve për Kodin nga Shoqata e Prokurorëve Publikë, në kompetencë të Shoqatës së Prokurorëve Publikë.**
- **Aktiviteti 1.2: Miratimi i plotësimit të Kodit të Prokurorëve Publikë, në kompetencë të Shoqatës së Prokurorëve Publikë dhe Prokurorisë Publike të RMV-së, për të cilat afati i realizimit ka qenë gjysma e dytë e vitit 2021, të dyja janë “të realizuara” brenda afatit të përcaktuar.**

Masa e parashikuar 2: Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme për gjyqtarët dhe prokurorët publikë me qëllim të zbatimit të kodeve të sjelljes profesionale përfshin dy aktivitete:

- **Aktiviteti 2.1: Miratimi i programeve për trajnime të detyrueshme për sjelljen profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me afat gjysmën e dytë të vitit 2021, në kompetencë të AGJPP, është “i realizuar” brenda afatit të përcaktuar.**
- **Aktiviteti 2.2: Zbatimi i trajnimeve nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, në kompetencë të AGJPP, me afat realizimi në vitin 2021 në kontinuitet, është “i realizuar” gjatë periudhës pesëvjeçare. Konkretisht, AGJPP gjatë periudhës 2021–2025 ka realizuar rreth 80 trajnime tematike, me numër dhe diversitet të konsiderueshëm pjesëmarrësish nga sistemi i drejtësisë. Zbatimi i këtij aktiviteti tregon një qasje aktive dhe funksionale drejt përmirësimit të standardeve profesionale dhe etike.**

Masa 3: Zbatimi i vlerësimit të rreziqeve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë përfshin dy aktivitete dhe atë:

- **Aktiviteti 3.1: Formimi i grupit të punës eksperte për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë, me afat realizimi gjysmën e parë të vitit 2022, në kompetencë të KSHPK, është “i realizuar” në kohë.**
- **Aktiviteti 3.2: Përgatitja e një analize të thelluar dhe vlerësimi i faktorëve që gjenerojnë korrupsion në sistemin e drejtësisë, me afat realizimi në gjysmën e dytë të vitit 2022, gjithashtu në kompetencë të KSHPK, është “realizuar” në vitin 2023 me prezantim publik të Raportit me gjetje nga analiza e realizuar nga grupi i punës i ekspertëve. Raporti për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë është publikuar në faqen e internetit të KSHPK.**

Për tejkalimin e **Problemit 2: Mungesë e mjaftueshme e materialeve dhe resurseve kadrovike, mungesë e sistemeve të automatizuara për shpërndarjen e lëndëve dhe ndjekjen e tyre në prokurorinë publike, si dhe transparencë e pamjaftueshme në punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë, parashihen tre masa. Masa 1: Ekipim kadrovik të prokurorive publike në përputhje me sistematizimet ekzistuese të vendeve të punës, dhe dy aktivitete:**

- **Aktiviteti 1.1: Rritja e mjeteve buxhetore për Prokurorinë Publike për punësime të reja, me afat realizimi gjysmën e dytë të vitit 2021, në kompetencë të Ministrisë së Financave, vlerësohet si “i parealizuar”. Konkretisht, sipas raportit të dorëzuar për vitin 2025, Ministria e Financave ka dhënë mendim negativ për Planin vjetor të punësimeve në PPRMV-së për vitin 2025 për shkak të implikimeve fiskale, ndërsa një plan i rishikuar për vitin 2025 nuk është dorëzuar në Ministrinë e Financave.**
- **Aktiviteti 1.2: Zbatimi i trajnimeve për prokurorët e rinj, në kompetencë të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë dhe me afat realizimi 2021 – në**

kontinuitet. Aktiviteti në vazhdimi ka qenë „i realizuar” gjatë gjithë periudhës pesëvjeçare. Sipas raporteve të dorëzuara nga AGJPP, gjatë periudhës 2021–2025 janë mbajtur katër trajnime njëditore dhe/ose shumëditore, në të cilat kanë marrë pjesë gjithsej 59 prokurorë publikë të sapoemëruar.


Masa 2: Krijimi i qendrave hetimore brenda prokurorive publike përfshin dy aktivitete të realizuara në periudhën raportuese:

- **Aktiviteti 2.1: Sigurimi i mjeteve buxhetore për qendrat hetimore,** është në kompetencë të **Ministrit të Financave** dhe i parashikuar për **vitin 2021–në kontinuitet**. Ky aktivitet në vitin 2021 është vlerësuar në zhvillim e sipër, në vitet 2023 dhe 2024 ka qenë i parealizuar, ndërsa në vitet 2022 dhe 2025 ka pasur status “i realizuar”.
- **Aktiviteti 2.2: Marrja e vendimit për krijimin e qendrave hetimore,** me afat realizimi në vitin **2021– dhe në kontinuitet**, në kompetencë të **PPRMV-së**, ka qenë “në zhvillim e sipër” në vitet 2021 dhe 2024, ndërsa në vitet 2022, 2023 dhe 2025 ka qenë “i realizuar”. Gjatë gjithë periudhës pesëvjeçare të zbatimit të Strategjisë, PPRMV ka krijuar ose vënë në funksion gjithsej gjashtë qendra hetimore, dhe atë në: PTHP Shkup, PTHP Kumanovë, PTHP Tetovë, PTHPNKOK (të formuara me vendim në vitin 2018, ndërsa të pajisura dhe vëna në funksion gjatë periudhës raportuese), PTHP Shtip dhe PTHP Manastir (të formuara me vendim në vitin 2025).

Masa 3: Vendosja e një sistemi të automatizuar për shpërndarjen dhe ndjekjen e lëndëve në prokurorinë publike përfshin tre aktivitete:


- **Aktiviteti 3.1: Analiza e procesit të menaxhimit të lëndëve në PPRMV,** me afat realizimi në **gjysmën e dytë të vitit 2021**, në kompetencë të **PPRMV-së**, është “**realizuar**” brenda afatit të përcaktuar.
- **Aktiviteti 3.2: Prokurimi i sistemit të automatizuar për shpërndarjen dhe ndjekjen e lëndëve,** i parashikuar për **gjysmën e parë të vitit 2022** në kompetencë të **PPRMV-së**, ka status “në vazhdim e sipër”. Konkretisht, PPRMV me datë 10.02.2022 ka miratuar Rregulloren për shpërndarjen e lëndëve në prokuroritë publike përmes sistemit elektronik të shpërndarjes së lëndëve. Në mungesë të mjeteve buxhetore për prokurimin e sistemit të automatizuar, PPRMV përmes projektit “BE mbështetje për sundimin e së drejtës” ka siguruar fonde për sistem të ri elektronik të menaxhimit të lëndëve dhe në vitin 2025 është shpallur tender për përzgjedhjen e kompanisë që do të zhvillojë zgjidhjen softuerike. Edhe pse financimi i sistemit është në kuadër të fondeve IPA, në kuadër të projektit është parashikuar bashkëfinancim i pjesshëm shtetëror, i cili deri në dhjetor 2025 nuk është siguruar.
- **Aktiviteti 3.3: Trajnimi i personelit për përdorimin e tij,** i parashikuar për **gjysmën e dytë të vitit 2022** në kompetencë të **PPRMV-së**, është i ndërlidhur me aktivitetin e mëparshëm, përkatësisht me prokurimin e sistemit i cili ende nuk është realizuar plotësisht, dhe për këtë arsye ky aktivitet konsiderohet “i parealizuar”.

Për **Problemin 3: Efikasiteti i pamjaftueshëm dhe transparenca e pamjaftueshme në punën e Avokaturës Shtetërore**, është paraparë **Masa 1: Rritja e efikasitetit dhe transparencës në punën e Avokaturës Shtetërore**, me **Aktivitetin 1.1: Miratimi i një ligji të ri për Avokaturën Shtetërore**, për të cilin afati ishte **gjysma e dytë e vitit 2022**, në kompetencë të Ministrit të Drejtësisë. Sipas raporteve të dorëzuara, ky aktivitet që nga viti 2024 ka status “në zhvillime e sipër”, duke pasur parasysh se ende nuk është miratuar Ligji i ri për Avokaturën Shtetërore, i cili është përgatitur dhe është vendosur në platformën RVKE.




Fotografia 13: Shkalla e përgjithëshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 14 aktivitete të parashikuara për këtë sektor, 10 aktivitete janë planifikuar të realizohen njëheri, ndërsa 4 aktivitete janë planifikuar në kontinuitet për periudhën 2021–2025, që do të thotë se për periudhën e përmendur pesëvjeçare janë vlerësuar gjithsej 30 aktivitete. Prej tyre, 21 aktivitete janë realizuar (70%), 4 aktivitete janë të përealizuara (13%), ndërsa 5 aktivitete janë në zhvillim e sipër (17%).



Fotografia 14: Statusi i realizimit të përgjithshëm të aktiviteteve sipas viteve



Fotografia 15: Statusi i aktiviteteve sipas institucioneve

- Për SHPP është parashikuar një aktivitet, i cili është realizuar në vitin 2021.
- Për MD është parashikuar një aktivitet, i cili është në zhvillim e sipër.
- Për PPRMV janë parashikuar 9 aktivitete, prej të cilave pesë janë realizuar, një aktivitet nuk është realizuar dhe tre janë në zhvillim e sipër.
- MF ka 6 aktivitete, prej të cilave dy janë realizuar, tre nuk janë realizuar dhe një është në zhvillim e sipër.
- KSHPK ka 2 aktivitete të realizuara.
- AGJPP ka 11 aktivitete të realizuara.

7. SEKTORI ORGANET PËR ZBATIMIN E LIGJIT

Përshkrimi i sektorit

Në lidhje me organet për zbatimin e ligjit, në Strategji janë identifikuar shtatë probleme të mëposhtme:

- 1) Autorizime të mëdha diskrecionale të personave përgjegjës dhe mungesë transparence në punësime dhe avancime në MPB;
- 2) Sistem joefikas për përcaktimin e përgjegjësisë profesionale në organet për zbatimin e ligjit;
- 3) Kompetenca të paqarta dhe të pasakta dhe përputhje e kompetencave të inspektorateve;
- 4) Veprim subjektiv dhe i papërshtatshëm i inspektorëve gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre;
- 5) Mbikëqyrje inspektuese jo mjaft funksionale në vetëqeverisjen lokale;
- 6) Drejtuesit e institucioneve nuk zbatojnë rekomandimet nga auditimi i brendshëm dhe ESHR;
- 7) Ndikimi i personave përgjegjës në institucionet publike mbi pavarësinë e auditimit të brendshëm.

Për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara për tejkalimin e problemeve në sektorin e organeve për zbatimin e ligjit, janë kompetente institucionet e mëposhtme:

- 8) Qeveria;
- 9) Ministria e Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejshëm: MPB);
- 10) MF;
- 11) Drejtoria e Policisë Financiare (në tekstin e mëtejshëm: DPF);
- 12) Drejtoria për Inteligjencë Financiare (në tekstin e mëtejshëm: DIF);
- 13) MD;
- 14) Drejtoria e Doganave (në tekstin e mëtejshëm: DD);
- 15) KSHPK;
- 16) Këshilli Inspektues (në tekstin e mëtejshëm: KI);
- 17) Ministrinë;
- 18) MSHIA/MAP;
- 19) Inspektorati Shtetëror Administrativ (në tekstin e mëtejshëm: ISHA) dhe
- 20) Enti Shtetëror i Revizionit (në tekstin e mëtejshëm: ESHR).

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në sektor

Në sektorin e Organeve për zbatimin e ligjit, për tejkalimin e shtatë problemeve prioritare janë parashikuar 13 masa dhe 21 aktivitete, prej të cilave 20 aktivitete janë njëherëshe, ndërsa një aktivitet është përcaktuar të zbatohet në kontinuitet nga viti 2021 deri në 2025, me çrast numrin total të aktiviteteve të vlerësuara për periudhën pesëvjeçare shkon në 25. Bazuar në analizën e raporteve vjetore të kryera, gjendja e realizimit të aktiviteteve është si më poshtë:

Problemi 1: Kompetenca diskrete e personave përgjegjës dhe mungesë transparence në punësime dhe avancime në MPB								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosija e transparencës në procedurën e punësimit dhe avancimit në MPB, përveç punësimeve që realizohen në bazë të dispozitave të veçanta të Ligjit për punët e brendshme.	1.1 Ndryshim i Ligjit për punë të brendshme	MPB	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E realizuar	/	/	/
2. Të sigurohet transparenca e akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në MPB dhe publikimi i tyre në faqen e internetit të MPB-së, përveç vendeve të punës që rregullohen në bazë të dispozitave të veçanta të Ligjit për punë të brendshme.	2.1. Deklasifikimi i akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në MPB	MPB	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 2: Sistem joefikas për përcaktimin e përgjegjësisë profesionale në organet e zbatimit të ligjit								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Krijimi i një njësie të veçantë organizative për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale në DPF dhe DIF	1.1 Ndryshim i Ligjit për Policinë Financiare	DPF	Gjysma e dytë e vitit 2022	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	1.2 Harmonizimi i akteve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në DPF dhe DIF	DPF DIF	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
2. Përmirësimi i procesit të procedurave disiplinore në MPB	2.1 Harmonizimi i akteve të brendshme me “Strategjinë për avancimin dhe përmirësimin e	MPB	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

	procedurave disiplinore 2020–2022”.							
3. Vendosja e statusit të policisë gjyqësore për të punësuarit në Sektorin për përgjegjësi profesionale pranë Drejtorisë së Doganave (në përputhje me Ligjin për procedurë penale, nenet 46, 47).	3.1 Ndryshim dhe plotësim i Ligjit për procedurë penale, neni 47 paragrafi 2, në drejtim të zgjerimit të fushëveprimit të veprave penale, përkatësisht plotësimit të kompetencës së pjesëtarëve të policisë gjyqësore pranë DD edhe me veprat penale nga fusha e korrupsionit të kryera nga të punësuarit në DD.	MD	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
	3.2 Ndryshim dhe plotësim i Ligjit për Administratën Doganore (harmonizim me ndryshimet e LPP).	MF	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
	3.3 Ndryshim dhe plotësim i rregulloreve për sistematizimin dhe organizimin e Drejtorisë Doganore (harmonizim me ndryshimet e Ligjit për Procedurën Penale dhe Ligjit për Drejtorinë Doganore).	DD	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
4. Vendosja e detyrimit që nëpunësit doganorë të paraqesin deklaratë për gjendjen pasurore dhe interesat, si dhe për ndryshimet në gjendjen pasurore dhe interesat.	4.1 Ndryshim dhe plotësim i Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, në drejtim të saktësisht të dispozitës së nenit 83.	MD	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	4.2 Ndryshim dhe plotësim i Ligjit për Drejtorinë Doganore (harmonizim me Ligjin e ndryshuar për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit).	DD	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E realizuar	/	/	/

Problemi 3: Kompetenca të paqarta dhe të pasakta të përcaktuara, si dhe përputhje e kompetencave të inspektorateve

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	
1. Përcaktimi më i saktë dhe ndarja e kompetencave të shërbimeve të veçanta inspektuese.	1.1 Analizë e kompetencave ligjore të shërbimeve inspektuese.	KI	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	1.2 Ndryshim i ligjeve në të cilat, sipas analizës, janë identifikuar kompetenca të pasakta ose përputhje të tyre me inspektoratet e tjera.	Ministritë përkatëse	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar
Problemi 4: Veprim subjektiv dhe jo i duhur i inspektorëve gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Forcimi i integritetit të shërbimeve inspektuese.	1.1 Hartimi i metodologjisë për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në shërbimet inspektuese.	MSHIA	Gjysma e dytë e vitit 2021	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar
	1.2 Përgatitja e një analize të rreziqeve të korrupsionit në shërbimet inspektuese.	MSHIA	Gjysma e dytë e vitit 2021	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar	E realizuar	/
2. Të parashihet detyrimi që inspektorët të deklarojnë gjendjen pasurore dhe interesat pranë Këshillit Inspektues.	2.1 Ndryshim i ligjeve materiale që kanë të bëjnë me shërbimet inspektuese, me qëllim vendosjen e detyrimit për deklarimin e gjendjes pasurore dhe interesave.	MSHIA, KI, ministritë përkatëse	Gjysma e dytë e vitit 2021	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar
3. Përcaktimi i përgjegjësisë disiplinore për mosdeklarimin e gjendjes pasurore dhe interesave nga ana e inspektorëve.	3.1 Të plotësohen ligjet materiale për shërbimet inspektuese me përcaktimin e masave disiplinore për mosparaqitjen e deklaratave.	MSHIA, KI, ministritë përkatëse	Gjysma e dytë e vitit 2021	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar
Problemi 5: Mbikëqyrje e pamjaftueshme funksionale inspektuese në vetëqeverisjen lokale								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Forcimi i shërbimeve inspektuese në NJVL me inspektorë të autorizuar.	1.1 Zbatimi i një mbikëqyrjeje të vazhdueshme inspektuese nga Inspektorati Shtetëror Administrativ	ISHA	2021, në kontinuitet	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

	në NJVL lidhur me përmbushjen e detyrimit ligjor për punësimin e inspektorëve të autorizuar.							
Problemi 6: Personat përgjegjës ose udhëheqës të institucioneve nuk i zbatojnë rekomandimet e propozuara nga revizioni i brendshëm dhe Enti Shtetëror i Revizionit								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Të vendoset një sistem efikas për raportimin mbi (mos)zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të Entit Shtetëror të Revizionit, drejtuar organeve më të larta mbikëqyrëse dhe kontrolluese.	1.1 Ndryshim i Ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik.	MF	Gjysma e parë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	E realizuar	/
	1.2 Ndryshim i Ligjit për Revizionin Shtetëror.	MF	Gjysma e parë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
Problemi 7: Ndikimi i personave përgjegjës në institucionet publike mbi pavarësinë e auditimit të brendshëm								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Sigurimi i pavarësisë në punën e auditimit të brendshëm përmes formimit të një njësie të veçantë në Ministrinë e Financave.	1.1 Ndryshim i Ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik.	MF	Gjysma e parë e vitit 2023	E pamaturuar	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
	1.2 Ndryshim i aktit për organizimin dhe sistematizimin e Ministrisë së Financave.	MF	Gjysma e dytë e vitit 2023	E pamaturuar	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/

Për tejkalimin e **Problemit 1: Autorizimet diskrete të personave përgjegjës dhe mungesa e transparencës në punësime dhe avancime në MPB**, parashikohet **Masa 1. Vënia e transparencës në procedurën e punësimit dhe avancimit në MPB, përveç punësimeve të kryera sipas dispozitave të veçanta të Ligjit për Punët e Brendshme, dhe Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i Ligjit për Punët e Brendshme**, me afat realizimi gjysma e parë të vitit 2022, nën kompetencën e MPB-së. Ky aktivitet është „realizuar“ me miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Punët e Brendshme („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 89/22).

Masa 2. Të sigurohet transparencë të akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në MPB dhe publikimi i tyre në faqen e internetit të MPB-së, përveç vendeve të punës të kryera sipas dispozitave të veçanta të Ligjit për Punët e Brendshme, përfshin: **Aktivitetin 2.1: Deklasifikimi i akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në MPB, me afatin të realizimit në gjysmën e parë të vitit 2022, nën kompetencën e MPB-së**. Statusi përfundimtar i këtij aktiviteti është „i përealizuar“. Gjatë periudhës nga afati i këtij aktiviteti deri në vitin 2025, MPB nuk ka ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme për deklasifikimin e akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës. Në vitin 2025, Kuvendi miratoi një Ligj të ri për Punët e Brendshme („Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr. 160/25), me zbatim të shtyrë dhe në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare parashikon miratimin e disa akteve nënligjore, përfshirë akte për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në MPB-së. KSHPK rekomandon që gjatë miratimit të këtyre akteve, të merret parasysh përmbushja e obligimeve nga kjo masë.

Për **Problemin 2: Sistem joefikas për përcaktimin e përgjegjësisë profesionale në organet për zbatimin e ligjit**, është parashikuar **Masa 1: Themelimi i një njësie të veçantë organizative për kontrollin e brendshëm dhe standardet profesionale në DIF dhe DPF**, e cila përfshin dy aktivitete:

- **Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i Ligjit për Policinë Financiare, me afat për pjesën e dytë të vitit 2021**, nën kompetencën e MF. Statusi përfundimtar i këtij aktiviteti është „në zhvillim e sipër“, duke pasur parasysh që deri në dhjetor 2025 nuk ishte përfunduar procedura për miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Policinë Financiare.
- **Aktiviteti 1.2: Harmonizimi i akteve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në DIF dhe DPF**. Afati për këtë aktivitet ka qenë pjesa e dytë e vitit 2021, nën kompetencën e DPF. DPF raporton se me projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Policinë Financiare është parashikuar një dispozitë për themelimin e një njësie të veçantë për kontroll të brendshëm në Drejtorinë e Policisë Financiare. Projektligji është dërguar në MF për shqyrtim të mëtejshëm. DIF e ka realizuar këtë aktivitet në vitin 2022. Ky aktivitet vlerësohet, „në zhvillim e sipër“.

Masa 2. Përmirësimi i procesit të procedurave disiplinore në MPB përfshin një aktivitet: **Aktiviteti 2.1: Harmonizimi i akteve të brendshme me „Strategjinë për përmirësimin dhe avancimin e procedurave disiplinore 2020-2022“**, me afat realizimi pjesa e dytë e vitit 2021, nën kompetencën e MPB-së. Statusi përfundimtar i këtij aktiviteti është „në zhvillim e sipër“, duke pasur parasysh se gjatë periudhës nga viti 2021, MPB ka ndërmarrë vazhdimisht aktivitete për zbatimin e përcaktimeve strategjike të Ministrisë në fushën e procedurave disiplinore, por deri në dhjetor 2025 ato nuk janë përfunduar plotësisht.

Masa 3. Vendosja e statusit të policisë gjyqësore për të punësuarit në Sektorin për përgjegjësi profesionale pranë Drejtorisë Doganore (sipas Ligjit për Procedurën Penale, nenet 46 dhe 47), përfshin tre aktivitete:

- **Aktiviteti 3.1: Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Procedurën Penale, nen 47, paragrafi 2, duke përfshirë kompetencat e të punësuarve të policisë gjyqësore në DD edhe për veprat penale nga fusha e korrupsionit të kryera nga punonjësit e DD,** me afat realizimi **pjesa e dytë e vitit 2021**, nën kompetencën e MD. Statusi i këtij aktiviteti është „i përealizuar“, pasi ndryshimet e propozuara nuk u pranuan nga grupi punues për përgatitjen e Ligjit për Procedurën Penale, për shkak se ishin në kundërshtim me mekanizmin e kontrollit të jashtëm të policisë dhe organeve të zbatimit të ligjit.
- **Aktiviteti 3.2: Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Drejtorinë Doganore (harmonizimi me ndryshimin e LPP-së),** me afat realizimi **pjesa e dytë e vitit 2021**, nën kompetencën e MF. Statusi përfundimtar i këtij aktiviteti është „i përealizuar“, pasi është i kushtëzuar nga zbatimi i Aktivitetit 3.1.
- **Aktiviteti 3.3: Ndryshimi dhe plotësimi i Rregulloreve për sistematizimin dhe organizimin e Drejtorisë Doganore (harmonizimi me ndryshimin e LPP-së dhe LPD),** me afatin **pjesa e dytë e vitit 2021**, nën kompetencën e DD. Statusi i këtij aktiviteti është „i përealizuar“, pasi gjithashtu është i lidhur me Aktivitetin 3.1.

Masa 4. Vendosja e detyrimit për të punësuarit në doganë të paraqesin deklaratë për pasurinë dhe interesat dhe për çdo ndryshim në pasuri dhe interesa, përfshin dy aktivitete:

- **Aktiviteti 4.1: Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit për saktësimin e nenit 83,** me afat realizimi **gjysmën e parë të vitit 2022**, nën kompetencën e MD. Statusi përfundimtar është „në zhvillim e sipër“. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave ka qenë në procedurë qeveritare deri në dhjetor 2025.
- **Aktiviteti 4.2: Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Drejtorinë Doganore (harmonizimi me ndryshimin e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit),** me afat realizimi **pjesa e dytë e vitit 2022**, nën kompetencën e MF. Ky aktivitet është „realizuar“ brenda afatit të parashikuar.

Për Problemin 3: Kompetenca të paqarta dhe të pasakta dhe përputhje e kompetencave midis inspektorateve, është parashikuar **Masa 1: Saktësimi dhe ndarja e kompetencave të shërbimeve të veçanta inspektuese,** me dy aktivitete:

- **Aktiviteti 1.1: Analiza e kompetencave ligjore të shërbimeve inspektuese,** me afat realizimi **në gjysmën e parë të vitit 2022**, nën kompetencën e KI. Statusi përfundimtar është „në zhvillim e sipër“, pasi nga gjithsej 28 shërbime inspektuese, gjatë periudhës raportuese vetëm 18 shërbime inspektuese kanë dorëzuar të dhëna tek KI, prej të cilave 13 kanë identifikuar përputhje në rregullore, ndërsa 5 shërbime inspektuese nuk kanë identifikuar përputhje të rregulloreve sipas të cilave veprojnë.
- **Aktiviteti 1.2: Ndryshimi i ligjeve ku, sipas analizës, janë identifikuar kompetenca të pasakta ose përputhje me inspektorate të tjera, me afatin pjesa e dytë e vitit 2022,** nën kompetencën e ministrive pëkatëse. Për arsye se në planin Aksional të Strategjisë për këtë aktivitet nuk është përcaktuar institucioni përgjegjës, i njejtë është shënuar si „i përealizuar“.

Problemi 4: Veprim subjektiv dhe i papërshtatshëm i inspektorëve gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, përfshin tre masa. **Masa 1: Forcimi i integritetit të shërbimeve inspektuese i cili e parashikon Aktivitetin 1.1: Hartimi i një metodologjie për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni në shërbimet inspektuese,** me afat realizimi **pjesa e dytë e vitit 2021**, nën kompetencën e MSHIA(MAP). Statusi përfundimtar i këtij aktiviteti është „i përealizuar“. MAP ka raportuar vazhdimisht se aktiviteti është realizuar, duke u bazuar në faktin se në shërbimet inspektuese mbikëqyrja inspektuese bazohet në vlerësimin e rrezikut sipas Ligjit për mbikëqyrjen inspektuese. Pas zbatimit të analizës së raporteve, KSHPK ka

konstatuar se dispozitat e Ligjit për mbikëqyrjen inspektuese lidhen me hartimin e metodologjisë së vlerësimit të rrezikut gjatë përgatitjes së planit vjetor të punës së shërbimit inspektues, ndërsa metodologjia për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni e parashikuar me Aktivitetin 1.1 të kësaj mase është e ndryshme nga metodologjitë që shërbimet inspektuese kanë miratuar sipas Ligjit për mbikëqyrjen inspektuese.

Aktiviteti 1.2: Përgatitja e analizës së rreziqeve nga korrupsioni në shërbimet inspektuese, me afat realizimi për vitin 2021, nën kompetencën e MAP, është shënuar si e „realizuar“, edhe pse nuk ndjek rrugën e aktiviteteve të parashikuara në kuadër të kësaj mase. Konkretisht, në kuadër të Projektit të USAID për pjesëmarrje qytetare, aktiviteti – Ndhimë teknike për reformat inspektuese – përfshiu hartimin e dokumentit „Analiza e pikave të nxehta potenciale për korrupsion në punën e shërbimeve inspektuese“. Ky dokument identifikoi pika korruptive në tre inspektorate të zgjedhura (Inspektorati Shtetëror për Mbrojtjen e Mjedisit, Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor dhe Inspektorati Shtetëror i Tregut), dhe mbi bazën e të dhënave të mbledhura u përgatit një listë e „pikave të nxehta“ për korrupsion në mbikëqyrjen inspektuese në nivel kombëtar në Maqedoninë e Veriut, duke përfshirë rekomandime për tejkalimin e tyre në të gjitha shërbimet inspektuese.

Masa 2: Të përshkruhet detyrimi që inspektorët të paraqesin pasurinë dhe interesat te Këshilli Inspektues, parasheh **Aktiviteti 2.1: Ndryshimi i ligjeve materiale që lidhen me shërbimet inspektuese për të vendosur detyrimin për paraqitjen e pasurisë dhe interesave**, me afat realizimi **pjesa e dytë e vitit 2021**, nën kompetencën e MSHIA(MAP). Statusi përfundimtar është „i parealizuar“. Në vitin 2025 u miratua Ligji i ri për mbikëqyrjen inspektuese („Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr. 135/25), i cili hyn në fuqi më 1 janar 2026. As në ligjin e mëparshëm, as në ligjin e ri nuk janë parashikuar dispozita për vendosjen e detyrimit që inspektorët të raportojnë pasurinë dhe interesat.

Masa 3: Vendosja e përgjegjësisë disiplinore për mosparaqitjen e pasurisë dhe interesave nga inspektorët, njëashtu përfshin një **Aktivitet 3.1: Të plotësohen ligjet materiale të shërbimeve inspektuese për të parashikuar masa disiplinore për mosdorëzimin e deklaratave**, me afat realizimi në **pjesën e dytë të vitit 2021**, nën kompetencën e MSHIA(MAP). Ma status përfundimtarë „i parealizuar“. Ky aktivitet është i kushtëzuar nga zbatimi i Aktivitetit 2.1 të Masës 2.

Për tejkalimin e **Problemit 5: Mbikëqyrje jo e mjaftueshëm inspektuese funksionale në vetëqeverisjen lokale**, parashikohet **Masa 1: Forcimi i shërbimeve inspektuese në NJVL-të me inspektorë të autorizuar dhe Aktiviteti 1.1: Kryerja e mbikëqyrjes së vazhdueshme inspektuese nga Inspektorati Shtetëror Administrativ në NJVL-të lidhur me përmbushjen e detyrimit ligjor për punësimin e inspektorëve të autorizuar**, me afat realizimi **për vitin 2021** në kontinuitet, nën kompetencën e ISHA e cila për pesë vite ka patur statusin „i realizuar“.


Problemi 6: Personat përgjegjës ose drejtuesit e institucioneve nuk zbatojnë rekomandimet e propozuara nga revizioni i brendshëm dhe ESHR, adresohet me **Masën 1: Të vendoset e një sistemi efikas për raportimin e mos/zbatimit të rekomandimeve nga revizioni i brendshëm dhe ESHR tek organet më të larta mbikëqyrëse dhe kontrolluese**, me dy aktivitete:

- **Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i Ligjit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik**, me afat realizimi në **gjysmën e parë të vitit 2021**, nën kompetencën e MF. Ky aktivitet është „realizuar“ në vitin 2025, me miratimin e Ligjit për sistemin e kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 255/24).

- **Aktiviteti 1.2: Ndryshimi i Ligjit për Revizionin Shtetëror**, me afat realizimi në gjysmën e parë të vitit 2021, nën kompetencën e MF. Ky aktivitet ka statusin „në zhvillim e sipër“, pasi projektligji për auditimin shtetëror është në koordinim ndërsektorial në MF dhe nuk është finalizuar.


Për Problemin 7: Ndikimi i personave përgjegjës në institucionet publike mbi pavarësinë e revizionit të brendshëm, parashikohet: **Masa 1: Sigurimi i pavarësisë në punën e revizionit të brendshëm përmes krijimit të një njësie të veçantë në Ministrinë e Financave**, me dy aktivitete.

- **Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i Ligjit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik**, nën kompetencën e MF, me afat realizimi në gjysmën e parë të vitit 2023. Sipas raportit, ky aktivitet është „realizuar“, gjegjësisht në vitin 2025 është miratuar Ligji i ri për sistemin e kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik.
- **Aktiviteti 1.2: Ndryshimi i aktit për organizimin dhe sistematizimin e Ministrisë së Financave**, nën kompetencën e MF, me afat realizimi në pjesën e dytë të vitit 2023. Ky aktivitet është „realizuar“ me zbatimin e Aktivitetit 1.1.




Fotografia 16: Shkalla e përgjithshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 21 aktivitete të parashikuara për këtë sektor, 20 aktivitete janë planifikuar të realizohen njëheri, ndërsa 1 aktivitet është planifikuar të realizohet në kontinuitet për periudhën 2021-2025, që do të thotë se për këtë periudhë pesëvjeçare janë vlerësuar gjithsej 25 aktivitete. Nga këto, 11 aktivitete janë realizuar (44%), 8 janë të përealizuara (32%), dhe 6 janë në zhvillim e sipër (24%).



Fotografia 17: Statusi i realizimit të aktiviteteve sipas viteve



Fotografia 18: Statusi i aktiviteteve sipas institucioneve

- Për MAP janë parashikuar 4 aktivitete, prej të cilave një është realizuar, ndërsa tre janë të porealizuara.
- Për MPB-në janë parashikuar 3 aktivitete, prej të cilave një është realizuar, një është e porealizuar, dhe një është në zhvillim e sipër.
- Për MD janë parashikuar 2 aktivitete, prej të cilave një është i porealizuar, dhe një është në zhvillim e sipër.
- Për KI është parashikuar një aktivitet, i cili është në zhvillim e sipër.
- MF ka gjithsej 6 aktivitete, prej të cilave 3 janë realizuar, një është e porealizuar, dhe 2 aktivitete janë në zhvillim e sipër.
- Ministritë kanë një aktivitet, i cili është i porealizuar.
- ISHA ka 5 aktivitete të realizuara.
- DPF ka një aktivitet në zhvillim e sipër.

- DD ka 2 aktivitete, prej të cilave një është realizuar dhe tjetri i parealizuar.

8. SEKTORI I SHËNDETËSISË

Përshkrim i sektorit

Në lidhje me sektorin e shëndetësisë, në Strategji janë identifikuar pesë probleme kryesore:

- 1) Nuk ekzistojnë kritere efektive për përcaktimin e kompensimeve kontraktuale (limitet/buxhetet) për institucionet shëndetësore (ISHP dhe ISHPPr) dhe për çmimet e shërbimeve shëndetësore dhe barnave, as për përcaktimin dhe shpërndarjen transparente të buxhetit të destinuar për institucionet shëndetësore, teknologjitë e reja dhe barnat, apo metodat e ofrimit të shërbimeve shëndetësore;
- 2) Subjektivizëm në zgjedhjen e barnave që mbulohen nga fondet publike, domethënë nga kontributet për sigurimin shëndetësor të qytetarëve, ndërsa rregullativa për mjekësinë e bazuar në prova nuk zbatohet në mënyrë të qëndrueshme;
- 3) Keqpërdorime në procedurat për dhënien/marrjen e donacioneve, studimeve klinike dhe projekteve;
- 4) Praktika joetike në marketingun e barnave;
- 5) Vendimmarrje transparente dhe objektive në procedurat për trajtim jashtë vendit.

Për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara për tejkalimin e problemeve në sektorin e shëndetësisë, janë kompetente institucionet e mëposhtme:

- 1) MSH
- 2) Fondi për Sigurim Shëndetësor (në tekstin e mëtejshëm: FSSH),
- 3) Agjencia për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore (në tekstin e mëtejshëm: MALMED),
- 4) Dhoma e Mjekëve (në tekstin e mëtejshëm: DHM),
- 5) Institucionet Shëndetësore (në tekstin e mëtejshëm: ISH).

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në sektorin e shëndetësisë

Në sektorin e shëndetësisë, për tejkalimin e pesë problemeve prioritare janë parashikuar 18 masa dhe 26 aktivitete, prej të cilave 25 aktivitete janë të njëherëshme, ndërsa një aktivitet është planifikuar të zbatohet në kontinuitet nga viti 2022 deri në 2025, me çrast numri total i aktiviteteve të vlerësuara për periudhën pesëvjeçare është 29. Në bazë të analizës së kryer të raporteve vjetore, gjendja me realizimin e aktiviteteve është si vijon:

Problemi 1: Nuk ekzistojnë kritere efektive për përcaktimin e kompensimeve kontraktuale (limite/buxhete) për institucionet shëndetësore (publike dhe private) dhe për çmimet e shërbimeve shëndetësore dhe barnave, si dhe nuk ekzistojnë kritere për përcaktimin dhe shpërndarjen transparente të buxhetit të dedikuar për institucionet shëndetësore, teknologjitë e reja, barnat dhe metodat për shërbime shëndetësore.								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosja e kritereve efektive për shpërndarjen e buxhetit të FSSH-së sipas shërbimeve shëndetësore dhe institucioneve shëndetësore.	1.1. Përgatitja e një analize të rregullativës ekzistuese për shpërndarjen e buxhetit të FSSH-së sipas shërbimeve shëndetësore dhe institucioneve shëndetësore.	FSSHRMV	Gjysma e dytë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
	1.2. Ndryshim i Rregullores për përcaktimin e kritereve për përcaktimin e kompensimit kontraktual, në drejtim të vendosjes së kritereve të matshme dhe relevante që do të ndikojnë drejtpërdrejt në lartësinë e kompensimit kontraktual.	FSSHRMV	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E realizuar	/	/
2. Forcimi i kapaciteteve të Fondit për planifikim, analitikë dhe ekonomi shëndetësore, me theks të veçantë në metodologjinë për vlerësimin e teknologjive shëndetësore (HTA).	2.1. Formimi i një Sektori për Analitikë / Zhvillim / Ekonomi Shëndetësore në FSSH.	FSSHRMV	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
3. Sigurimi i një mënyre inkluzive të shpërndarjes së buxhetit sipas niveleve dhe fushave të kujdesit shëndetësor nga një organ i pavarur (shoqatë, asociacion etj.), me përfaqësues	3.1 Formimi i një organi të pavarur (shoqatë, asociacion etj.) me përfaqësues nga institucionet shëndetësore, i cili do të përfaqësojë dhe mbrojë interesat e të gjitha institucioneve shëndetësore dhe do të marrë pjesë në negociatat për përcaktimin e buxheteve të tyre.	FSSHRMV, MSH, ISH	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

nga institucionet shëndetësore.	3.2. Shpërndarja vjetore e buxhetit shëndetësor – në total sipas niveleve dhe fushave të kujdesit shëndetësor, si dhe individualisht për secilën institucion shëndetësor.	FSSHRMV, MSH, ISH	Gjysma e dytë e vitit 2022, në kontinuitet	E pamaturuar	E parealizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar
4. Digjitalizim dhe ndërlidhja e menaxhmentit financiar dhe kontabilist të ofruesve të shërbimeve shëndetësore.	4.1. Formimi i një sistemi elektronik me bazë të dhënash (softuer) për të gjitha shpenzimet për materiale, paga, barna, pajisje dhe shpenzime të tjera të institucioneve shëndetësore, si bazë për përcaktimin e çmimeve reale të shërbimeve, si dhe për nevojën e rishikimit të tyre.	FSSHRMV	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
5. Përmirësimi i rregullativës dhe transparencës së procesit të përcaktimit të çmimeve referente të shërbimeve shëndetësore dhe barnave.	5.1. Përgatitja/rishikimi i rregulloreve për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve shëndetësore dhe barnave.	FSSHRMV	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
	5.2. Përfshirja e dispozitave për “Marrëveshje për ndarjen e rrezikut” (ang. Managed Entry Agreements) për barna që kanë pozitë monopoliste në treg, ndryshim në Ligjin për sigurim shëndetësor dhe ndryshim në Rregulloren për listën pozitive të barnave dhe në Rregulloren për çmimet referente të barnave.	FSSHRMV MSH	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E realizuar	/	/
	5.3. Miratimi i procedurave për negociimin e çmimeve me institucionet shëndetësore dhe kompanitë farmaceutike, të cilat do të bazohen në parimin e transparencës.	FSSHRMV	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
6. Vendosja e një sistemi për përcaktimin e “standardit” dhe “mbi-standardit” të materialeve të përfshira në shërbimet shëndetësore.	6.1. Hartimi i akteve nënligjore me të cilat do të përcaktohen standardi dhe mbi-standardi i shërbimeve, materialeve, ndihmave etj.	FSSHRMV Msh	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
7. Zbatimi i kontrolleve dhe	7.1. Përfshirja e kontrolleve të rregullta dhe të jashtëzakonshme	FSSHRMV MSH	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

revizioneve të brendshme të procesit të përcaktimit të çmimeve të barnave dhe zbatimit të saktë të metodologjive.	në procesin dhe metodologjitë për përcaktimin e çmimeve unike të barnave në Ministrinë e Shëndetësisë dhe çmimeve referente të barnave në FSSH RMV.							
8. Vendosja e transparencës dhe procedurës në procesin e miratimit dhe shpërndarjes së buxhetit të FSSH-së drejt institucioneve shëndetësore.	8.1. Miratimi i një rregulloreje për mënyrën dhe procedurën e miratimit dhe shpërndarjes së buxhetit.	FSSHRMV	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E realizuar	/	/
	8.2. Vendosja e detyrimit për publikimin e buxheteve të FSSH-së.	FSSHRMV	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
9. Vendosja dhe mirëmbajtja e një sistemi të indikatorëve të matshëm dhe transparentë të performancës për institucionet shëndetësore.	9.1. FSSHRMV dhe MSH në sistematizim të përcaktojnë një njësi organizative përgjegjëse për vendosjen e një sistemi për monitorimin e indikatorëve të performancës së institucioneve shëndetësore; të përcaktohet një procedurë për komunikim me institucionet shëndetësore; të mundësohet publikimi dhe ndjekja online e indikatorëve të performancës.	FSSHRMV, MSH me „Termini im“ Dhe ISH	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
10. Rishikimi vjetor i çmimeve të shërbimeve shëndetësore dhe barnave.	10.1 Në metodologjinë për përcaktimin e çmimeve referente të shërbimeve shëndetësore të përcaktohen afate për rishikim të plotë të çmimeve, të paktën njëheri në vit, duke ndjekur elementet kalkulative që marrin pjesë në formimin e çmimeve.	FSSHRMV Institucionet Shëndetësore	Gjysma e dytë e vitit 2023	E pamaturuar	E pamaturuar	E realizuar	/	/
Problemi 2: Subjektivizëm në përzgjedhjen e barnave që mbulohen nga mjetet publike, përkatësisht nga kontributet për sigurimin shëndetësor të qytetarëve, ndërsa rregullativa për mjekësinë e bazuar në prova nuk zbatohet në mënyrë të qëndrueshme								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosja e një kornize ligjore për përzgjedhjen e barnave që do të mbulohen nga	1.1. Përcaktimi i kriterëve për përzgjedhjen e barnave që mbulohen nga FSSHRMV.	MSH FSSHRMV	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/	/

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

buxheti shtetëror, e cila do të jetë e unifikuar dhe do të vlejë për të gjitha barnat.	1.2. Miratimi i Rregullores për listën pozitive të barnave në bazë të metodologjisë së “Vlerësimit të Teknologjive Shëndetësore” (Health Technology Assessment - HTA).	MSH FSSHRMV	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/	/
	1.3. Përfshirja e dispozitave për “Marrëveshje për ndarjen e rrezikut” (ang. Managed Entry Agreements) për barnat që kanë pozitë monopoliste në treg, në rregullativën ligjore, në Rregulloren për listën pozitive të barnave dhe në Rregulloren për çmimet referente të barnave.	MSH FSSHRMV	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar	/	/
2. Sigurimi i transparencës në zbatimin e programeve të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat përfshijnë edhe sigurimin e barnave.	2.1. Publikimi i listës së barnave që mbulohen nga programet e Ministrisë së Shëndetësisë, së bashku me kriteret mbi të cilat është bërë përzgjedhja.	MSH	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
3. Zbatim i qëndrueshëm i parimeve të mjekësisë së bazuar në prova.	3.1. Përditësimi i udhëzimeve për praktikimin e mjekësisë së bazuar në prova, në kuadër të procedurës së parashikuar me ligj.	MSH Odat Shoqatat profesionale FSSHRMV	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	3.2. Miratimi i udhëzimeve për mjekësinë e bazuar në prova për fushat ku ato nuk ekzistojnë.	MSH Odat Shoqatat profesionale FSSHRMV	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar
Problemi 3: Keqpërdorime në procedurat e dhënies/pranimit të donacioneve, studimeve klinike dhe projekteve.								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Të saktësohen karakteristikat, kushtet dhe mënyra e pranimit të donacioneve nga institucionet shëndetësore publike (ISHP).	1.1. Hartimi i aktit nënligjor për pranimin e donacioneve.	MSH Agjencia e barnave	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

2. Vendosja e një Regjistri publik të donacioneve për barna, pajisje dhe studime klinike.	2.1. Hartimi i një regjistri.	MSH Agjencia e barnave	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar
Problemi 4: Praktika joetike në marketingun e barnave								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Rregullimi dhe monitorimi i marrëdhënieve ndërmjet kompanive farmaceutike dhe mjekëve në lidhje me marketingun e barnave.	1.1. Miratimi i një kodi etik për sjelljen e të gjithë aktorëve gjatë marketingut të barnave.	MALMED Oda e Mjekëve	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E realizuar	/	/	/
2. Në nivel spitalor, të krijohet një sistem i “Komiteteve Terapeutike” dhe “Regjistrave të Barnave Spitalore”.	2.1. Të miratohen ndryshime ligjore dhe akte nënligjore për vendosjen e detyrimit për krijimin e sistemeve të “Komiteteve Terapeutike” dhe “Regjistrave të Barnave Spitalore” në të gjitha spitalet e vendit.	MSH ISHP	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër
Problemi 5: Transparenca dhe objektiviteti në procesin e vendimmarrjes për trajtimin jashtë shtetit.								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Përcaktimi i spitaleve referuese përmes kriterëve të qarta të përcaktuara në akte nënligjore.	1.1. Ndryshim i akteve për përcaktimin e kriterëve.	FSSHRMV	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E realizuar	/	/	/

Për tejkalimin e **Problemit 1: Nuk ekzistojnë kritere efektive për përcaktimin e kompensimeve të kontraktuara (limitet/buxhetet) për institucionet shëndetësore (ISHP dhe IPSH) dhe për çmimet e shërbimeve shëndetësore dhe barnave, dhe as për përcaktimin dhe shpërndarjen transparente të buxhetit të dedikuar për institucionet shëndetësore, teknologjitë e reja dhe barnat**, parashikohet: **Masa 1: Vendosja e kriterëve efektive për shpërndarjen e buxhetit të FSSH sipas shërbimeve dhe institucioneve shëndetësore**, me dy aktivitete:

- **Aktiviteti 1.1: Hartimi i një analize të rregullativës ekzistuese për shpërndarjen e buxhetit të FSSHRMV-së sipas shërbimeve dhe institucioneve shëndetësore**, me afat realizimi në **gjysmën e dytë të vitit 2021** dhe kompetencën e FSSHRMV. Ky aktivitet është „realizuar“ brenda afatit të parashikuar.
- **Aktiviteti 1.2: Ndryshimi i Rregullores për përcaktimin e kriterëve të kompensimit të kontraktuar në mënyrë që të vendosen kritere të matshme dhe të rëndësishme që ndikojnë direkt në nivelin e kompensimit të kontraktuar**, me afat realizimi në **gjysmën e parë të vitit 2022** dhe nën kompetencën e FSSHRMV-së. Ky aktivitet është „realizuar“ gjatë vitit 2023. Më saktësisht, më 23.08.2023 u miratua Vendimi i ri për përcaktimin e kriterëve për kompensimet kontraktuale të institucioneve shëndetësore („Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr. 206/2023), ku janë përcaktuar kritere të përgjithshme dhe të veçanta për përcaktimin e kompensimit kontraktual për institucionet shëndetësore.

Masa 2: Forcimi i kapaciteteve të FSSH-së për planifikim, analizë dhe ekonomi shëndetësore, me theks të veçantë në metodologjinë për Vlerësimin e Teknologjive Shëndetësore (HTA). parasheh Aktivitetin 2.1: Formimi i Sektorit për analizë / zhvillim / ekonomi shëndetësore në FSSHRMV. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, nën kompetencën e FSSHRMV. Ky aktivitet është „i porealizuar“, pasi FSSHRMV njofton se nuk është realizuar për arsye objektive, kryesisht mungesë e stafit të kualifikuar dhe largimi i tij drejt sektorit privat. Ky lloj stafi shumë i specializuar për ekonominë shëndetësore prodhohet shumë pak përmes arsimit formal (vetëm në Fakultetin e Farmacisë për barnat), ndërsa për shërbimet shëndetësore nuk ekziston fare.

Masa 3: Sigurimi i një mënyre gjithëpërfshirëse të shpërndarjes së buxhetit sipas niveleve dhe fushave të kujdesit shëndetësor nga një organ i pavarur (shoqatë, asociacion etj.) me përfaqësues nga institucionet shëndetësore (ISH), përmban dy aktivitete:

- **Aktiviteti 3.1: Formimi i një organi të pavarur (shoqatë, asociacion etj.) me përfaqësues nga ISH që do të përfaqësojë dhe mbrojë interesat e të gjitha ISH dhe do të marrë pjesë në negociatat për përcaktimin e buxheteve të ISH.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, nën kompetencën e FSSHRMV, dhe statusi përfundimtar është „në zhvillim e sipër“, deri në formimin përfundimtar të këtij organi të pavarur.
- **Aktiviteti 3.2: Shpërndarja vjetore e buxhetit shëndetësor – gjithsej sipas niveleve dhe fushave të kujdesit shëndetësor, por edhe individualisht për çdo ISH**, me afat realizimi në **gjysmën e dytë të vitit 2022 në kontinuitet**, nën kompetencën e FSSHRMV. Ky aktivitet për periudhën 2023-2025 realizohet vazhdimisht, sipas Rregullores për shpërndarjen e mjeteve nga buxheti i Fondit për Sigurim Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr. 206/23).

Masa 4: Digjitalizimi dhe lidhja e menaxhmentit financiar kontabilist të ofruesve të shërbimeve shëndetësore, është masa e katërt dhe e njëjta parasheh Aktivitetin 4.1: Formimi i një sistemi elektronik me bazë të dhënash (software) për të gjithë shpenzimet për materiale, paga, barna, pajisje dhe shpenzime të tjera të ISH, si bazë për përcaktimin e çmimeve reale për shërbime dhe nevojën për revidim. Afati për realizimin e këtij aktiviteti është **gjysma e parë e vitit 2022**, nën kompetencën e FSSHRMV. Statusi përfundimtar i këtij aktiviteti është „**në zhvillim e sipër**“, pasi FSSHRMV në Planet Vjetore për Prokurime Publike për vitet 2023, 2025 dhe 2026 ka parashikuar prokurimin e këtij softueri, por për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, është kërkuar mbështetje donatore për prokurimin e tij.

Masa 5: Përmirësimi i rregullativës dhe transparencës në procesin e përcaktimit të çmimeve referente për shërbimet shëndetësore dhe barnat, përfshin tre Aktiviteti:

- **Aktiviteti 5.1: Hartimi/ri-vlerësimi i rregulloreve për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve shëndetësore dhe barnave.** Afati për realizim a këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, nën kompetencën e FSSHRMV. Ky aktivitet është „**realizuar**“ në 2024, me miratimin e Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën dhe metodologjinë e përcaktimit të çmimeve referente të barnave („Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.5/2024).
- **Aktiviteti 5.2: Përfshirja e dispozitave për „Marrëveshje për ndarjen e rrezikut“ (ang. Managed entry agreements) për barnat që kanë pozicion monopol në treg, ndryshim në Ligjin për sigurimin shëndetësor dhe ndryshim në Rregulloren për listën pozitive të barnave dhe në Rregulloren për çmimet referente të barnave.** Afati për realizim e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, nën kompetencën e FSSHRMV, dhe ky aktivitet është „**realizuar**“ në 2023.
- **Aktiviteti 5.3: Miratimi i procedurave për negociimin e çmimeve me ISH-të dhe kompanitë farmaceutike, bazuar në parimin e transparencës.** Afati për realizim ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, nën kompetencën e FSSHRMV. Ky aktivitet është „**realizuar**“ në 2024, me miratimin e akteve nënligjore të publikuara në „Gazetën Zyrtare e RMV-së“ nr. 206/23 dhe nr. 77/23, ku është eliminuar negociimi direkt me kompanitë farmaceutike, dhe për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve shëndetësore, komisioni për çmimet referente përfshin institucionet shëndetësore. Gjithashtu, është miratuar një Rregullore dhe metodologji e re për përcaktimin e çmimeve referente të shërbimeve shëndetësore për kujdesin primar, specialistiko-konsultativ dhe spitalor („Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.5/24).

Masa 6: Vendosja e një sistemi për përcaktimin e materialeve “standarde” dhe “mbi-standarde” që përfshihen në shërbimet shëndetësore ka paraparë Aktivitetin 6.1: Hartimi i legjislacionit nënligjor për të përcaktuar standardin dhe mbi-standardin e shërbimeve, materialeve dhe mjeteve ndihmëse. Afati i realizimit për këtë aktivitet ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, nën përgjegjësinë e FSSHRMV, dhe statusi i tij përfundimtar është “**në zhvillim e sipër.**”

Masa 7: Zbatimi i kontrolleve dhe revizioneve të brendshme të procesit të përcaktimit të çmimeve të barnave dhe përdorimit të saktë të metodologjive është paraparë Aktiviteti 7.1: Përfshirja e kontrolleve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të procesit dhe metodologjive për përcaktimin e çmimeve unike të barnave në MSH dhe çmimeve referente të barnave në FSSHRMV. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, dhe statusi i tij përfundimtar është “**në zhvillim e sipër.**” Njësia për kontroll të brendshëm dhe njësia për revizion të brendshëm pranë FSSHRMV kanë kryer kontroll mbi procesin e

përcaktimit të çmimeve referente dhe zbatimin e saktë të metodologjisë për përcaktimin e çmimeve referente të barnave në FSSHRMV. Duke qenë se ky kontroll është kryer në bazë të detyrimit nga Strategjia Kombëtare dhe përbën një kontroll ad hoc, ndërsa vetë Aktiviteti parashikon vëmtosjen e kontrolleve të rregullta dhe të jashtëzakonshme, ky Aktivitet nuk mund të konsiderohet si realizuar plotësisht.

Masa 8: Vendosja e transparencës dhe procedurës në procesin e miratimit dhe shpërndarjes së buxhetit të FSSH për ISH përfshin dy Aktivitete:

- **Aktiviteti 8.1: Miratimi i një rregulloreje për mënyrën dhe procedurën e miratimit dhe shpërndarjes së buxhetit**, me afat realizim në gjysmën e parë të vitit 2022, nën përgjegjësinë e FSSHRMV. Ky aktivitet është **realizuar** në vitin 2023.
- **Aktiviteti 8.2: Vendosja e detyrimit për publikimin e buxheteve të FSSHRMV**, me afat realizim në gjysmën e parë të vitit 2022, nën përgjegjësinë e FSSHRMV. Ky aktivitet është **realizuar** në vitin 2024.

Masa 9: Vendosja dhe mirëmbajtja e një sistemi të indikatorëve të matshëm dhe transparentë për suksesin e ISH përfshin Aktivitetin 9.1: FSSH dhe MSH, në Sistematizim, duhet të caktojë një njësi organizative përgjegjëse për vendosjen e sistemit për monitorimin e indikatorëve të suksesit të ISH; të përcaktohet procedura për komunikim me ISH; të mundësohet publikimi dhe monitorimi online i indikatorëve të suksesit. Afati për realizimin e këtij aktiviteti është **gjysma e parë e vitit 2022**, nën përgjegjësinë e FSSHRMV. Ky aktivitet është **“në zhvillim e sipër”**, pasi FSSHRMV ka vendosur monitorimin e performancës së punës së institucionit shëndetësor në mënyrë tremujore për kujdesin shëndetësor specialistik-konsultativ duke përdorur disa indikatorë, të cilët nuk janë publikuar.

Masa 10: Revizioni vjetor i çmimeve të shërbimeve shëndetësore dhe barnave përfshin Aktivitetin 10.1: Në metodologjinë për përcaktimin e çmimeve referente të shërbimeve shëndetësore të përcaktohen afatet për rishikimin e plotë të çmimeve, të paktën njëheri në vit, duke ndjekur elementët kalkulativë që ndikojnë në formimin e çmimeve. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2023**, dhe e njëjta është nën përgjegjësinë e FSSHRMV. Ky aktivitet është **“realizuar”** brenda afatit të caktuar.

Për sa i përket **Problemit 2: Subjektivizmi në përzgjedhjen e barnave që mbulohen nga fondet publike, dmth nga kontributet e sigurimeve shëndetësore të qytetarëve, dhe zbatimi jo i qëndrueshëm i rregullave për mjekësinë e bazuar në prova**, parashikon **Vendosjen e një kuadri ligjor për përzgjedhjen e barnave që do të mbulohen nga buxheti shtetëror, i cili do të jetë i unifikuar dhe i zbatueshëm për të gjitha barnat, dhe përfshin tre aktivitete:**

- **Aktiviteti 1.1: Përcaktimi i kriterëve për përzgjedhjen e barnave të mbuluara nga FSSHRMV.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, me përgjegjësi të MSH. Ky aktivitet është **“realizuar”** në vitin 2023.
- **Aktiviteti 1.2: Miratimi i Rregullores për listën pozitive të barnave bazuar në Metodologjinë e “Vlerësimit të Teknologjive Shëndetësore” (Health Technology Assessment - HTA).** Afati për këtë aktivitet ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, me përgjegjësi të MSH. Ky aktivitet gjithashtu është **“realizuar”** gjatë vitit 2023.
- **Aktiviteti 1.3: Përfshirja e dispozitave për “Marrëveshje të ndarjes së rrezikut” (Managed Entry Agreements) për barnat që kanë një pozicion monopol në treg, në rregulloren ligjore, në Rregulloren për listën pozitive të barnave dhe në Rregulloren**

për çmimet referente të barnave. Afati për këtë aktivitet *ka qenë gjysma e dytë e vitit 2021*, dhe bartës është MSH. Ky aktivitet është **“realizuar”** në vitin 2023.

Masa 2: Sigurimi i transparencës në zbatimin e programeve të MSH, përfshirë edhe sigurimin e barnave, parashikon Aktivitetin 2.1: **Publikimi i listës së barnave që mbulohen nga programet e MSH, së bashku me kriteret mbi bazën e të cilave është bërë përzgjedhja.** Afati për këtë aktivitet *ka qenë gjysma e parë e vitit 2021*, dhe përgjegjës është MSH. Ky aktivitet ka statusin përfundimtar **“i porealizuar”**. Gegjesisht MSH raporton se në seksionin “Raportet vjetore për zbatimin e programeve dhe buxhetit” në faqen e saj zyrtare publikohen të dhëna për Programin e trajtimit të personave me sëmundje të rralla, të cilat përfshijnë: tabelë me barnat e blera përmes programit, duke treguar emrin gjenetik dhe tregtar të barnës, formën farmaceutike, dozën dhe emrin e furnizuesit; listën e institucioneve publike shëndetësore ku janë shpërndarë barnat; numrin e personave që kanë përdorur terapinë me diagnozat përkatëse; numrin e personave në regjistrin për sëmundjet e rralla sipas diagnozave dhe realizimin buxhetor të aktiviteteve të financuara nga buxheti bazë i Ministrisë së Shëndetësisë dhe nga buxhetet e aktiviteteve vetë-financuese. Pas verifikimit të faqes së MSH, <https://zdravstvo.gov.mk/mk-MK/dokumenti/izvestaj>, është konstatuar se janë publikuar raportet vjetore për realizimin e programeve shëndetësore sipas viteve. Megjithatë, duke marrë parasysh se ky aktivitet kërkon publikimin e listës së barnave të mbuluara nga programet e Ministrisë së Shëndetësisë së bashku me kriteret mbi bazën e të cilave është bërë përzgjedhja e tyre, këto të dhëna nuk janë të disponueshme publikisht në raportet e përmendura. Për këtë arsye, ky aktivitet mbetet **“i porealizuar”**.

Masa 3: Zbatimi i qëndrueshëm i parimeve të mjekësisë bazuar në prova parashikon dy aktivitete.

- **Aktiviteti 3.1: Përditësimi i udhëzimeve për praktikimin e mjekësisë bazuar në prova brenda procedurës së parashikuar ligjërisht,** me afat për realizim në **gjysmën e dytë e vitit 2021**, dhe përgjegjësi të MSH. MSH raporton se aktiviteti po realizohet vazhdimisht, por duke marrë parasysh që gjatë gjithë periudhës pesëvjeçare është përditësuar vetëm një udhëzim nga 12 udhëzime të reja të miratuara, ky aktivitet vlerësohet me statusin **“në zhvillim e sipër”**.
- **Aktiviteti 3.2: Miratimi i udhëzimeve për mjekësi bazuar në prova për fushat ku ato nuk ekzistojnë,** me afat për realizim në **gjysmën e dytë e vitit 2021**, nën përgjegjësi të MSH. Ky aktivitet është **“i realizuar”** në vitin 2025.

Për adresimin e **Problemit 3: Keqpërdorimet në procedurat për marrje/dhënie të donacioneve, studime klinike dhe projekte,** janë parashikuar dy masa dhe dy aktivitete. **Masa 1: Saktësimi i karakteristikave, kushteve dhe mënyrës së pranimit të donacioneve nga institucionet publike shëndetësore (IPSH),** përfshin: **Aktiviteti 1.1: Hartimi i një akti nën-ligjor për pranimin e donacioneve, me afat realizimi në gjysmën e parë të vitit 2021,** dhe bartës MSH. Statusi përfundimtar i këtij aktiviteti është **“i porealizuar”**, pasi MSH ka miratuar vetëm një Vendim për përcaktimin e Metodologjisë për shpërndarjen e donacioneve të pajisjeve mjekësore dhe materialeve të konsumit mjekësor në ISHP (<http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2023/01/Metodologjia-za-raspredelba-na-donatsii-vo-JZU.pdf>), i cili nuk përbën akt nën-ligjor dhe nuk rregullon mënyrën e pranimit të donacioneve.


Për realizimin e **Masës 2: Vendosja e një Regjistri të qasshëm publik të donacioneve të ilaçeve, pajisjeve dhe studimeve klinike,** është parashikuar: **Aktiviteti 2.1: Hartimi i regjistrit.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti *ka qenë gjysma e dytë e vitit 2021*, dhe bartës

është **MSH**. Aktiviteti është “i realizuar” në vitin 2025. Përveç regjistrimit të donacioneve brenda Sektorit për Pajisje Mjekësore dhe donacioneve, i cili publikohet në faqen e MSH: <https://zdravstvo.gov.mk/lista-na-informacii-od-javen-karakter/>, MSH ka krijuar gjithashtu një portal digjital për të gjitha donacionet e pranuar në institucionet publike shëndetësore, i cili përditësohet në kohë reale nga përfaqësuesit e këtyre institucioneve.

Për **Problemin 4: Praktikën joetike në marketingun e ilaçeve**, është parashikuar: **Masa 1: Rregullimi dhe monitorimi i marrëdhënieve midis kompanive farmaceutike dhe mjekëve lidhur me marketingun e ilaçeve. Aktiviteti 1.1: Miratimi i një Kodi Etik për sjelljen e të gjithë aktorëve në marketingun e ilaçeve.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë gjysma e dytë e vitit 2021, ndërsa bartës është MALMED. Ky aktivitet u “realizua” në vitin 2022.


Për **Masën 2: Në nivel spitalor të krijohet një sistem i “Komiteteve Terapeutike” dhe “Regjistrave Spitalorë të Ilaçeve”**, është parashikuar: **Aktiviteti 2.1: Miratimi i ndryshimeve ligjore dhe aktet nënligjore për detyrimin e krijimit të një sistemi të “Komiteteve Terapeutike” dhe “Regjistrave Spitalorë të Ilaçeve” në të gjitha spitalet e vendit.** Afati për këtë aktivitet është gjysma e parë e vitit 2021, ndërsa bartës është Ministria e Shëndetësisë (MSH). Statusi përfundimtar i aktivitetit është “në zhvillim e sipër”. Problemi me praktikën korruptive në lidhje me përshkrimin e ilaçeve nuk është zgjidhur përmes krijimit të “Komiteteve Terapeutike” dhe “Regjistrave Spitalorë të Ilaçeve”, por përmes mekanizmave të tjerë sistematikë. Sipas MSH-së, mjekët përshkruajnë ilaçet me emër gjenetik dhe jo me emër të mbrojtur, duke zvogëluar mundësinë për favorizim të prodhuesve të caktuar. Zgjedhja e terapive përcaktohet nga udhëzimet e detyrueshme për mjekësinë bazuar në prova, ndërsa blerja e ilaçeve bëhet përmes prokurimeve publike duke përdorur emër gjenetik. Kështu, vendimet për përdorimin e ilaçeve përcaktohen në nivel sistematik për të gjitha institucionet shëndetësore, jo përmes organeve individuale brenda secilës institucion.

Për **Problemin 5: Vendimmarrje e qartë dhe objektive në procedurën e trajtimit jashtë vendit**, është parashikuar: **Masa 1: Përcaktimi i spitaleve referente përmes kriterëve të qarta të definuara në aktet nënligjore e parasheh Aktivitetin 1.1: Ndryshimi i akteve për përcaktimin e kriterëve.** Afati për këtë aktivitet ka qenë gjysma e dytë e vitit 2021, ndërsa bartës FSSHRMV. Aktiviteti u “realizua” në vitin 2022.




Fotografia 19: Shkalla e përgjithëshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 26 Aktivitete të parashikuara për këtë fushë, 25 Aktivitete janë planifikuar të realizohen njëheri, ndërsa një Aktivitet është planifikuar të realizohet në kontinuitet për periudhën 2022–2025, që do të thotë se për këtë periudhë pesëvjeçare janë vlerësuar gjithsej 29 Aktivitete. Nga këto, 18 Aktivitete janë realizuar (62%), 4 nuk janë realizuar (14%), dhe 7 janë në zhvillim e sipër (24%).



Fotografia 20: Statusi i realizimit të aktiviteteve sipas viteve



Fotografia 21: Statusi i aktiviteteve sipas institucioneve

- Për MSH janë parashikuar 9 Aktivitete, prej të cilave 5 janë realizuar, 2 nuk janë realizuar, dhe 2 janë në zhvillim e sipër.
- Për FSSHRMV janë parashikuar 19 Aktivitete, prej të cilave 12 janë realizuar, 2 nuk janë realizuar, dhe 5 janë në zhvillim e sipër.
- MALMED ka një Aktivitet, i cili është realizuar.

9. SEKTORI I ARSIMIT

Përshkrimi i sektorit

Në lidhje me sektorin e arsimit, Strategjia ka identifikuar tetë probleme të mëposhtme:

- 1) Ndikime të theksuara dhe autorizime diskrecionale gjatë punësimit në arsim;
- 2) Kapacitete të pamjaftueshme të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit;
- 3) Ndërgjegje e ulët për adresimin e çështjes së korrupsionit brenda institucioneve arsimore;
- 4) Mungesë e një rregullative ligjore të qartë për përdorimin e mjeteve/ndihmësve mësimorë dhe didaktike;
- 5) Mungesë e procedurave për prokurimet që në institucionet edukativo-arsimore realizohen jashtë Ligjit për Prokurime Publike;
- 6) Mungesë e aktit nënligjor për mënyrën e rregullimit të dhënies me qira të pronës së paluajtshme të institucioneve arsimore;
- 7) Rritja e cilësisë së arsimit të lartë në fushën e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve shkencore dhe akreditimit të programeve studimore;
- 8) Mungesë e përmbajtjeve të mjaftueshme në procesin edukativ në arsimin e mesëm për parimet e qeverisjes së mirë dhe integritetit.

Për realizimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara për adresimin e problemeve në sektorin e arsimit, institucionet përgjegjëse janë:

- 1) Qeveria,
- 2) MASH,
- 3) MF,
- 4) MASH,
- 5) KI,
- 6) KSHPK,
- 7) NJVL
- 8) Byroja e Zhvillimit të Arsimit (në tekstin e mëvonshëm: BZHA),
- 9) Qendra për Zhvillim të Arsimit Profesional (në tekstin e mëvonshëm: QZHAP),
- 10) Inspektorati Shtetëror i Arsimit (në tekstin e mëvonshëm: ISHA),
- 11) Qendra Shtetërore e Provimeve (në tekstin e mëvonshëm: QSHP),
- 12) Senatet e universiteteve, dhe
- 13) Agjencia për Cilësi në Arsimin e Lartë (në tekstin e mëvonshëm: ACAL).

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në sektorin përkatës

Në sektorin e arsimit, për adresimin e tetë problemeve prioritare janë parashikuar 18 masa dhe 34 aktivitete, prej të cilave 27 aktivitete janë të njëherëshme, 6 aktivitete janë të planifikuara të realizohen në kontinuitet nga viti 2021 deri në 2025, dhe një aktivitet është i planifikuar të realizohet në kontinuitet nga viti 2022 deri në 2025. Kështu, numri

total i aktiviteteve të vlerësuara për periudhën pesëvjeçare arrin 61. Bazuar në analizën e raporteve vjetore, gjendja e realizimit të aktiviteteve është si vijon:

Problemi 1: Ndikimet e theksuara dhe kompetencat diskrete gjatë punësimeve në sektorin e arsimit								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosja e kriterëve të qarta për vlerësimin dhe procedurat gjatë zhvillimit të intervistave për punësimin e mësuesve në arsimin fillor dhe të mesëm	1.1. Miratimi i akteve nënligjore lidhur me zhvillimin e intervistës dhe përcaktimin e kriterëve për vlerësim gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për mësues	MASH BZHA QZHAP	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
2. Vendosja e një detyrimi ligjor që vendimet për shkarkimin e drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme para përfundimit të mandatit të përmbajnë arsyetime të detajuara dhe të jenë subjekt i mbikëqyrjes inspektuese	2.1. Ndryshimi i Ligjit për Inspektimin Arsimor në drejtim të mbikëqyrjes së detyrueshme mbi vendimet për shkarkimin e parakohshëm të drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme	MASH	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	2.2. Zbatimi i mbikëqyrjes lidhur me përmbajtjen e arsyetimeve në vendimet për shkarkimin e parakohshëm të drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme	ISHA	Gjysma e dytë e vitit 2021 – në kontinuitet	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
3. Vendosja e një mekanizmi të mbikëqyrjes së rregullt nga ana e ISHT-së mbi procedurat për përzgjedhjen në titujt mësimor-shkencorë	3.1. Miratimi i një plani/programi vjetor nga ISHT për mbikëqyrjen e procedurave për përzgjedhjen në titujt mësimor-shkencorë	ISHA MASH	Gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet	E parealizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar	Në zhvillim e sipër
Problemi 2: Kapacitete të pamjaftueshme të ndërtuara të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Përmirësimi i kushteve materiale-	1.1. Hartimi i një analize për vlerësimin e kapaciteteve të ISHA-së	ISHA Këshilli i inspektorëve	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

teknike dhe burimeve njerëzore të ISHA-së	1.2. Rritja e buxhetit të ISHT-së	MF	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar
	1.3. Rritja e numrit të inspektorëve	MF ISHA	Gjysma e parë e vitit 2022	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar
	1.4. Mbikëqyrja jashtëzakonshme inspektuese të kryhet nga të paktën dy inspektorë	ISHA	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër
2. Edukim dhe trajnime për forcimin e rezistencës së punonjësve të ISHA-së ndaj ndikimeve	2.1. Zbatimi i edukimeve dhe trajnimeve mbi integritetin dhe etikën, si dhe për rritjen e vetëdijes së punonjësve të ISHT-së për mënyrën e raportimit të përpjekjeve për ndikim tek organi kompetent – KSHPK dhe/ose KI	KSHPK KI ISHA	Gjysma e dytë e vitit 2021 – në kontinuitet	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
3. Forcimi i mekanizmave për kontrollin e punës së inspektorëve në ISHA	3.1. Hartimi i një analize për vendosjen e një mekanizmi për kontrollin e punës së inspektorëve	ISHA KSHPK	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	3.2. Vendosja e mekanizmit për kontrollin e punës së inspektorëve	MASH ISHA	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 3: Vetëdijesim i ulët për trajtimin e çështjes së korrupsionit brenda institucioneve arsimore								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Ngritja e vetëdijes së drejtorëve dhe mësuesve për parandalimin e korrupsionit në arsimin fillor dhe të mesëm	1.1. Hartimi i një Programi trajnimesh për drejtorë dhe mësues mbi etikën dhe integritetin	BZHA QSHP QZHAP	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar
	1.2. Hartimi i një Udhëzuesi/Doracaku për parandalimin e korrupsionit	BZHA QSHP KSHPK QZHAP	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	1.3. Organizimi dhe zbatimi i punësive edukative me drejtorët dhe mësuesit	BZHA QSHP KSHPK QZHAP	Gjysma e dytë e vitit 2022 – në kontinuitet	E pamaturuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

2. Rritja e vetëdijes për përdorimin e mekanizmeve të raportimit të korrupsionit në universitete	2.1. Zbatimi i aktiviteteve për raportimin e korrupsionit në universitete me përfshirjen edhe të studentëve	Universiteti “Goce Dellçev” – Shtip	Gjysma e parë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
	2.1. Zbatimi i aktiviteteve për raportimin e korrupsionit në universitete, duke përfshirë edhe studentët	Universiteti “Nëna Terezë” – Shkup	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/	/
	2.1. Zbatimi i aktiviteteve për raportimin e korrupsionit në universitete, duke përfshirë edhe studentët	Universiteti për Shkenca dhe Teknologji Informatike “Shën Apostulli Pali” – Ohër	Gjysma e parë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
	2.1. Zbatimi i aktiviteteve për raportimin e korrupsionit në universitete, përfshirë edhe studentët	Universiteti “Shën Klimenti i Ohrit” – Manastir	Gjysma e parë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
3. Vendosja e një mekanizmi për monitorimin e përpjekjeve të përcaktuara në Politikën e Draftit për Parandalimin e Korrupsionit në universitet	3.1. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Politikës së Draftit për Parandalimin e Korrupsionit në universitet dhe publikimi i raporteve vjetore	Universiteti “Goce Dellçev” – Shtip	Gjysma e parë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/	/	/
	3.1. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Politikës së Draftit për Parandalimin e Korrupsionit në universitet dhe publikimi i raporteve vjetore	Universiteti “Nëna Terezë” – Shkup	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
	3.1. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Politikës së Draftit për Parandalimin e Korrupsionit në universitet dhe publikimi i raporteve vjetore	Universiteti për Shkenca dhe Teknologji Informatike “Shën Apostulli Pali” – Ohër	Gjysma e parë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/	/	/

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

	publikimi i raporteve vjetore							
	3.1. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Politikës së Draftit për Parandalimin e Korrupsionit në universitet dhe publikimi i raporteve vjetore	Universiteti “Shën Klimenti i Ohrit” – Manastir	Gjysma e parë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
Problemi 4: Mosekzistimi i një rregullative të qartë ligjore për përdorimin e mjeteve/pajisjeve mësimore dhe didaktike								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosja e kriterëve të qarta për blerjen dhe përdorimin e mjeteve mësimore në shkolla fillore dhe të mesme	1.1. Hartimi i një analize të praktikës dhe përcaktimi i kriterëve për blerjen dhe përdorimin e mjeteve mësimore	MASH BZHA	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E realizuar	/
	1.2. Miratimi i një ndryshimi në Ligjin për tekste mësimore	MASH	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
	1.3. Miratimi i akteve nënligjore përkatëse	MASH BZHA QZHP	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar
Problemi 5: Mungesa e procedurave për prokurimet që në institucionet arsimore realizohen jashtë Ligjit për Prokurime Publike (ekskursionet e nxënësve, sigurimi i shkollës, fotografimi i nxënësve dhe përgatitja e almanakëve, blerja e ushqimit etj.)								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Hartimi i akteve nënligjore që do të rregullojnë mënyrën e realizimit të prokurimeve në institucionet arsimore që nuk i nënshtrohen Ligjit për Prokurime Publike	1.1. Miratimi i akteve nënligjore/rregulloreve	MASH	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar
Problemi 6: Mungesa e akteve nënligjore për rregullimin e mënyrës së dhënies me qira të pronës së paluajtshme institucioneve arsimore								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Hartimi i akteve nënligjore, udhëzimeve dhe udhërrëfyeseve që do të rregullojnë dhënien me qira të	1.1. Miratimi i akteve nënligjore, udhëzimeve dhe udhërrëfyeseve	MASH NJVL	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

pronës së paluajtshme institucioneve arsimore dhe të larta								
Problemi 7: Përmirësimi i cilësisë së arsimit të lartë në fushën e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve shkencore dhe programeve studimore								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Këshilli Nacional për Arsimin e Lartë dhe Veprimtarinë Shkencore-Hulumtuese dhe Agjencia për Cilësinë në Arsimin e Lartë të jenë funksionale	1.1. Emërimi i anëtarëve të Këshillit Nacional dhe të Agjencisë për Cilësinë në Arsimin e Lartë	Qeveria MASH	Gjysma e dytë e vitit 2020	E realizuar	/	/	/	/
2. Rregullimi i llogaridhënies së Agjencisë për Cilësinë në Arsimin e Lartë	2.1. Hartimi i ndryshimeve në Ligjin për Arsimin e Lartë për rregullimin e qartë të llogaridhënies së Agjencisë për Cilësinë në Arsimin e Lartë	MASH ACAL	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E realizuar	/	/	/
3. Sigurimi i transparencës gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të Agjencisë për Cilësinë në Arsimin e Lartë	3.1. Publikimi i vendimeve të arsyetuara për përzgjedhjen e anëtarëve të Agjencisë për Cilësinë në Arsimin e Lartë	Qeveria MASH	Gjysma e parë e vitit 2020 - në kontinuitet	Në zhvillim e sipër	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar
4. Sigurimi i transparencës në punën e Agjencisë për Cilësinë në Arsimin e Lartë në pjesën e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve shkencore dhe programeve studimore	4.1. Publikimi i vendimeve të detajuara të Agjencisë për akreditimet, reakreditimet dhe aktivitetet e tjera profesionale	ACAL	Gjysma e parë e vitit 2021 - në kontinuitet	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar
5. Anëtarësimi i Agjencisë për Cilësinë në Arsimin e Lartë në ENQA (Rrjeti Evropian i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë)	5.1. Hartimi i Planit për anëtarësimin e Agjencisë për Cilësinë në Arsimin e Lartë në ENQA	ACAL	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
Problemi 8: Përmbytje të pamjaftueshme në procesin arsimor në arsimin e mesëm mbi parimet e qeverisjes së mirë dhe integritetit								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

1. Vendosja e përmbajtjeve për edukim antikorruption për nxënësit e arsimit të mesëm si pjesë e programeve të rregullta mësimore	1.1. Zbatimi të Projekteve që kanë të bëjnë me – Edukimin kundër korrupsionit në shkollat e mesme pilot	BZHA MASH KSHPK	Gjysma e parë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
	1.2 Miratimi i akteve përkatëse për futjen e edukimit kundër korrupsionit në programet e rregullta mësimore	BZHA	Gjysma e dytë e vitit 2021 – në kontinuitet	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër

Problemi 1: Ndikime të theksuara dhe autorizime diskrecionale gjatë punësimeve në arsim.

Masa 1: Vendosja e kriterëve të qarta për vlerësim dhe procedurat gjatë intervistave për punësimin e mësuesve në arsimin fillor dhe të mesëm, për të cilën është paraparë Aktiviteti 1.1: Miratimi i aktit nënligjor lidhur me realizimin e intervistës dhe përcaktimin e kriterëve për vlerësim gjatë zgjedhjes së kandidatëve për mësues. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë gjysma e parë e vitit 2021, dhe bartës është Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH). MASH raporton se Aktiviteti është **në zhvillim e sipër**, domethënë po përgatitet Ligji i ri për mësuesit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në arsimin fillor dhe të mesëm, por duke qenë se ky aktivitet kishte afat realizimi vitin 2021, gjatë gjithë periudhës së raportimit ka statusin **“i perealizuar”**.

Masa 2: Vendosja e një detyrimi ligjor që vendimet për shkarkimin e drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme para përfundimit të mandatit të përmbajnë arsye të detajuara dhe t’i nënshtrohen mbikëqyrjes inspektuese, parasheh dy aktivitete:

- **Aktiviteti 2.1: Ndryshimi i Ligjit për inspektimin arsimor në drejtëm të mbikëqyrjes së detyrueshme mbi vendimet për shkarkimin e parakohshëm të drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme.** Afati për realizim ka qenë gjysma e dytë e vitit 2021, ndërsa bartës është Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH). Aktiviteti gjatë gjithë periudhës pesëvjeçare ka statusin **“i perealizuar”**.
- **Aktiviteti 2.2: Zbatimi i mbikëqyrjes lidhur me përmbajtjen e arsytimit të vendimeve për shkarkimin e parakohshëm të drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme.** Afati për realizim ka qenë gjysma e dytë e vitit 2021 – në kontinuitet, dhe bartës është Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), dhe gjatë gjithë periudhës së raportimit ka statusin **“në zhvillim e sipër”**.

Masa 3: Vendosja e një mekanizmi të rregullt mbikëqyrës nga ISHA mbi procedurat e zgjedhjes në titujt mësimit-shkencorë, parasheh një aktivitet: Aktiviteti 3.1: Miratimi i një plani/programi vjetor nga ISHA për mbikëqyrjen e procedurave të zgjedhjes në titujt mësimit-shkencorë. Afati për realizim ka qenë gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet, dhe bartës është ISHA. Ky aktivitet në vitin 2021 ka qenë i shënuar si i **“perealizuar”**, ndërsa në vitet 2022, 2023 dhe 2024 ka qenë **“i realizuar”**. Megjithatë, në vitin 2025, ISHA njoftoi se aktiviteti është **“në zhvillim e sipër”**, domethënë se për mbikëqyrjen e procedurave të zgjedhjes në titujt mësimit-shkencorë dhe shkencorë në institucionet e arsimit të lartë (publike dhe private) dhe institutet shkencore, ishte miratuar një plan/program vjetor për mbikëqyrje të rregullt me një afat kohor tre mujor. Bazuar në këtë, janë kryer edhe mbikëqyrje inspektuese të jashtëzakonshme.

Problemi 2: Kapacitete të pamjaftueshme të Inspektoratit Shtetëror i Arsimit. Masa 1: Përmirësimi i kushteve materiale-teknike dhe burimeve njerëzore të ISHA, parasheh katër aktivitete:

- **Aktiviteti 1.1: Përgatitja e një analize për vlerësimin e kapaciteteve të ISHA.** Me afat realizimi në gjysmën e dytë e vitit 2021, ndërsa institucion përgjegjës është ISHA. Statusi përfundimtar është **“i perealizuar”**, pasi që ISHA nuk ka kryer analizën, ndërsa raportet e dorëzuara tregojnë nevojën për punësimin e inspektorëve dhe stafit tjetër në

vendet e lira, avancimin e atyre ekzistues dhe përmirësimin e kapaciteteve materiale-teknike.

- **Aktiviteti 1.2: Rritja e buxhetit të ISHA.** Afati për realizim e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, dhe institucioni përgjegjës është **MF**. Gjatë katër viteve të fundit, aktiviteti ka qenë “në zhvillim e sipër”, me qëllim që MF çdo vit të raportojë për rritjen e buxhetit të ISHA, dhe në vitin 2025 ky aktivitet përfundimisht u konsiderua “**i realizuar**”. Sipas raporteve të MF, shihet qartë se buxheti i ISHA-s vazhdimisht është rritur.
- **Aktiviteti 1.3: Rritja e numrit të inspektorëve.** Me afat realizimi në **gjysmën e parë të vitit 2022**, ndërsa institucioni përgjegjës është **MF**. Statusi përfundimtar i aktivitetit është “**i realizuar**” në vitin 2025.
- **Aktiviteti 1.4: Mbikëqyrje inspektuese të jashtëzakonshme nga të paktën dy inspektorë.** Afati për realizim të këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, dhe institucioni përgjegjës është **ISHA**. Në vitin 2021 aktiviteti ka qenë “në zhvillim e sipër”, ndërsa vitet në vijim ka qenë i “**parealizuar**”. Sipas raportit të fundit në 2025, gjatë mbikëqyrjeve të jashtëzakonshme, në varësi të kompleksitetit dhe vëllimit të rasteve, si dhe objektivitetit dhe korrupsionit, drejtori i ISHA-s cakton që në shumicën e rasteve të veprojnë të paktën dy inspektorë. Aktiviteti konsiderohet “në zhvillim e sipër” deri sa të vendoset obligimi që çdo mbikëqyrje inspektuese e jashtëzakonshme të kryhet nga të paktën dy inspektorë.
- **Masa 2: Edukim dhe trajnime për forcimin e rezistencës së punonjësve të ISHA-s ndaj ndikimeve** është paraparë **Aktiviteti 2.1: Zbatimi i edukimit dhe trajnimeve për integritet dhe etikë, si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit të punonjësve të ISHA-s mbi mënyrën e raportimit të përpjekjeve për ndikim te organi kompetent – KSHPK dhe/ose ISHA.** Afati për realizim ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021 – në kontinuitet**, dhe aktiviteti është nën përgjegjësinë e **KSHPK**. Përveç vitit 2022, kur aktiviteti ka qenë i parealizuar, në vitet e tjera ka status “në zhvillim e sipër”. Pas vendosjes së një sistemi integriteti në vitin 2023, ISHA ka vazhduar aktivitete të lidhura me edukimin për integritet dhe etikë. Brenda Programit Vjetor për trajnime gjenerike të inspektorëve (2022), Këshilli Inspektues në bashkëpunim me KSHPK parashikoi trajnime mbi temën “Parandalimi i korrupsionit”, duke përfshirë edhe punonjësit e ISHA-s. Programi u përmirësua për vitin 2025 (temat 1.13 dhe 1.14), duke siguruar vazhdimësi të edukimit. Pas përfundimit të mbështetjes së donatorit (USAID), ISHA përfshiu trajnimet për parandalimin e korrupsionit dhe integritetin në Planin Vjetor të Punës për 2025, duke siguruar qëndrueshmëri institucionale dhe pavarësi nga mbështetja e projekteve.

Për **Masën 3: Forcimi i mekanizmave të kontrollit mbi punën e inspektorëve në ISHA**, parasheh aktivitetet e mëposhtme:

- **Aktiviteti 3.1: Përgatitja e një analize për vendosjen e një mekanizmi kontrolli mbi punën e inspektorëve.** Afati për realizim ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, dhe aktiviteti është nën përgjegjësinë e **ISHA**. Statusi përfundimtar është “**i parealizuar**”, pasi analiza për vendosjen e mekanizmit të kontrollit nuk është përgatitur.
- **Aktiviteti 3.2: Vendosja e mekanizmit të kontrollit mbi punën e inspektorëve.** Afati për realizim ishte **gjysma e parë e vitit 2022**, dhe aktiviteti është nën përgjegjësinë e **MASH**. Statusi përfundimtar është “**i parealizuar**”.

Problemi 3: Ndërgjegjësim i ulët për adresimin e çështjes së korrupsionit brenda institucioneve arsimore.

Masa 1: Forcimi i ndërgjegjësimit të drejtorëve dhe mësuesve për parandalimin e korrupsionit në arsimin fillor dhe të mesëm, përfshin tre aktivitete:

Aktiviteti 1.1: Hartimi i një Programi trajnimesh për drejtorë dhe mësues për etikë dhe integritet. Afati për realizim ka qenë gjysma e parë e vitit 2022, dhe aktiviteti është nën përgjegjësinë e BZHA. Statusi përfundimtar është “i porealizuar”.

- **Aktiviteti 1.2: Hartimi i një Udhëzuesi/Doracaku për parandalimin e korrupsionit.** Afati për realizim ka qenë gjysma e parë e vitit 2022, dhe aktiviteti është nën përgjegjësinë e BZHA. Statusi përfundimtar është “i porealizuar”.
- **Aktiviteti 1.3: Organizimi dhe zhvillimi i punëtorive edukative me drejtorët dhe mësuesit.** Afati për realizim ka qenë gjysma e dytë e vitit 2022 – në kontinuitet, dhe aktiviteti është nën përgjegjësinë e BZHA. Aktiviteti nuk u realizua në vitin 2022, dhe për tre vitet pasuese, duke filluar nga 2023, ka status “në zhvillim e sipër”. Sipas programeve të reja mësimore, ku përfshihen përmbajtje për parandalimin e korrupsionit, BZHA ka zhvilluar trajnime të vazhdueshme me mësuesit që zbatojnë programet e reja.

Masa 2: Rritja e ndërgjegjësimit për përdorimin e mekanizmave të raportimit të korrupsionit në universitetet përfshin një aktivitet: Aktiviteti 2.1: Zbatimi i aktiviteteve për raportimin e korrupsionit në universitetet, me përfshirë edhe të studentëve, e cila përfshin pesë institucione. Afati për realizim ka qenë gjysma e parë e vitit 2021, dhe aktiviteti është nën përgjegjësinë e Senateve të universiteteve. Ky aktivitet u “realizua” nga të gjitha universitetet që angazhuan dorëzimin e raporteve (UGD, UKLO, USHIT dhe UNT).

Masa 3: Vendosja e një mekanizmi për monitorimin e përpjekjeve të përcaktuara në Draft-politikën për parandalimin e korrupsionit në universitet përfshin një aktivitet: Aktiviteti 3.1: Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Draft-politikës për parandalimin e korrupsionit në universitet dhe publikimi i raporteve vjetore. Afati për realizim ka qenë gjysma e parë e vitit 2021, dhe aktiviteti është nën përgjegjësinë e Senateve të universiteteve. Ky aktivitet u “realizua” nga të gjitha universitetet që u obliguan të dorëzojnë raporte (UGD, UKLO, USHIT dhe UNT).

Për Problemin 4: Mungesa e një rregullative ligjore të saktë për përdorimin e mjeteve mësimore vizuale dhe didaktike, në Planin e Veprimit të Strategjisë është paraparë Masa 1: Vendosja e kriterëve të qarta për furnizimin dhe përdorimin e mjeteve arsimore në shkollat fillore dhe të mesme, e cila përfshin tre aktivitete:

Aktiviteti 1.1: Hartimi i një analize të praktikës dhe përcaktimi i kriterëve për furnizimin dhe përdorimin e mjeteve arsimore. Afati për këtë aktivitet ka qenë gjysma e parë e vitit 2021, ndërsa bartës është MASH. Ky aktivitet është “realizuar” në vitin 2024, me miratimin e Ligjit të ri për tekstet shkollë për arsimin fillor dhe të mesëm („Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr. 3/25), ku janë rregulluar procedurat për furnizimin dhe përdorimin e mjeteve arsimore.

Aktiviteti 1.2: Miratimi i ndryshimeve në Ligjin për tekstet shkollë. Afati për këtë aktivitet ka qenë gjysma e dytë e vitit 2021, ndërsa bartës është MASH. Ky aktivitet është “realizuar” në vitin 2024, me miratimin e Ligjit të ri për tekstet shkollë për arsimin fillor dhe të mesëm („Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr. 3/25), ku janë rregulluar procedurat për furnizimin dhe përdorimin e mjeteve arsimore.

Aktiviteti 1.3: Miratimi i akteve përkatëse nënligjore. Afati për këtë aktivitet ka qenë gjysma e dytë e vitit 2021, ndërsa bartës është MASH. Ky aktivitet nuk është realizuar në tre vitet e para, ndërsa në vitin 2024 ka qenë në zhvillim e sipër, ndërsa në vitin 2025 është **“realizuar”** përfundimisht. Pas miratimit të Ligjit të ri për tekstet shkollore, në vitin 2025 janë miratuar edhe dy procedura që janë publikisht të qasshme në faqen e internetit të MASH dhe Shërbimit Pedagogjik, përkatësisht: Procedura për mënyrën e zbatimit të procedurës për miratimin e teksteve shkollore në gjuhë të huaj, si dhe Procedura për mënyrën e zbatimit të procedurës për miratimin e teksteve shkollore përmes konkursit publik. Procedurat e përmendura janë në funksion të forcimit të ligjshmërisë në marrjen e vendimeve dhe shërbejnë si udhërrëfyes për të gjithë të përfshirët në këto procedura.

Gjithashtu, në vitin 2025 janë miratuar edhe këto akte nënligjore: Urdhëresë për përcaktimin e formulës për përcaktimin e vlerës kataloguese të tekstit shkollor; Rregullore për mënyrën e regjistrimit në bazën e recensentëve dhe mënyrën e punës së recensentëve; Rregullore për formën dhe përmbajtjen e Katalogut të teksteve shkollore të miratuara për përdorim; Rregullore për mënyrën e pranimit, ruajtjes, shpërndarjes dhe kthimit të seteve të teksteve shkollore në shkollat fillore dhe të mesme; si dhe Rregullore për mënyrën e miratimit të fletoreve të punës për përdorim në shkolla.

Problemi 5: Mungesa e procedurave për prokurime që në institucionet edukativo-arsimore realizohen jashtë ligjit për prokurime publike (ekskursionet e nxënësve, sigurimi i shkollës, fotografimi i nxënësve dhe përgatitja e almanakëve, furnizimi me ushqim, etj.), përfshin Masën 1: Hartimi i akteve nënligjore me të cilat do të rregullohet mënyra e zbatimit të prokurimeve në institucionet edukativo-arsimore që nuk i nënshtrohen ligjit për prokurime publike, e cila përfshin Aktivitetin 1.1: Miratimi i akteve nënligjore/rregulloreve. Afati për këtë aktivitet ka qenë gjysma e parë e vitit 2022, ndërsa bartës është MASH. Ky aktivitet nuk u realizua në vitet e kaluara dhe i njëjti është **“realizuar”** në vitin 2025 me miratimin e rregulloreve të reja për arsimin fillor dhe të mesëm: Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e përdorimit të mjeteve që shkolla fillore i mbledh nga prindërit, përkatësisht kujdestarët e nxënësve dhe Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e përdorimit të mjeteve që shkolla e mesme i mbledh nga prindërit, përkatësisht kujdestarët e nxënësve. (<https://portal.mdt.gov.mk/post-body-files/pravilnici-mon-file-IOJI.pdf>).

Problemi 6: Mungesa e akteve nënligjore për mënyrën e rregullimit të dhënies me qira të pasurisë së paluajtshme të institucioneve arsimore, gjithashtu përfshin një masë të vetme, Masa 1: Hartimi i akteve nënligjore, udhëzimeve dhe orientimeve me të cilat do të rregullohet dhënia me qira e pasurisë së paluajtshme të institucioneve edukativo-arsimore dhe të arsimit të lartë, e cila duhet të realizohet përmes Aktivitetit 1.1: Miratimi i akteve nënligjore, udhëzimeve dhe orientimeve. Afati për këtë aktivitet ka qenë gjysma e parë e vitit 2022, ndërsa bartës është MASH. Ky aktivitet mbeti **“i parealizuar”** gjatë gjithë periudhës raportuese.

Problemi 7: Rritja e cilësisë së arsimit të lartë në fushën e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve shkencore dhe programeve studimore. Masa 1: Këshilli Nacional për Arsim të Lartë dhe Veprimtari Shkencore-Hulumtuese dhe Agjencia për Cilësi në Arsimin e Lartë të jenë funksionale, përfshin Aktivitetin 1.1: Emërimi i anëtarëve të Këshillit Nacional dhe të Agjencisë për Cilësi në Arsimin e Lartë. Afati për këtë aktivitet ka qenë gjysma e dytë e vitit 2020, ndërsa bartës është Qeveria. Ky aktivitet është **“realizuar”** në vitin 2021.

Masa 2: Rregullimi i llogaridhënies së Agjencisë për Cilësi në Arsimin e Lartë gjithashtu parashikon **Aktivitetin 2.1: Hartimi i ndryshimeve të Ligjit për Arsim të Lartë për rregullimin e saktë të llogaridhënies së Agjencisë për Cilësi në Arsimin e Lartë**. Afati për këtë aktivitet ka qenë gjysma e dytë e vitit 2021, ndërsa bartës është MASH. Ky aktivitet është “realizuar” në vitin 2022.


Masa 3: Sigurimi i transparencës gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të Agjencisë për Cilësi në Arsimin e Lartë parashikon **Aktivitetin 3.1: Publikimi i vendimeve të arsyetuara për zgjedhjen e anëtarëve të Agjencisë për Cilësi në Arsimin e Lartë**. Afati për këtë aktivitet është gjysma e parë e vitit 2020 – në kontinuitet, ndërsa bartës është Qeveria. Ky aktivitet ishte në zhvillim e sipër gjatë vitit 2021, ndërsa në periudhën nga 2022 deri në 2025 konsiderohet “i realizuar”. Sipas raporteve të Qeverisë, vendimet për shkarkimin ose emërimin e anëtarëve të Bordit të Akreditimit dhe të Bordit për Vlerësimin e Arsimit të Lartë publikohen rregullisht në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”. Pavarësisht statusit të realizuar të aktivitetit, KSHPK konstaton se në vendimet e miratuara nuk ka arsyetim të detajuar për zgjedhjen/shkarkimin e anëtarëve.

Masa 4: Sigurimi i transparencës në punën e Agjencisë për Cilësi në Arsimin e Lartë në pjesën e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve shkencore dhe programeve studimore, për të cilën duhet të realizohet **Aktiviteti 4.1: Publikimi i vendimeve të arsyetuara në mënyrë të detajuar të Agjencisë për akreditimet, reakreditimet dhe aktivitetet e tjera profesionale**. Afati për këtë aktivitet është gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet, ndërsa bartës është ACAL. Ndryshe nga vitet e mëparshme kur ky aktivitet vlerësohej rregullisht me status në zhvillim e sipër, në vitin 2025 aktiviteti është shënuar si “i realizuar”.

Masa 5: Anëtarësimi i Agjencisë për Cilësi në Arsimin e Lartë në ENQA (Rrjeti Evropian i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë) parashikon **Aktivitetin 5.1: Hartimi i një Plani për anëtarësimin e Agjencisë për Cilësi në Arsimin e Lartë në ENQA dhe verifikimin e këtij plani**. Afati për këtë aktivitet ka qenë gjysma e parë e vitit 2022, ndërsa bartës është ACAL. Ky aktivitet është “në zhvillim e sipër” gjatë gjithë periudhës raportuese, duke pasur parasysh se nga ana e ACAL është hartuar një Plan Veprimi i cili parashikon rinovimin e statusit si anëtare e asociuar, pagesën e anëtarësisë vjetore në ENQA, si dhe miratimin e një Ligji për Cilësi që do të sigurojë përputhshmëri me standardet e përcaktuara ESG 2015, miratimin e akteve nënligjore që do të dalin nga Ligji i ri për Cilësi, definimin e proceseve dhe procedurave të nevojshme dhe përgatitjen e Agjencisë për monitorim nga ana e ENQA.


Problemi 8: Përmbajtje të pamjaftueshme në procesin arsimor në arsimin e mesëm lidhur me parimet e qeverisjes së mirë dhe integritetit, parashikon një Masë të vetme 1: **Vendosja e përmbajtjeve për edukim antikorrupsion për nxënësit e arsimit të mesëm si pjesë e programeve të rregullta mësimore,** për të cilën janë paraparë dy aktivitete:

- **Aktiviteti 1.1: Zbatimi i Projektit – Edukimi antikorrupsion në shkollat e mesme pilot, për të cilin afati ka qenë gjysma e parë e vitit 2021,** ndërsa bartës është BZHA është “realizuar” brenda afatit të përcaktuar.
- **Aktiviteti 1.2: Miratimi i akteve përkatëse për vendosjen e edukimit antikorrupsion në programet e rregullta mësimore.** Afati për këtë aktivitet ka qenë gjysma e dytë e vitit 2021 – në kontinuitet, ndërsa bartës është BZHA. Ky aktivitet ishte i përcaktuar në vitet 2021, 2023 dhe 2024, ndërsa në vitet 2022 dhe 2025 ka qenë “në zhvillim e sipër”.




Fotografia 22: Shkalla e përgjithshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 34 aktivitete të parashikuara për këtë sektor, 27 aktivitete janë planifikuar të realizohen njëherë, 6 aktivitete janë planifikuar në kontinuitet për periudhën 2021–2025, ndërsa një aktivitet në kontinuitet për periudhën 2022–2025, që do të thotë se për këtë periudhë pesëvjeçare janë vlerësuar gjithsej 61 aktivitete. Prej tyre, 25 aktivitete janë realizuar (41%), 22 aktivitete janë në zhvillim e sipër (36%), ndërsa 14 aktivitete nuk janë realizuar (23%).



Fotografia 23: Statusi i aktiviteteve sipas periudhës së vlerësimit



Fotografia 24: Statusi i përgjithshëm i aktiviteteve sipas institucioneve

- Për MASH janë parashikuar 9 aktivitete, nga të cilat 5 janë realizuar, ndërsa 4 janë të parealizuara.
- Për ISHA janë parashikuar 13 aktivitete, nga të cilat 3 janë realizuar, 3 janë të parealizuara, ndërsa 7 aktivitete janë në zhvillim e sipër.
- BZHA ka gjithsej 12 aktivitete, nga të cilat 1 është realizuar, 6 aktivitete janë të parealizuara, ndërsa 5 aktivitete janë në vijim.
- Për KSHPK janë parashikuar 5 aktivitete, nga të cilat 1 është i parealizuar, ndërsa 4 aktivitete janë në zhvillim e sipër.
- Për MF janë parashikuar 2 aktivitete, të cilat janë të realizuar.
- Për ACAL janë parashikuar 6 aktivitete, nga të cilat 1 është e realizuar, ndërsa 5 aktivitete janë në zhvillim e sipër.
- Për Qeverinë janë parashikuar 6 aktivitete, nga të cilat 5 janë të realizuara, ndërsa 1 është në zhvillim e sipër.
- Universitetet UGD, UKLO, USHIT dhe UNT kanë nga 2 aktivitete secili, gjithsej 8 aktivitete, të cilat janë të gjitha të realizuara.

10. SEKTORI PËR PUNË DHE POLITIKË SOCIALE

Përshkrimi i sektorit

Në lidhje me sektorin për punë dhe politikës sociale, në Strategji është përcaktuar problemi prioritar si vijon:

- 1) Mungesa e mbikëqyrjes në procedurat për realizimin e të drejtave në bazë të sigurimit pensional dhe invalidor.

Për realizimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara për tejkalimin e problemit në sektorin e punës dhe politikës sociale janë përgjegjëse institucionet e mëposhtme:

- 1) Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (në tekstin e mëtejshëm: MPPS)
- 2) MSH
- 3) Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor (në tekstin e mëtejshëm: FSPIRMV-së)

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në sektorin përkatës

Në sektorin për Punë dhe Politikës Sociale, për tejkalimin e një problemi prioritar janë parashikuar 5 masa dhe 10 aktivitete, nga të cilat 8 aktivitete janë njëherëshe, ndërsa 2 aktivitete janë të përcaktuara të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme nga viti 2021 deri në vitin 2025, me ç'rast numri i përgjithshëm i aktiviteteve të vlerësuara për periudhën pesëvjeçare është 18. Bazuar në analizën e realizuar të raporteve vjetore, gjendja e realizimit të aktiviteteve është si vijon:

Problemi 1: Mungesa e mbikëqyrjes në procedurat për realizimin e të drejtave në bazë të sigurimit pensional dhe invalidor								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosja e një sistemi të unifikuar të centralizuar dhe të digjitalizuar për sigurimin social	1.1 Ndryshimi i rregullativës ligjore në fushën e sigurimeve sociale	MPPS Institucione tjera përkatëse	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/	/
	1.2. Vendosja e një sistem i unifikuar i centralizuar dhe i digjitalizuar për sigurimin social	MPPS	Gjysma e dytë e vitit 2023	E pamaturuar	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
2. Themelimi i një organi të ri për ekspertizë të centralizuar / vlerësim të invaliditetit / aftësisë për punë, me qëllim uljen e mundësisë për korrupsion gjatë vendimmarrjes	2.1 Hartimi i një analize për procesin aktual të vlerësimit të invaliditetit / aftësisë për punë	MPPS FSPIRMV-së	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
	2.2. Miratimi i një zgjidhjeje ligjore për formimin e organit për ekspertizë / vlerësim.	MPPS FSPIRMV-së	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/	/
	2.3. Themelimi i organit për ekspertizë / vlerësim.	MPPS FSPIRMV-së	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E perealizuar	E perealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
3. Përmirësimi i rregullativës që rregullon procedurën për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rishikimin e konstatimit, vlerësimit dhe mendimit për përcaktimin e invaliditetit	3.1 Analizë e Rregullores për organizimin, përbërjen dhe mënyrën e punës së Komisionit për rishikimin e konstatimit, vlerësimit dhe mendimit për përcaktimin e invaliditetit, me qëllim identifikimin e paqartësive në lidhje me përzgjedhjen e anëtarëve të tij.	MPPS	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E perealizuar	E realizuar	/	/
	3.2 Ndryshimi i Rregullores për organizimin, përbërjen dhe mënyrën e punës së Komisionit për rishikimin e	MPPS	Gjysma e parë e vitit 2023	E pamaturuar	E pamaturuar	E perealizuar	E realizuar	/

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

	konstatimit, vlerësimit dhe mendimit për përcaktimin e invaliditetit.							
4. Forcimi i mbikëqyrjes në procedurat për realizimin e të drejtave në bazë të sigurimit pensional dhe invalidor	4.1. Miratimi i metodologjisë për zbatimin e kontrolleve (të rregullta dhe ad hoc).	MPPS	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	4.2. Zbatimi i kontrolleve të rregullta dhe ad hoc (jo vetëm në bazë të ankesave)	MPPS	2021, në kontinuitet	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
5. Forcimi i mbikëqyrjes në procedurat për realizimin e të drejtave në bazë të ndihmës dhe kujdesit nga një person tjetër	5.1. Zbatimi i kontrolleve të rregullta dhe ad hoc (jo vetëm mbi bazën e ankesave)	MPPS MSH	2021, në kontinuitet	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E realizuar

Problemi 1: Mungesa e mbikëqyrjes në procedurat për realizimin e të drejtave në bazë të sigurimit pensional dhe invalidor.

Për Masën 1: Krijimi i një sistemi të vetëm të digjitalizuar qendror për sigurimin social, janë parashikuar dy aktivitete:

- **Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i legjislacionit në fushën e sigurimit social.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, dhe e njehta është në kompetencë të MPPS (MPSPDR). Ky aktivitet është “**realizuar**” gjatë vitit 2023.
- **Aktiviteti 1.2: Krijimi i një sistemi të vetëm të digjitalizuar qendror për sigurimin social.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2023**, ndërsa institucioni përgjegjës është **MPPS (MPSPDR)**. Statusi përfundimtar i këtij aktiviteti është “**në zhvillim e sipër**”, duke qenë se aktualisht po punohet në dizajnimin e sistemit të IT-së të Regjistratit për sigurimin e detyrueshëm social, dhe i njëjti pritet të vendoset deri në fund të vitit 2027.

Masa 2: Formimi i një trupi të ri për ekspertizë/qendrore për vlerësimin e aftësisë së kufizuar/kapacitetit për punë, me qëllim uljen e mundësisë për korrupsion gjatë vendimmarrjes, përfshin tre aktivitete:

- **Aktiviteti 2.1: Hartimi i një analize për procesin aktual të vlerësimit të aftësisë së kufizuar/kapacitetit për punë.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa është në kompetencë të **MPPS (MPSPDR)** e cila ka raportuar se aktiviteti është “**realizuar**” në vitin 2024, me informacion se analiza është përgatitur me mbështetje eksperte në kuadër të Projektit për Administrimin e Sigurimeve Sociale – SIAP.
- **Aktiviteti 2.2: Miratimi i zgjidhjes ligjore për formimin e trupit për ekspertizë/vlerësim.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa është në kompetencë të **MPPS (MPSPDR)**. Statusi përfundimtar i aktivitetit është “**realizuar**” në vitin 2023, me miratimin e Ligjit të ri për sistemin e vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 209/2023), me të cilin parashikohet formimi i Trupit Qendror Koordinues për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara.
- **Aktiviteti 2.3: Formimi i trupit për ekspertizë/vlerësim.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2022**, ndërsa është në kompetencë të **MPPS (MPSPDR)**. Statusi përfundimtar i këtij aktiviteti është “**në zhvillim e sipër**”. Me miratimin e Ligjit të ri për sistemin e vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 209/2023), i cili do të zbatohet 18 muaj pas hyrjes në fuqi, parashikohet formimi i Trupit Qendror Koordinues për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Për Masën 3: Përmirësimi i rregullativës që rregullon procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit për revizion të konstatimit, vlerësimit dhe mendimit për përcaktimin e aftësisë së kufizuar, janë paraparë dy aktivitete:


- **Aktiviteti 3.1: Analiza e Rregullores për organizimin, përbërjen dhe mënyrën e punës së Komisionit për revizion të konstatimit, vlerësimit dhe mendimit për përcaktimin e aftësisë së kufizuar, me qëllim identifikimin e paqartësive lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të tij.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2022**, ndërsa është në kompetencë të **MPPS (MPSPDR)**. Ky aktivitet është “**realizuar**” në vitin 2023.

- **Aktiviteti 3.2: Ndryshimi i Rregullores për organizimin, përbërjen dhe mënyrën e punës së Komisionit për revizion të konstatimit, vlerësimit dhe mendimit për përcaktimin e aftësisë së kufizuar.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2023**, ndërsa është në kompetencë të **MPPS (MPSPDR)**. Sipas raportit të dorëzuar, MPSPDR ka informuar se aktiviteti është **“realizuar”** në vitin 2024.

Për Masën 4: Forcimi i mbikëqyrjes në procedurat për realizimin e të drejtave në bazë të sigurimit pensional dhe invalidor përfshin dy aktivitete:


- **Aktiviteti 4.1: Miratimi i Metodologjisë për zbatimin e kontrolleve (të rregullta dhe ad hoc),** me afat realizimi **gjysma e parë e vitit 2022**, në kompetencë të **MPPS (MPSPDR)**. Ky aktivitet është me status **“i porealizuar”**, pasi metodologjia e parashikuar nuk është miratuar.
- **Aktiviteti 4.2: Zbatimi i kontrolleve të rregullta dhe ad hoc (jo vetëm në bazë të parashitësive).** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **viti 2021 – në kontinuitet**, ndërsa institucioni përgjegjës është **MPPS (MPSPDR)**. Ky aktivitet është kushtëzuar nga miratimi i Metodologjisë për zbatimin e kontrolleve nga Aktiviteti 4.1 i kësaj mase, prandaj për pesë vite radhazi është shënuar si **“i porealizuar”**.

Për Masën 5: Forcimi i mbikëqyrjes në procedurat për realizimin e të drejtave në bazë të ndihmës dhe kujdesit nga person tjetër, parashikon **Aktivitetin 5.1: Zbatimi i kontrolleve të rregullta dhe ad hoc (jo vetëm në bazë të parashitësive),** për të cilin afati i realizimit ka qenë **viti 2021 – në kontinuitet**, ndërsa institucioni përgjegjës është **MPPS (MPSPDR)**. Në vitin 2021 dhe 2024, ky aktivitet është vlerësuar si **“i porealizuar”**, ndërsa në vitet 2022 dhe 2023 ka pasur status **“në zhvillim e sipër”**. Ndryshe nga vitet e mëparshme, Sektori për mbikëqyrje inspektuese në fushën e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, në vitin 2025 ka kryer gjithsej 21 inspektime të jashtëzakonshme dhe kontrolluese për ndihmë dhe kujdes nga person tjetër, nga të cilat 14 kanë qenë të jashtëzakonshëm dhe 7 kontrollues. Për këtë arsye, ky aktivitet konsiderohet si **“i realizuar”** në vitin 2025.



Fotografia 25: Shkalla e përgjithshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 10 aktivitete të parashikuara për këtë sektor, 8 aktivitete janë planifikuar të realizohen njëheri, ndërsa 2 aktivitete janë parashikuar të realizohen në kontinuitet për periudhën 2021–2025, që do të thotë se për periudhën e përmendur pesëvjeçare janë vlerësuar gjithsej 18 aktivitete. Prej tyre, 6 aktivitete janë realizuar (33%), 8 aktivitete janë të porealizuara (44%), ndërsa 4 aktivitete janë në zhvillim e sipër (22%).



Fotografia 26: Statusi i aktiviteteve sipas periudhës së vlerësimit

Të gjitha aktivitetet në këtë sektor janë në kompetencë të MPSDR.

11. SEKTORI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR

Pëershkrimi i sektorit

Në lidhje me sektorin për urbanizmit dhe planifikim hapësinor, në Strategji është përcaktuar problemi prioritar në vijim:

- 1) Mungesë e mbikëqyrjes së mjaftueshme mbi realizimin e ndërtimeve të kategorisë së dytë.

Për realizimin e masës dhe aktivitetit të parashikuar për tejkalimin e problemit në sektorin e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor, përgjegjëse është institucioni në vijim:

- 1) Ministria e Transportit dhe Lidhjeve (në tekstin e mëtejme: MTL).


Shkalla e realizimeve të aktiviteteve në sektorin përkatës

Në sektorin e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor është konstatuar një problem prioritar, për tejkalimin e të cilit me Planin e Veprimit të Strategjisë është parashikuar një Masë dhe një aktivitet i shënuar të realizohet në kontinuitet për periudhën 2022–2025, me ç'rast numri i përgjithshëm i aktiviteteve të vlerësuara për periudhën pesëvjeçare është 4. Bazuar në të dhënat e marra dhe analizën e realizuar në lidhje me zbatimin e masave dhe aktiviteteve në sektorin e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor, gjendja është si vijon:


Problemi 1: Mungesë e mbikëqyrjes së mjaftueshme mbi realizimin e ndërtimeve të kategorisë së dytë								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendorsja e mbikëqyrjes së përforcuar mbi realizimin e ndërtimeve të kategorisë së dytë.	1.1. Ndryshimi i Ligjit për ndërtim në drejtim të inicimit të detyrueshëm të procedurës për heqjen e licencës për mbikëqyrje të personit juridik, nëse konstatohet parregullsi me paraqitjen e gjendjes së pavërtetë.	MTL	Gjysma e dytë e vitit 2022 – në kontinuitet	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar

Për **Problemën 1: Mbikëqyrja e pamjaftueshme mbi realizimin e ndërtimeve të kategorisë së dytë** në sektorin e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor, është parashikuar **Masa 1: Vendosja e mbikëqyrjes së përforcuar mbi realizimin e ndërtimeve të kategorisë së dytë**, e cila përfshin **Aktivitetin 1.1: Ndryshimin e Ligjit për ndërtim në drejtim të inicimit të detyrueshëm të procedurës për heqjen e licencës për mbikëqyrje të personit juridik nëse konstatohet parregullsi me paraqitje të gjendjes së pavërtetë**. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2022 – në kontinuitet**, ndërsa bartës është MTL (MT). Ky aktivitet, në periudhat e kaluara raportuese, ka qenë i shënuar me status “në zhvillim e sipër”, ndërsa në vitin 2025 është realizuar, me miratimin e Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për ndërtim (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 101/25), ku është shtuar një dispozitë e re në nenin ekzistues 38, me të cilën përcaktohet baza për heqjen e licencave të lëshuara sipas këtij ligji. Përkatësisht me ndryshimin e Ligjit të datës 21 maj 2025 është vendosur një kontroll i përforcuar sipas detyrës zyrtare (të paktën dy herë në vit) nga MT, me qëllim kryerjen e verifikimeve dhe konstatimeve të rregullta, dhe jo vetëm në bazë të ankesave të paraqitura – në rastet kur personi juridik për mbikëqyrje të ndërtimit harton ose vërteton raport me shkrim për një fazë të veçantë të ndërtimit me konstatime që nuk janë në përputhje me punimet e realizuara, harton ose vërteton raport përfundimtar për mbikëqyrjen e kryer me konstatime që nuk janë në përputhje me punimet e realizuara, ose harton apo vërteton raport për kontroll teknik të kryer në kundërshtim me dispozitat e nenit 90 paragrafët (3) dhe (4) të ligjit.

Përfundimisht me dhjetor 2025, MT ka kryer kontroll të detyrueshëm të të gjitha licencave të lëshuara, jo vetëm të atyre për mbikëqyrje, dhe si rezultat i kësaj janë hequr 41 licenca për mbikëqyrje ndërtimi, nga të cilat 27 janë të formës së prerë, ndërsa të tjerat janë në procedurë administrative gjyqësore.



Fotografia 27: Shkalla e përgjithshme e realizimit në sektorin përkatës



Fotografia 28: Statusi i aktiviteteve sipas periudhës së vlerësimit

Të gjitha aktivitetet në këtë fushë janë në kompetencë të MT.

12. SEKTORI I MJEDISIT JETËSORË

Përshkrimi i sektorit

Në lidhje me sektorin e mjedisit jetësor, në Strategji është përcaktuar problemi prioritar si vijon:

- 1) Mungesë e një sistemi të integruar të menaxhimit rajonal të mbeturinave.

Për realizimin e masës dhe aktiviteteve të parashikuara për tejkalimin e problemit në sektorin e mjedisit jetësor, përgjegjëse janë institucionet e mëposhtme:

- 1) Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejme: MMJPH) dhe
- 2) NJVL

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në sektorin përkatës

Në sektorin e Mjedisit Jetësor, për tejkalimin e një problemi prioritar është parashikuar një Masë dhe 2 aktivitete njëherëshe. Bazuar në analizën e realizuar të raporteve vjetore, gjendja e realizimit të aktiviteteve është si vijon:

Problemi 1: Mungesë e një sistemi të integruar për menaxhimin rajonal të mbeturinave								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Krijimi i qendrave rajonale për menaxhimin e mbeturinave.	1.1 Shpallja e konkursit për përzgjedhjen e koncesionarëve.	MMJPH	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	1.2. Miratimi i vendimeve për dhënien e koncesioneve për menaxhimin e mbeturinave.	NJVL BNJVL	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër


Problemi 1: Mungesa e një sistemi të integruar për menaxhimin rajonal të mbeturinave në sektorin e mjedisit jetësor, është paraparë **Masa 1: Krijimi i qendrave rajonale për menaxhimin e mbeturinave**, e cila përfshin dy aktivitete:

- **Aktiviteti 1.1: Shpallja e thirrjes për përzgjedhjen e koncesionarëve**, me afat realizimi **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa bartës është **MMJPH**. Ky aktivitet është zbatuar në kontinuitet gjatë viteve të kaluara, por ende nuk është realizuar plotësisht, prandaj ka status **“në zhvillim e sipër”**. Respektivisht MMJPH informon se fokusi i aktiviteteve në sektorin e menaxhimit të mbeturinave vazhdon në drejtim të krijimit të një sistemi të integruar rajonal të menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me detyrimet e marra përmes kredisë së BERZH dhe projekteve IPA. Në zbatim janë: projekti për zhvillim korporativ dhe mbështetje institucionale (nga dhjetori 2024) dhe projekti për hartimin e studimit të fizibilitetit për rajonin e Vardarit dhe rajonin juglindor (nga korriku 2025), të cilat janë pjesë e projektit “Menaxhimi Rajonal i Mbeturinave”. Në kuadër të këtij projekti, në vitin 2025 është realizuar furnizimi me pajisje për mirëmbajtjen e deponisë rajonale në Rusino, si dhe furnizimi me automjete, kosha dhe kontejnerë për komunat e rajonit të pelagonisë/jugperëndimore për menaxhimin e mbeturinave, ndërsa aktualisht është në zhvillim e sipër procesi i dorëzimit të pajisjeve. Për rajonin lindor dhe verilindor, është realizuar projekt për forcimin e kapaciteteve të vetëqeverisjes lokale për zbatimin e sistemit rajonal të menaxhimit të mbeturinave (i financuar nga fondet IPA II), i cili ka përfunduar në dhjetor të vitit 2025. Gjithashtu, në proces është projekti për mbylljen e deponive jo standarde në rajonin lindor (i cili financuar nga mjetet e IPA II).
- **Aktiviteti 1.2: Miratimi i vendimeve për dhënien e koncesioneve për menaxhimin e mbeturinave**, me afat realizimi **gjysma e dytë e vitit 2022**, ndërsa bartës janë **NJVL-të**. Megjithëse zbatimi i këtij aktiviteti ka filluar vetëm në vitin 2024. Ashtu si në raportin e vitit 2024 edhe në raportin për vitin 2025 BNJVL përsëri thekson se nuk është institucion kompetent për realizimin e saj, duke iu referuar informacioneve nga mediat për hapat e ndërmarrë. Gjegjësisht, më 10 dhjetor 2025, në organizim të SALAR International dhe në bashkëpunim me MMJPH, katërmëdhjetë kryetarë komunash themeluan Bordin Ndërkomunal për Menaxhimin e Mbeturinave (BNMM) për rajonin jugperëndimor dhe atë të Pellagonisë. Bashkëpunim i cili vendoset me qëllim ushtrimin e përbashkët të kompetencave komunale dhe realizimin e interesave të përbashkëta. Veprimtaria vazhdon të vlerësohet si **“në zhvillim e sipër”** gjatë dy viteve të fundit.



Fotografia 29: Shkalla e përgjithshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 2 aktivitete të parashikuara në Strategjinë për sektorin e mjedisit jetësor, të dy aktivitetet janë në zhvillim e sipër.



Fotografia 30: Statusi i aktiviteteve sipas periudhës së vlerësimit

Për MMJPH është parashikuar një aktivitet që është në zhvillim e sipër;
Për NJVL-të është parashikuar një aktivitet që është në zhvillim e sipër.

13. SEKTORI I BUJQËSISË

Përshkrimi i sektorit

Në lidhje me sektorin e bujqësisë, në Strategji janë përcaktuar pesë probleme prioritare si vijon:

- 1) Ridefinimi i sistemit të shitjes së tokës bujqësore në pronësi shtetërore dhe vendosja e një mbikëqyrjeje efektive mbi destinimin e përdorimit të tokës dhe përmbushjen e kontratave për përdorimin e tokës bujqësore shtetërore;
- 2) Ndryshime të shpeshta të rregullativës dhe kritere të pasakta për dhënien e subvencioneve;
- 3) Numër i pamjaftueshëm i të punësuarve dhe edukimi i tyre, asistencë e pamjaftueshme për orientimin e qytetarëve, mungesë transparence në procedura;
- 4) Koncentrimi i kompetencave në krijimin e politikave, zbatimin e tyre dhe mbikëqyrjen në fushën e ushqimit;
- 5) Koncentrimi i kompetencave në krijimin e politikave, zbatimin e tyre dhe mbikëqyrjen në fushën e veterinarisë.

Për realizimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara për tejkalimin e problemit në sektorin e bujqësisë janë përgjegjëse institucionet në vijim:

- 1) Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (në tekstin e mëtejshëm: MBPEU),
- 2) MF,
- 3) KI,
- 4) Agjencia për Ushqim dhe Veterinari (në tekstin e mëtejshëm: AUV),
- 5) Agjencia për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në tekstin e mëtejshëm: AMFBZHR),
- 6) Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë (në tekstin e mëtejshëm: ANZHB), dhe
- 7) Inspektorati Shtetëror i Bujqësisë (në tekstin e mëtejshëm: ISHB).

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në sektorin përkatës

Në sektorin e Bujqësisë, për tejkalimin e pesë problemeve prioritare janë parashikuar 9 masa dhe 16 aktivitete, nga të cilat 15 aktivitete janë njëherëshe, ndërsa një aktivitet është përcaktuar në kontinuitet për periudhën 2021–2025, me ç'rast numri i përgjithshëm i aktiviteteve të vlerësuara për periudhën pesëvjeçare është 20. Bazuar në analizën e realizuar të raporteve vjetore, gjendja e realizimit të aktiviteteve është si vijon:

Problemi 1: Ripërcaktimi i sistemit për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore dhe mbikëqyrje efektive mbi destinimin e përdorimit të tokës, si dhe përmbushjen e kontratave për përdorimin e tokës bujqësore shtetërore								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Forcimi i mbikëqyrjes mbi përdorimin e dedikuar të tokës dhe realizimin e kontratave të qirasë për tokën bujqësore	1.1. Përcaktimi i procedurave të detajuara për ushtrimin e mbikëqyrjes mbi përdorimin sipas destinimit dhe realizimin e kontratave për dhënie me qira të tokës bujqësore.	MBPEU	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar
	1.2. Ndryshimi i Ligjit për përdorimin e tokës bujqësore në drejtim të përcaktimit të sanksioneve për shkeljet e konstatuara, veçanërisht për anëtarët e komisionit, për njësinë organizative për menaxhimin e tokës bujqësore dhe për inspektorët kompetentë që kryejnë mbikëqyrje të operatorëve ekonomikë që kanë tokë bujqësore nën koncesion.	MBPEU	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
2. Rishikimi i rregullave për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore	2.1. Rishikimi i metodologjisë për shitjen e tokës bujqësore shtetërore në përputhje me kushtet e tregut, bazuar në klasat e tokës bujqësore.	MBPEU	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
3. Formimi i një organi të pavarur të administratës shtetërore, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore.	3.1. Ndryshimi i statusit juridik të komisionit për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore në një organ të pavarur të administratës shtetërore, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes miratimit të një ligji.	MBPEU	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 2: Ndryshime të shpeshta të rregullativës, kritere të paqarta për dhënie e subvencioneve								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Krijimi i masave dhe politikave të reja mbështetëse, të bazuara në parime për ruajtjen e	1.1. Përcaktimi i procedurave të qarta dhe të detajuara për mënyrën e vendosjes së masave të reja, të cilat do të mundësojnë mbrojtjen e	MBPEU	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

mjedisit jetësor, futjen e praktikave të mira bujqësore dhe prodhimin e ushqimit të shëndetshëm dhe të sigurt, si dhe përcaktimin e niveleve ekonomiksht të arsyeshme të subvencioneve.	mjedisit jetësor dhe do të sjellin praktika të mira bujqësore, si dhe prodhimin e ushqimit të shëndetshëm dhe të sigurt.							
	1.2. Krijimi i çdo mase të shoqërohet me indikator suksesi, me qëllim të monitorimit të efekteve të mbështetjes financiare.	MBPEU	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar
2. Vendosja e matshmërisë së efekteve nga zbatimi i masave për mbështetje financiare në bujqësi.	2.1. Përcaktimi i një metodologjie me të cilën do të sigurohet që masat e subvencionimit të jenë në funksion të zhvillimit të bujqësisë, ndërsa shumata e subvencioneve të jenë ekonomiksht të arsyeshme dhe të stimulojnë prodhimin real.	MBPEU	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 3: Numër i pamjaftueshëm i të punësuarve dhe edukimi i tyre, asistencë e pamjaftueshme për orientimin e qytetarëve, si dhe mungesë transparence në procedura								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Forcimi i kapaciteteve njerëzore të institucioneve me qëllim informimin në kohë dhe transparent të përdoruesve potencialë me informacionet relevante për qasje më të lehtë në këto mjete dhe veprim të shpejtë ndaj kërkesave.	1.1. Forcimi i burimeve njerëzore me qëllim trajtimin në kohë të kërkesave për mbështetje financiare.	MF MBPEU AMFBZHR APZHB	Gjysma e parë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar
	1.2. Vendosja e kompetencës për paraqitjen e kërkesave për pagesa direkte (subvencione) te një organ i vetëm kompetent, për një procedurë të vazhdueshme aplikimi.	MF MBPEU AMFBZHR	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	1.3. Miratimi i një zgjidhjeje ligjore për krijimin e shërbimeve këshilluese për ofrimin e ndihmës për përdoruesit potencialë për përfitimin e mbështetjes financiare.	MBPEU AMFBZHR APZHB	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
2. Rritja e transparencës së procedurave dhe informimi i përdoruesve potencialë me informacionet relevante për qasje më të lehtë në këto mjete.	2.1. Të vendosen procedura për transparencë – informimi i përdoruesve potencialë për kushtet e përfitimit të mbështetjes financiare.	MBPEU AMFBZHR APZHB	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar	/	/
	2.2. Të realizohen trajnime për të punësuarit me qëllim përmirësimin e njohurive të tyre dhe rritjen e integritetit.	MBPEU AMFBZHR APZHB	Gjysma e dytë e vitit 2020 – në kontinuitet	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar

Problemi 4: Koncentrimi i kompetencave në hartimin e politikave (ligjeve dhe akteve nënligjore), zbatimin e politikave dhe ushtrimin e mbikëqyrjes në fushën e ushqimit								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Ndarja e kompetencave për hartimin e politikave, zbatimin e tyre dhe mbikëqyrjen.	1.1. Ndryshimi i paketës ligjore në fushën e ushqimit në drejtim të ndarjes së kompetencave për hartimin e politikave, zbatimin e tyre, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e procedurave për kundërvajtje në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, përmes Ligjit për sigurinë e ushqimit dhe Ligjit për sigurinë e ushqimit për kafshë.	MBPEU	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	E përealizuar
	1.2. Krijimi i një organi të posaçëm për shërbimin inspektues të ushqimit ose transferimi i inspektorëve në Inspektoratin Shtetëror të Bujqësisë.	MBPEU KI AUV ISHB	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	E përealizuar
Problemi 5: Koncentrimi i kompetencave në hartimin e politikave (ligjeve dhe akteve nënligjore), zbatimin e politikave dhe ushtrimin e mbikëqyrjes në fushën e veterinarisë								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Ndarja e kompetencave në tre segmente: hartimi i politikave, ushtrimi i kompetencave profesionale dhe kryerja e mbikëqyrjes.	1.1. Ndryshimi i paketës ligjore në drejtim të ndarjes së kompetencave për hartimin e politikave, zbatimin e tyre, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e procedurave për kundërvajtje në fushën e shëndetit veterinar; Ligji për shëndetin veterinar, Ligji për produktet medicinale veterinare, Ligji për nënprodukte me origjinë shtazore dhe Ligji për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve.	MBPEU	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	E përealizuar
	1.2. Krijimi i një organi të posaçëm për shërbimin inspektues të shëndetit veterinar, duke e ndarë atë nga organi që zbaton politikat në fushën e shëndetit veterinar në një inspektorat të veçantë, ose transferimi i inspektorëve në Inspektoratin Shtetëror të Bujqësisë.	MBPEU	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	E përealizuar

Problemi 1: Ridefinimi i sistemit të shitjes së tokës bujqësore në pronësi shtetërore dhe mbikëqyrja efektive e destinimit të përdorimit të tokës dhe përmbushjes së kontratave për përdorimin e tokës bujqësore shtetërore, përmban tre masa me katër aktivitete.

Masa 1: Forcimi i mbikëqyrjes mbi përdorimin e tokës sipas destinimit dhe realizimin e kontratave të qirasë së tokës bujqësore, përfshin aktivitetet në vijim:

- **Aktiviteti 1.1: Përcaktimi i procedurave të detajuara për ushtrimin e mbikëqyrjes mbi përdorimin sipas destinimit dhe realizimin e kontratave të qirasë së tokës bujqësore.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa është në kompetencë të MBPEU. Ndryshe nga vitet e mëparshme, ky aktivitet është **“realizuar”** në vitin 2025. Në faqen e internetit të MBPEU është publikuar një listë kontrolli (<https://diz.gov.mk/dokumenti/obrazci-tarifnici/>), e cila është përgatitur për nevojat e Inspektoratit Shtetëror të Bujqësisë dhe përdoret gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes ndaj shfrytëzuesve të tokës bujqësore shtetërore.
- **Aktiviteti 1.2: Ndryshimi i Ligjit për shfrytëzimin e tokës bujqësore në drejtim të përcaktimit të sanksioneve për shkeljet e konstatuara, veçanërisht për anëtarët e komisionit, njësinë organizative për menaxhimin e tokës bujqësore dhe inspektorët kompetentë që ushtrojnë mbikëqyrje ndaj operatorëve ekonomikë që kanë tokë bujqësore me koncesion.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa është në kompetencë të MBPEU. Ky aktivitet ka mbetur **“i porealizuar”** gjatë gjithë periudhës raportuese, pasi ende nuk janë parashikuar sanksione për anëtarët e Komisionit apo sektorin për menaxhimin e tokës bujqësore.

Masa 2: Rishikimi i rregullave për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore përfshin **Aktivitetin 2.1: Rishikimi i metodologjisë për shitjen e tokës bujqësore shtetërore në përputhje me kushtet e tregut, bazuar në klasat e tokës bujqësore.** Këtë aktivitet, MBPEU si institucion përgjegjës, duhej të realizonte në **gjysmën e parë të vitit 2021**. I njëjti ka mbetur **“i porealizuar”** gjatë gjithë periudhës raportuese, pasi nuk janë bërë ndryshime në Ligjin për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore.

Masa 3: Formimi i një organi të pavarur të administratës shtetërore, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore, parashikon **Aktivitetin 3.1: Ndryshimin e statusit juridik të Komisionit për shitjen e tokës bujqësore shtetërore në një organ të pavarur të administratës shtetërore të themeluar nga Kuvendi përmes miratimit të një ligji** për të cilin afati i realizimit të këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa institucioni përgjegjës është MBPEU. Ky aktivitet ka mbetur **“i porealizuar”** gjatë gjithë periudhës raportuese, pasi nuk është bërë ndryshim në statusin juridik të Komisionit për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore.

Problemi 2: Ndryshimet e shpeshta të rregullativës dhe kriteret e pasakta për dhënien e subvencioneve përmban dy masa me tre aktivitete.

Për Masën 1: Krijimi i masave dhe politikave të reja të mbështetjes të bazuara në parimet e ruajtjes së mjedisit, zbatimit të praktikave të mira bujqësore dhe prodhimit të ushqimit të shëndetshëm dhe të sigurt, si dhe në nivele ekonomikisht të arsyeshme të subvencioneve, janë parashikuar dy aktivitete:

- **Aktiviteti 1.1: Përcaktimi i procedurave të qarta dhe të detajuara për mënyrën e vendosjes së masave të reja, me të cilat do të sigurohet mbrojtja e mjedisit dhe do të promovohen praktikat e mira bujqësore dhe prodhimi i ushqimit të shëndetshëm dhe**

të sigurt. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa është në kompetencë të MBPEU. Statusi përfundimtar i aktivitetit është **“i realizuar”**. Sipas raportit të dorëzuar për vitin 2025, MBPEU ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për periudhën 2021–2027 (<https://faolex.fao.org/docs/pdf/mac209144.pdf>), në të cilën, në Pjesën II – Objektivat, llojet e ndërhyrjeve të politikave dhe masat për periudhën 2021–2027, përfshihen edhe politikat për menaxhimin e burimeve natyrore dhe zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

- **Aktiviteti 1.2: Çdo masë të shoqërohet me indikatorë suksesi për monitorimin e efekteve të mbështetjes financiare.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa është në kompetencë të MBPEU. Statusi përfundimtar i aktivitetit është **“i realizuar”** me miratimin e Strategjisë Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për periudhën 2021–2027, në të cilën janë parashikuar indikatorë suksesi për monitorimin e efekteve të mbështetjes financiare.

Masa 2: Vendosja e matshmërisë së efekteve nga zbatimi i masave të mbështetjes financiare në bujqësi parashikon **Aktivitetin 2.1: Përcaktimin e një metodologjie me të cilën do të sigurohet që masat e subvencionimit të jenë në funksion të zhvillimit të bujqësisë, ndërsa shumat e subvencioneve të jenë ekonomikisht të arsyeshme dhe të stimulojnë prodhimin real.** Afati për këtë aktivitet është **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa institucion përgjegjës është MBPEU. Megjithëse MBPEU raporton se aktiviteti është realizuar, nga raporti i dorëzuar rezulton se nuk është përcaktuar një metodologji e tillë që të sigurojë që masat e subvencionimit të jenë në funksion të zhvillimit të bujqësisë dhe që shumat e subvencioneve të jenë ekonomikisht të arsyeshme dhe stimuluese për prodhimin real. Për këtë arsye, aktiviteti konsiderohet **“i parealizuar”** gjatë gjithë periudhës raportuese.

Problemi 3: Numri i pamjaftueshëm i të punësuarve dhe edukimi i tyre, asistenca e pamjaftueshme për orientimin e qytetarëve dhe mungesa e transparencës në procedura, përmban dy masa me pesë aktivitete.

Masa 1: Forcimi i kapaciteteve njerëzore të institucioneve me qëllim informimin në kohë dhe transparent të përdoruesve potencialë me informacionet relevante për qasje më të lehtë në këto mjete dhe trajtim në kohë të kërkesave, përfshin aktivitetet në vijim:

- **Aktiviteti 1.1: Forcimi i burimeve njerëzore për trajtim në kohë të kërkesave për mbështetje financiare.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021**, dhe i njëjti është nën kompetencë të MF. Për dallim nga vitet e mëparshme kur ky aktivitet kishte status në zhvillim e sipër, e njëjta është **“realizuar”** në vitin 2025. Sipas raportit të dorëzuar në vitin 2025, numri i përgjithshëm i të punësuarve në AMFBZHR në tetor të vitit 2025 ka qenë 236 persona dhe në raport me muajin dhjetor të vitit 2024 është rritur me 17 persona.
- **Aktiviteti 1.2: Vendosja e kompetencës për dorëzimin e kërkesave për pagesa direkte (subvencione) te një organ i vetëm kompetent për procedurë të vazhdueshme aplikimi.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021**, dhe e njëjta është në kompetencë të MF. Ky aktivitet gjatë gjithë periudhës raportuese ka qenë **“i parealizuar”**. MF ka raportuar se gjatë vitit 2025 nuk është dorëzuar asnjë kërkesë për transferimin e të punësuarve nga MBPEU në AMFBRZH. Sipas raporteve të mëparshme dhe deri më tani shihet qartë se nuk janë transferuar punonjës nga MBPEU në AMFBRZH.
- **Aktiviteti 1.3: Miratimi i zgjidhjes ligjore për krijimin e shërbimeve këshilluese për ofrimin e ndihmës për përdoruesit potencialë për marrjen e mbështetjes**

financiare. Afati për realizimin e këtij aktiviteti është **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa institucioni përgjegjës është MBPEU. Ky aktivitet është “**realizuar**” në vitin 2024, me miratimin e Ligjit për sistemin këshilldhënës për bujqësinë dhe zhvillimin rural (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 263/23).


Masa 2: Rritja e transparencës së procedurave dhe informimi i përdoruesve potencialë me informacionet relevante për qasje më të lehtë në këto mjete përmban dy aktivitete:

- **Aktiviteti 2.1: Vendosja e procedurave për transparencë – informimi i përdoruesve potencialë për kushtet e dhënies së mbështetjes financiare.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **viti 2021**, ndërsa institucioni përgjegjës është MBPEU. Në vitet 2021 dhe 2022 ky aktivitet ka qenë i përcaktuar, ndërsa është “**realizuar**” në vitin 2023.
- **Aktiviteti 2.2: Zbatimi i trajnimeve për punonjësit për përmirësimin e njohurive të tyre dhe rritjen e integritetit.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **viti 2021 – në kontinuitet**, ndërsa institucioni përgjegjës është MBPEU. Ky aktivitet ka qenë i shënuar në zhvillim e sipër vetëm në vitin 2023, kur MBPEU ka raportuar se ka miratuar politikë të integritetit dhe plan vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni për vitin 2023, por nuk ka të dhëna për realizimin e trajnimeve konkrete për rritjen e njohurive dhe integritetit të punonjësve. Në vitet e tjera të periudhës raportuese, ky aktivitet është konsideruar “**i përcaktuar**”, pasi në Planin e trajnimeve të MBPEU nuk janë parashikuar trajnime të specializuara për integritet.

Për tejkalimin e **Problemit 4: Përqendrimi i kompetencave në krijimin e politikave (ligje dhe akte nënligjore)**, zbatimin e politikave dhe ushtrimin e mbikëqyrjes në fushën e ushqimit, në Planin e Veprimit të Strategjisë është parashikuar **Masa 1: Ndarja e kompetencave për krijimin e politikave, zbatimin e tyre dhe mbikëqyrjen**, për të cilën janë parashikuar: **Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i paketës ligjore në fushën e ushqimit në drejtim të ndarjes së kompetencave për krijimin e politikave, zbatimin e tyre, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e procedurave kundërvajtëse në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, përmes Ligjit për sigurinë e ushqimit dhe Ligjit për sigurinë e ushqimit për kafshë dhe Aktiviteti 1.2: Krijimi i një organi të veçantë për shërbimin inspektues të ushqimit ose transferimi i inspektorëve në Inspektoratin Shtetëror të Bujqësisë.** Afati për realizimin e të dy aktiviteteve ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa bartës është MBPEU. Këto aktivitete kanë status përfundimtar “**të përcaktuara**”. Në këtë rast është me rëndësi të theksohet se me ndryshimet dhe plotësimet e Strategjisë, të miratuara nga KSHPK në vitin 2023 dhe të dorëzuara në Kuvendin e RMV-së (por të pa miratuara), problemi 4 nga sektori bujqësi është hequr, ndërsa aktivitetet e lidhura me të janë vlerësuar si të panevojshëm.


Problemi 5: Koncentrimi i kompetencave në krijimin e politikave (ligje dhe akte nënligjore), zbatimin e politikave dhe ushtrimin e mbikëqyrjes në fushën e veterinarisë në sektorin e bujqësisë, parashikohet **Masa 1: Ndarja e kompetencave në tre segmente – krijimi i politikave, ushtrimi i kompetencave profesionale dhe mbikëqyrja**, e cila përfshin dy aktivitete: **Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i paketës ligjore në drejtim të ndarjes së kompetencave për krijimin e politikave, zbatimin e tyre, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e procedurave kundërvajtëse në fushën e shëndetit veterinar; Ligji për shëndetin veterinar, Ligji për produkte mjekësore veterinarë, Ligji për nënprodukte me origjinë shtazore dhe Ligji për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe Aktiviteti 1.2: Krijimi i një organi të veçantë për shërbimin inspektues në fushën e shëndetit veterinar, ndarë nga organi që zbaton politikën në këtë fushë, ose transferimi i inspektorëve në Inspektoratin Shtetëror të Bujqësisë.**

Afati për të dy aktivitetet ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa bartës është MBPEU. Këto aktivitete, ashtu si të mëparshmet, kanë status përfundimtar “**të parealizuara**”. Është me rëndësi të theksohet se me ndryshimet dhe plotësimet e Strategjisë, të miratuara nga KSHPK në vitin 2023 dhe të dorëzuara në Kuvendin e RMV-së (por të pa miratuara), problemi 5 në sektorin e bujqësisë është hequr, ndërsa aktivitetet e lidhura me të janë vlerësuar si të panevojshëm.




Fotografia 31: Shkalla e përgjithshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 20 aktivitete në Strategjinë për sektorin e Bujqësisë (është parashikuar që një aktivitet të zbatohet në kontinuitet për periudhën 2021–2025), 6 aktivitete janë realizuar (30%), 13 aktivitete janë të parealizuara (65%), ndërsa 1 aktivitet është në zhvillim e sipër (5%).



Fotografia 32: Statusi i aktiviteteve sipas periudhës së vlerësimit



Fotografia 33: Statusi i përgjithshëm i aktiviteteve sipas institucioneve

- Për MBPEU janë parashikuar 18 aktivitete, nga të cilat 5 janë realizuar, 12 janë të porealizuara, ndërsa 1 është në zhvillim e sipër.
- Për MF janë parashikuar 2 aktivitete, nga të cilat 1 është realizuar, ndërsa 1 është i porealizuar.

14. SEKTORI I SPORTIT

Përshkrimi i sektorit

Në lidhje me sektorin e sportit, në Strategji janë përcaktuar dy probleme prioritare si vijon:

- 1) Probleme në menaxhimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e objekteve sportive në pronësi të RMV-së dhe të objekteve sportive në pronësi të NJVL-ve;
- 2) Mungesë e mbikëqyrjes inspektuese në sport.

Për realizimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara për tejkalimin e problemeve në sektorin e sportit, përgjegjëse janë institucionet në vijim:

- 1) Agjencia për Rini dhe Sport (në tekstin e mëtejshëm: ARS),
- 2) Qeveria,
- 3) MD,
- 4) KSHPK dhe
- 5) NJVL

Shkalla e realizimit të aktiviteteve

Në sektorin e Sportit, për tejkalimin e dy problemeve prioritare janë parashikuar 6 masa dhe 15 aktivitete, nga të cilat 11 aktivitete janë njëherëshe, 3 aktivitete janë të përcaktuara për realizim në kontinuitet për periudhën 2021–2025, ndërsa 1 aktivitet është i përcaktuar në zhvillim e sipër për periudhën 2022–2025, me ç'rast numri i përgjithshëm i aktiviteteve të vlerësuara për periudhën pesëvjeçare është 30. Bazuar në analizën e realizuar të raporteve vjetore, gjendja e realizimit të aktiviteteve është si vijon:

Problemi 1: Menaxhim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e papërshtatshme e objekteve sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Miratimi i një strategjie për objektet sportive në pronësi shtetërore	1.1. Analiza e gjendjes së objekteve sportive në pronësi shtetërore	ARS Qeveria	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar
	1.2 Regjistrimi i objekteve sportive në pronësi shtetërore	ARS NJVL	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	1.3. Përgatitja e një strategjie për objektet sportive në pronësi shtetërore, e bazuar në analizën dhe inventarizimin, veçanërisht në aspekt të: kategorizimit, pronësisë, menaxhimit, disponimit, shfrytëzimit dhe decentralizimit.	ARS	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
2. Rregullimi i statusit juridik të objekteve sportive në pronësi shtetërore	2.1. Analiza e kontratave për shfrytëzimin e objekteve sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale (arsyeshmëria juridike dhe ekonomike, afatet, respektimi)	ARS NJVL	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	2.2. Marrja e mjeteve juridike për rregullimin e statusit juridik të objekteve sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale	ARS NJVL	Gjysma e dytë e vitit 2022 në kontinuitet	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	2.3. Zbatimi i mbikëqyrjes inspektuese në lidhje me shfrytëzimin e objekteve sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale	ARS NJVL	2021, Në kontinuitet	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E realizuar

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

3.Rregullimi ligjor i objekteve sportive	3.1. Miratimi i një ligji për objektet e sportit	MD	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	3.2. Miratimi i akteve nënligjore për: - Kategorizimin e objekteve - Rregulloren për përcaktimin e tarifës për shfrytëzimin e objekteve sportive	MD	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
4. Vendosja e një sistemi informativ për evidencën e objekteve sportive në pronësi shtetërore	4.1. Krijimi i një baze të të dhënave për objektet sportive në pronësi shtetërore (vendndodhja, kategoria, komuna, pronësia, sipërfaqja, viti i ndërtimit, përmbajtjet, struktura, etj.)	ARS	Gjysma e parë e vitit 2023	E pamaturuar	E pamaturuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
Problemi 2: Mungesë e mbikëqyrjes inspektuese në sport								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosja e një mbikëqyrjeje inspektuese të pavarur në sport dhe në objektet sportive	1.1. Analiza e gjendjes aktuale të mbikëqyrjes inspektuese në sektorin e sportit dhe në objektet sportive	ARS	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
	1.2. Ndryshime dhe plotësime të Ligjit për sportin në pjesën për mbikëqyrjen inspektuese	MD	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	1.3 Themelimi i Inspektoratit Shtetëror të Sportit	MD	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
2. Edukimi për integritet dhe etikë të federatave sportive, klubeve dhe administratës	2.1. Miratimi i një programi për trajnime dhe edukim për integritet dhe etikë për federatat sportive, klubet, administratën dhe punonjësit sportivë.	ARS NJVL	Gjysma e parë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	2.2. Zbatimi i trajnimeve, punëtorive, tryezave të rrumbullakëta dhe paraqitjeve publike në media për integritet dhe etikë.	ARS KSHPK	Në kontinuitet	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

	2.3. Hartimi i materialit propagandues për integritet dhe etikë në sport	ARS KSHPK	Në kontinuitet	E perealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E perealizuar	E perealizuar
--	--	--------------	----------------	----------------------	----------------------------	----------------------------	----------------------	----------------------

Problemi 1: Menaxhim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e papërshtatshme e objekteve sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të njërive të vetëqeverisjes lokale përmban 4 masa dhe 9 aktivitete.

Masa 1: Hartimi i një strategjie për objektet sportive në pronësi shtetërore përmban aktivitetet në vijim:

- **Aktiviteti 1.1: Analiza e gjendjes lidhur me objektet sportive në pronësi shtetërore.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, dhe i njëjti është në kompetencë të ARS (MS). Statusi përfundimtar i këtij aktiviteti është **“i porealizuar”**, ndërsa MS si arsye kryesore për mosrealizim ka theksuar mungesën e numrit të mjaftueshëm të burimeve njerëzore në sektorin për objektet sportive.
- **Aktiviteti 1.2: Regjistrimi i objekteve sportive në pronësi shtetërore.** Afati për realizim ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, dhe e njëjta është nën kompetencë të ARS (MS). Ky aktivitet ka status përfundimtar **“në zhvillim e sipër”**. MS thekson se në regjistrin ekzistues janë të evidentuara 1366 objekte sportive në RMV, 90% e komunave kanë dorëzuar të dhëna për objektet sportive në territorin e tyre, ndërsa 10% nuk kanë dorëzuar të dhëna pavarësisht kërkesave të dërguara. Gjithashtu, është formuar edhe një Komision nga Ministri i Sportit për realizimin e këtyre aktiviteteve.
- **Aktiviteti 1.3: Hartimi i Strategjisë për objektet sportive në pronësi shtetërore, bazuar në analizën dhe regjistrimin, veçanërisht në aspekt të kategorizimit, pronësisë, menaxhimit, përdorimit dhe decentralizimit.** Afati për realizim ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2022**, dhe e njëjta është në kompetencë të ARS (MS). Ky aktivitet ka mbetur **“i porealizuar”** gjatë gjithë periudhës raportuese.

Masa 2: Rregullimi i statusit juridik të objekteve sportive në pronësi të RMV-së dhe NJVL-të përfshin aktivitetet në vijim:

- **Aktiviteti 2.1: Analiza e kontratave për shfrytëzimin e objekteve sportive në pronësi të RMV-së dhe NJVL-të (arsyetimi ligjor dhe ekonomik, afatet, respektimi i tyre).** Afati për realizim ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, dhe e njëjta është në kompetencë të ARS (MS). Në tre vitet e para të periudhës raportuese ky aktivitet nuk është realizuar, ndërsa në vitet 2024 dhe 2025 është vlerësuar me status **“në zhvillim e sipër”**. MS raporton se është formuar një Komision nga Ministri i Sportit lidhur me kompetencat e Ndërmarrjes Publike për menaxhimin e objekteve sportive në pronësi shtetërore dhe objekteve që janë nën juridiksionin e saj.
- **Aktiviteti 2.2: Marrja e masave ligjore për rregullimin e statusit juridik të objekteve sportive në pronësi të RMV-së dhe NJVL-të.** Afati për realizim ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022 – në kontinuitet**, ndërsa është në kompetencë të ARS (MS). Në tre vitet e para të periudhës raportuese ky aktivitet nuk është realizuar, ndërsa në vitet 2024 dhe 2025 është vlerësuar si **“në zhvillim e sipër”**, pasi MS ka informuar se është formuar një grup pune me detyrë hartimin e një plani aksional për rregullimin e statusit juridik të objekteve sportive në pronësi të RMV-së dhe NJVL-të.
- **Aktiviteti 2.3: Kryerja e mbikëqyrjes inspektuese lidhur me shfrytëzimin e objekteve sportive në pronësi të RMV-së dhe NJVL-të.** Ky aktivitet është parashikuar të zbatohet nga viti 2021 në kontinuitet, ndërsa është në kompetencë të ARS (MS). Në vitet 2021, 2022 dhe 2024 ky aktivitet nuk është realizuar, në

vitin 2023 ka qenë “**në zhvillim e sipër**”, ndërsa sipas raportit të fundit për vitin 2025 është vlerësuar si “**i realizuar**”, me njoftimin se është kryer mbikëqyrje inspektuese e çrregullt në qendrën e skijimit “Kodra e Diellit”, për të cilën është përgatitur procesverbali nr. LI.14-188/4 i datës 24.02.2025.

Masa 3: Rregullimi ligjor i objekteve sportive përfshin aktivitetet në vijim: **Aktiviteti 3.1: Miratimi i Ligjit për objektet sportive.** **Aktiviteti 3.2: Miratimi i akteve nënligjore për kategorizimin e objekteve dhe Rregullores për përcaktimin e tarifës për përdorimin e objekteve sportive.** Afati për realizimin e të dy aktiviteteve ka qenë viti 2022, ndërsa institucioni përgjegjës në periudhat e mëparshme raportuese ishte MD, ndërsa nga viti 2024 është MS. Të dy aktivitetet kanë status “**të parealizuar**” gjatë gjithë periudhës raportuese.

Masa 4: Vendosja e një sistemi informativ për evidencën e objekteve sportive në pronësi shtetërore përfshin një aktivitet të vetëm: **Aktiviteti 4.1: Hartimi i një baze të dhënash për objektet sportive në pronësi shtetërore (vendndodhja, kategoria, komuna, pronësia, sipërfaqja, viti i ndërtimit, përmbajtja, struktura etj.).** Afati për realizim ka qenë **gjysma e parë e vitit 2023**, ndërsa është në kompetencë të **ARS (MS)**. Ky aktivitet ka status përfundimtar “**në zhvillim e sipër**”, ndërsa MS raporton se është përgatitur një bazë e të dhënave për objektet sportive në pronësi shtetërore, e cila duhet të përditësohet me të dhëna nga komunat që ende nuk kanë dorëzuar informacione për objektet sportive.

Problemin 2: Mungesa e mbikëqyrjes inspektuese në sport, Masa 1: Vendosja e një mbikëqyrjeje të pavarur inspektuese në sport dhe objektet sportive përfshin tre aktivitete:


- **Aktiviteti 1.1: Analiza e gjendjes aktuale të mbikëqyrjes inspektuese në sektorin e sportit dhe objektet sportive.** Afati për realizim ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021**, ndërsa është në kompetencë të **ARS (MS)**. Ky aktivitet është “**realizuar**” në vitin 2024. MS raporton se është përgatitur një analizë nga njësia për mbikëqyrje inspektuese, e cila përfshin: analizën e gjendjes aktuale të mbikëqyrjes inspektuese në sektorin e sportit dhe objektet sportive; funksionimin e shërbimit inspektues; kompetencat dhe kornizën ligjore; problemet me të cilat përballlet shërbimi inspektues – njësia për mbikëqyrje inspektuese në sport; si dhe rekomandimet dhe përfundimet.
- **Aktiviteti 1.2: Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për sportin në pjesën e mbikëqyrjes inspektuese.** Afati për realizim ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa institucioni përgjegjës në periudhat e mëparshme raportuese ishte MD, ndërsa nga viti 2024 është MS. Ky aktivitet ka status përfundimtar “**i parealizuar**”.
- **Aktiviteti 1.3: Krijimi i Inspektoratit Shtetëror për Sport.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2022**, ndërsa institucioni përgjegjës në periudhat e mëparshme raportuese ishte MD, ndërsa nga viti 2024 është MS. Ky aktivitet gjithashtu ka status përfundimtar “**i parealizuar**”, pasi Inspektorati Shtetëror për Sport nuk është krijuar.

Masa 2: Edukimi për integritet dhe etikë i federatave sportive, klubeve, administratës dhe punonjësve sportivë përfshin tre aktivitete:

- **Aktiviteti 2.1: Miratimi i programit për trajnime dhe edukim për integritet dhe etikë për federatat sportive, klubet, administratën dhe punonjësit sportivë.** Afati për realizim ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021**, ndërsa institucioni përgjegjës


është **ARS (MS)**. Statusi përfundimtar i këtij aktiviteti është **“i përealizuar”**, duke pasur parasysh faktin se treguesi i aktivitetit është “programi i miratuar për trajnime dhe edukim”, ndërsa për të pestin vit radhazi raportohet se një program i tillë është në përgatitje e sipër.

- **Aktiviteti 2.2: Zbatimi i trajnimeve, punëtorive, tryezave të rrumbullakëta dhe paraqitjeve publike mediatike për integritet dhe etikë.** Afati për realizim ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021**, ndërsa institucioni përgjegjës është **ARS (MS)**. Në vitin 2021 ky aktivitet ka qenë i përealizuar, në vitet 2022 dhe 2023 ka qenë “në zhvillim e sipër”, sepse në vitin 2023 është mbajtur një konferencë në Hotel Limak në Shkup, ku morën pjesë përfaqësues të mediave sportive, sportistë, punonjës sportivë, federata sportive dhe shoqëria akademike. KSHPK vlerëson se ky aktivitet duhet të realizohet mbi bazën e një programi të miratuar për integritet dhe etikë, i cili nuk është miratuar nga ARS gjatë gjithë periudhës raportuese. Për këtë arsye, në vitet 2024 dhe 2025 aktiviteti është konsideruar **“i përealizuar”**.
- **Aktiviteti 2.3: Përgatitja e materialeve propaganduese për integritet dhe etikë në sport.** Afati për realizim ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021**, ndërsa institucioni përgjegjës është **ARS (MS)**. Në vitin 2021 ky aktivitet nuk është realizuar, në vitet 2022 dhe 2023 ka qenë “në zhvillim e sipër”, ndërsa në vitet 2024 dhe 2025 është vlerësuar si **“i përealizuar”**.



Fotografia 34: Shkalla e përgjithshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 15 aktivitete të parashikuara për këtë sektor, 11 aktivitete janë planifikuar të realizohen njëheri, 3 aktivitete janë planifikuar në kontinuitet për periudhën 2021–2025, ndërsa një aktivitet është parashikuar në kontinuitet për periudhën 2022–2025, që do të thotë se për periudhën e përmendur pesëvjeçare janë vlerësuar gjithsej 30 aktivitete. Nga këto, 2 aktivitete janë realizuar (7%), 18 aktivitete nuk janë realizuar (60%), ndërsa 10 aktivitete janë në zhvillim e sipër (33%).



Fotografia 35: Statusi i aktiviteteve sipas periudhës së vlerësimit

Nga viti 2024, për të gjitha aktivitetet në sektorin e sportit, institucioni përgjegjës është MS.

15. SEKTORI PËR EKONOMI DHE BIZNES

Përshkrimi i sektorit

Sa i përket sektorit ekonomi dhe biznes, në Strategji janë përcaktuar këto katër probleme prioritare:

- 1) Mungesa e regjistrimit të ndihmës shtetërore të dhënë për operatorët ekonomikë në pronësi të personave juridikë vendas dhe të huaj;
- 2) Dhënie e tepruar e koncesioneve, mungesë transparence në kontratat e koncesioneve dhe mekanizma të pamjaftueshëm për përcaktimin e tarifës reale të koncesionit për lëndët e para të shfrytëzuara;
- 3) Mungesa e regjistrave të pasurisë në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të njëjve të vetëqeverisjes lokale (NJVL);
- 4) Pjesëmarrje e pamjaftueshme e subjekteve të vogla ekonomike në procesin e hartimit të politikave ekonomike dhe politikave të tjera relevante për komunitetin e biznesit.

Për realizimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara për tejkalimin e problemeve në sektorin e ekonomisë dhe biznesit, përgjegjëse janë institucionet e mëposhtme:

- 1) Qeveria,
- 2) ME,
- 3) MMPH,
- 4) MBPEU,
- 5) MSH,
- 6) MSHIA,
- 7) MPB,
- 8) Agjencia për Kadastrën të Patundshmërive (në vijim: AKP),
- 9) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: KMK),
- 10) Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrësisë (në vijim: AMS),
- 11) Shoqëria civil dhe
- 12) Komuniteti i biznesit.

Shkalla e realizimit të aktiviteteve

Në sektorin e ekonomisë dhe biznesit, për tejkalimin e katër problemeve prioritare janë parashikuar 8 masa dhe 13 aktivitete, prej të cilave 8 aktivitete janë njëherëshe, 3 aktivitete janë të përcaktuara për zbatim në kontinuitet nga viti 2021 deri në 2025, ndërsa 2 aktivitete janë të përcaktuara për zbatim në kontinuitet nga viti 2022 deri në 2025, me ç'rast numri i përgjithshëm i aktiviteteve të vlerësuara për periudhën pesëvjeçare arrin në 31. Bazuar në analizën e kryer të raporteve vjetore, gjendja e realizimit të aktiviteteve është si vijon:

Problemi 1: Mungesa e një regjistri të ndihmës shtetërore të dhënë për operatorët ekonomikë në pronësi të personave juridikë vendas dhe të huaj								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Krijimi, publikimi dhe përditësimi i një regjistri me informacione për çdo formë të ndihmës shtetërore.	1.1. Përgatitja e një regjistri të ndihmës shtetërore në kuadër të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.	KMK	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 2: Dhënie e tepruar e koncesioneve, mungesë e transparencës në kontratat koncesionare dhe mekanizma të pamjaftueshëm të zhvilluar për përcaktimin e tarifës reale të koncesionit për lëndët e para të shfrytëzuara								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Optimizimi i shfrytëzimit të pasurive natyrore në drejtim të mbrojtjes së mjedisit.	1.1. Përgatitja e një studimi fizibiliteti për përcaktimin e gjendjes së shfrytëzimit të burimeve natyrore sipas fushave.	ME	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar
	1.2. Miratimi i politikave dhe masave në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të studimit të fizibilitetit.	ME Qeveria	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar
2. Rritja e transparencës në dhënie të koncesioneve.	2.1. Publikimi i kontratave të koncesioneve për shfrytëzimin e lëndëve të para.	ME MMPH MBPEU	Gjysma e dytë e vitit 2021– në kontinuitet	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar
3. Zhvillimi i mekanizmave për përcaktimin e nivelit dhe arkëtimin e tarifës reale të koncesionit për lëndët e para të shfrytëzuara.	3.1. Analiza dhe rishikimi i nivelit të shumës së tarifës koncesionare dhe i shkallës së arkëtimin të saj.	ME MMPH MBPEU	Gjysma e parë e vitit 2021– në kontinuitet	E realizuar	E realizuar	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar
	3.2. Zhvillimi i metodologjisë dhe mekanizmave për përcaktimin e një tarife reale koncesionare.	ME	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër
	4.1. Rritja e numrit të të punësuarve në shërbimet inspektuese.	ME MMPH	Gjysma e parë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

4. Rritja e kontrollit gjatë shfrytëzimit të lëndëve të para.	4.2. Zbatimi i trajnimeve për punonjësit e shërbimeve inspektuese kompetente.	MB	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 3: Mungesa e regjistrave për pasurinë në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të njëjve të vetëqeverisjes lokale.								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Krijimi i një evidencë të unifikuar të pasurive të paluajtshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.	1.1. Përditësimi i evidencës elektronike të pasurive të paluajtshme në pronësi shtetërore, si dhe të pasurive të paluajtshme në pronësi shtetërore që përdoren nga organet shtetërore dhe nga personat juridikë të themeluar nga shteti dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale.	AKP	Gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	1.2. Sigurimi i transparencës duke integruar një opsion për kërkim të hapur të pasurisë në pronësi shtetërore në portalin e shpërndarjes së Agjencisë për Kadastër të Pasurive të Paluajtshme (sipas EIB, emrit të organit shtetëror, llojit të pasurisë së paluajtshme dhe kritereve të tjera).	AKP	Gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
2. Krijimi i një regjistri publikisht të qashtëm për automjetet motorike në pronësi të institucioneve të sektorit publik dhe njëjve të vetëqeverisjes lokale (përveç automjeteve për qëllime të veçanta).	2.1 Regjistri ekzistues i automjeteve motorike që mbahet në MPB të përmirësohet me mundësinë që të dhënat të jenë publikisht të qashtë dhe të lehta për kërkim sipas institucioneve.	MPB	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër
Problemi 4: Përfshirje e pamjaftueshme e subjekteve të vogla ekonomike në procesin e krijimit të politikave ekonomike dhe politikave të tjera relevante për komunitetin e biznesit.								

*Raport përfundimtar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
2021–2025 për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2025*

Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Rritja e transparencës së procesit të krijimit të politikave ekonomike dhe politikave të tjera relevante për komunitetin e biznesit.	1.1. Ndryshimi i metodologjisë për vlerësimin e ndikimit të rregullativës (VNR) në drejtëm të publikimit më të detajuar të arsyeve për miratimin e një zgjidhjeje të caktuar ligjore, propozimeve kryesore që kanë qenë objekt shqyrtimi (dhe propozuesve të tyre), si dhe ndikimit të zgjidhjes së zgjedhur në klimën ekonomike dhe komunitetin e biznesit.	MSHIA	Gjysma e dyt e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	1.2. Zbatimi i trajnimeve, mentorimit dhe mbështetjes për mikro dhe ndërmarrjet e vogla për ndërtimin e qëndrimeve dhe veprimit të përbashkët lidhur me politikat që ndikojnë në klimën ekonomike dhe kushtet e funksionimit të tyre në vend.	APH Sektori civil Asociacionet e biznesit	Gjysma e parë e vitit 2022 – në kontinuitet	E pamaturuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar

Për tejkalimin e **Problemit 1: Mungesa e regjistrimit të ndihmës shtetërore të dhënë për operatorët ekonomikë në pronësi të personave juridikë vendas dhe të huaj**, është parashikuar një **Masë e vetme 1: krijimi, publikimi dhe përditësimi i një regjistrit me informacione për çdo formë të ndihmës shtetërore, me Aktivitetin 1.1: hartimi i regjistrit të ndihmës shtetërore në kuadër të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës**. Afati për realizimin e këtij aktiviteti është **gjysma e dytë e vitit 2022**, dhe e njëjta është në kompetencë të **KMK-së**. Ky aktivitet ka mbetur **“i parealizuar”** gjatë gjithë periudhës raportuese. Si arsye kryesore për mosrealizimin e aktivitetit, KMK-ja ka deklaruar mungesën e mjeteve financiare.

Problemi 2: Dhënia e tepruar e koncesioneve, mungesa e transparencës në kontratat e koncesioneve dhe mekanizmat e pamjaftueshëm për përcaktimin e tarifës reale të koncesionit për lëndët e para të shfrytëzuara. Masa 1: Optimizimi i shfrytëzimit të pasurive natyrore në drejtim të mbrojtjes së mjedisit, përfshin aktivitetet e mëposhtme:

- **Aktiviteti 1.1: Hartimi i një studimi fizibiliteti për përcaktimin e gjendjes së shfrytëzimit të burimeve natyrore sipas fushave.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, dhe i njëjti është në kompetencë të **MEMLP-së**, në përputhje me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e LOPOASH-së. Gjatë viteve të kaluara ky aktivitet nuk është realizuar, prandaj MEMLP raporton se aktiviteti është **“realizuar”** në vitin 2025 përmes përgatitjes së Strategjisë për kërkime gjeologjike dhe shfrytëzim të qëndrueshëm dhe shfrytëzim të mineraleve të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2025–2045, e cila gjatë vitit është dorëzuar dhe miratuar nga Qeveria.
- **Aktiviteti 1.2: Miratimi i politikave dhe masave në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve nga studimi i fizibilitetit.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2022**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të **MEMLP-së**, në përputhje me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e LOPOASH-së. Gjatë viteve të kaluara ky aktivitet nuk është realizuar, prandaj MEMLP raporton se aktiviteti është **“realizuar”** në vitin 2025 me Strategjinë e përgatitur për kërkime gjeologjike dhe shfrytëzim të qëndrueshëm dhe shfrytëzim të mineraleve të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2025–2045, në të cilën janë përcaktuar politikat dhe masat për gjendjen e shfrytëzimit të burimeve natyrore, përkatësisht ato janë të strukturuar në tri fusha prioritare (ekonomi, mjedis dhe social) përmes objektivave të përgjithshme dhe specifike, masave dhe aktivitetëve të përfshira në një plan veprimi me kornizë të qartë kohore për zbatimin e tyre.

plotësuar të prokurorëve publikë dhe zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme. Analiza e rreziqeve nga korrupsioni përbën një hap të rëndësishëm për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, për të siguruar efikasitet afatgjatë, nevojitet monitorim i vazhdueshëm i zbatimit të rezultateve dhe forcim i mëtejshëm i standardeve etike dhe të integritetit në praktikën e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Zbatimi i masave për forcimin e kapaciteteve dhe efikasitetit të prokurorëve publike tregon progres të pabarabartë. Ndërsa trajnimet për prokurorët e rinj publikë realizohen në mënyrë të vazhdueshme, pajisja me personel mbetet e kufizuar për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme buxhetore. Një hap pozitiv është krijimi i dy qendrave të reja hetimore, me çka rriten kapacitetet hetimore të prokurorëve. Vendosja e një sistemi të automatizuar për shpërndarjen dhe ndjekjen e lëndëve po përparon me mbështetjen e BE-së, por zbatimi i tij është vonuar, gjë që ndikon në aktivitetet e mëtejshme, si trajnimi i stafit. Përgatitja e Projektligjit për Avokaturën Shtetërore përbën një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës në punën e institucionit, si dhe drejt rregullimit më të mirë të kompetencave dhe organizimit të tij. Megjithatë, duke qenë se teksti i projektligjit ende ndodhet në fazë shqyrtimi brenda Ministrisë së Drejtësisë, nevojitet veprim i mëtejshëm institucional për finalizimin dhe miratimin e tij.

Në procesin e prioritizimit të fushave dhe sektorëve që do të përfshihen në Strategjinë e re Kombëtare 2026–2030, KSHPK konstatoi se sektori i gjyqësorit do të mbetet në fokus edhe në periudhën e ardhshme pesëvjeçare, ku përveç rreziqeve të reja të identifikuara, janë marrë parasysh edhe rreziqet e korrupsionit që nuk u tejkaluan me Strategjinë.

Në sektorin e **Organeve për zbatimin e ligjit**, në lidhje me kompetencat diskrecionale të personave përgjegjës dhe mungesën e transparencës në punësime dhe avancime në MPB, vërehet një përparim i pjesshëm me miratimin e ndryshimeve të Ligjit për punët e brendshme në vitin 2022. Megjithatë, sa i përket transparencës përmes publikimit në faqen e internetit të MPB-së të akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, përveç vendeve të punës të përfshira me dispozita të veçanta ligjore, kjo masë mbetet e pabarabartë, pasi aktet e brendshme nuk janë harmonizuar me Ligjin për informacionet e klasifikuara. Kjo kufizon kontrollin publik dhe rrit rrezikun e klientelizmit, ndikimeve politike dhe keqpërdorimit të kompetencave diskrecionale. Zbatimi i masave për përmirësimin e sistemit të përcaktimit të përgjegjësisë profesionale në organet e zbatimit të ligjit tregon përparim të kufizuar dhe të pabarabartë. Njëkohësisht, procesi i forcimit të mekanizmave të integritetit dhe llogaridhënies të zyrtarët doganorë është në zhvillim të sipër, por ende nuk është përfunduar plotësisht. Kjo tregon se nevojiten përpjekje shtesë institucionale dhe koordinim më i mirë ndërmjet institucioneve kompetente për zbatimin e plotë të masave të parapara. Kompetencat e paqarta dhe të përputhura midis shërbimeve inspektuese e ulin efikasitetin e mbikëqyrjes inspektuese dhe krijojnë hapësirë për veprime të pa harmonizuara dhe/ose selektive. Edhe pse KI ka bërë një analizë fillestare, ndryshimet ligjore ende nuk janë miratuar, gjë që krijon boshllëqe ligjore, rrezik korrupsioni, përdorim joefikas të burimeve dhe pasiguri juridike për qytetarët dhe sektorin e biznesit. Veprimi subjektiv i inspektorëve vazhdon të përbëjë rrezik për integritetin e shërbimeve inspektuese. Edhe pse sipas raporteve aktiviteti për mbikëqyrje të vazhdueshme inspektuese nga Inspektorati Shtetëror Administrativ është shënuar si i realizuar, problemi me mbikëqyrjen e pamjaftueshëm të inspektimit funksional në vetëqeverisjen lokale mbetet i pazgjidhur. Përmbushja formale e mbikëqyrjes nuk nënkupton se shërbimet inspektuese lokale funksionojnë në mënyrë efikase. Ende ekzistojnë dobësi të rëndësishme sistematike në mbikëqyrjen inspektuese lokale, si numër i pamjaftueshëm dhe i pabarabartë i inspektorëve midis komunave, burime të kufizuara dhe përgatitje profesionale e pamjaftueshme e shërbimeve, si dhe rreziqe nga presionet lokale dhe ndikimi politik në punën e tyre. Për më tepër, mungon një analizë e detajuar e efektivitetit të mbikëqyrjes, pasi raportet zakonisht

konstatojnë vetëm realizimin e kontroleve, pa vlerësuar rezultatet e tyre, gjë që e ul efikasitetin e sistemit dhe rrit rrezikun e korrupsionit dhe zbatimit selektiv të ligjit. Edhe pse është miratuar Ligji i ri për sistemin e kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik, problemi i moszbatimit të rekomandimeve të revizionit mbetet. Dobësitë kryesore janë mungesa e përgjegjësisë së mjaftueshme të personave drejtues, transparenca e kufizuar në zbatimin e rekomandimeve, mosmiratimi i Ligjit të ri për revizionin shtetëror dhe mungesa e zbatimit të raporteve të revizionit, për shkak të së cilës problemet e identifikuara shpesh mbeten të pazgjidhura.

Në sektorin e **Shëndetësisë**, reformat për përmirësimin e ekonomisë shëndetësore dhe menaxhimit financiar në institucionet shëndetësore shënojnë përparim. Miratimi i rregulloreve të reja, metodologjive për formimin e çmimeve të shërbimeve shëndetësore dhe barnave, si dhe transformimi i transparencës së proceseve të shpërndarjes së mjeteve përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit të sistemit të planifikimit dhe kontrollit në sektorin shëndetësor. Aktivitetet specifike, si publikimi i buxheteve të institucioneve shëndetësore, vendosja e rregullave të reja për përcaktimin e çmimeve referente të barnave dhe miratimi i kriterëve të reja për përcaktimin e kompensimeve kontraktuale, janë tregues i qartë i suksesit të reformave. Megjithatë, një pjesë e aktiviteteve nuk është realizuar plotësisht, siç është krijimi i një organi të pavarur për shpërndarjen e buxhetit të Fondit për Sigurim Shëndetësor të RMV-së ose krijimi i një sektori për analizë në FSSHRMV, gjë që tregon mungesë kapacitetesh dhe probleme në sigurimin e personelit.

Sistemi për për zgjedhjen e barnave që mbulohen nga mjetet publike tregon përparim të caktuar, veçanërisht përmes përmirësimit të kornizës ligjore, përcaktimit të kriterëve për për zgjedhjen e barnave dhe vendosjes së metodologjisë për vlerësimin e teknologjive shëndetësore. Këto aktivitete kontribuojnë në rritjen e transparencës dhe në zbatimin më të mirë të mjekësisë së bazuar në prova. Megjithatë, mbeten sfida të caktuara, si vonesat në realizimin e aktiviteteve të planifikuara, mungesa e transparencës në disa procese dhe publikimi jo i plotë i listës së barnave që mbulohen nga fondet publike. Për më tepër, proceset që lidhen me barnat për sëmundje të rralla dhe barnat me pozicion monopoli në treg tregojnë nevojën për më shumë transparencë dhe zbatim të qëndrueshëm të rregullave të përcaktuara.

Procesi i donacioneve, studimeve klinike dhe projekteve në sektorin e shëndetësisë përballet me sfida të rëndësishme, veçanërisht në lidhje me rregullimin dhe transparencën. Akti nënligjor për specifikimin e kushteve për pranimin e donacioneve në institucionet publike shëndetësore ende nuk është miratuar, gjë që tregon rregullim të pamjaftueshëm të këtij procesi. Njëkohësisht, regjistri publik i donacioneve është krijuar, por funksionon në mënyrë të kufizuar dhe nuk përditësohet rregullisht.

Nga aktivitetet dhe masat për rregullimin e praktikave joetike në marketingun e barnave vërehen disa përparime pozitive, por njëkohësisht identifikohen edhe mangësi të konsiderueshme. Miratimi i Kodit etik për marketingun e barnave është një hap i rëndësishëm në rregullimin e marrëdhënieve midis kompanive farmaceutike dhe punonjësve shëndetësorë. Megjithatë, është e nevojshme të nxitet rregullim i mëtejshëm i marketingut, me procedura dhe detyrime të përcaktuara qartë për të gjithë aktorët në sektor. Në të njëjtën kohë, krijimi i sistemeve si komitetet terapeutike dhe regjistrat spitalorë të barnave mbetet i parealizuar dhe nevojiten masa konkrete për zbatimin e tyre.

Për problemin e transparencës dhe objektivitetit në vendimmarrjen për trajtim jashtë vendit, masa për përcaktimin e spitaleve referente përmes kriterëve të qarta dhe aktit nënligjor ka

shënuar përparim të rëndësishëm në përpjekjet për të siguruar drejtësi dhe transparencë në proces. Me ndryshimin e akteve që përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen e spitaleve referente, është krijuar një bazë ligjore për vendimmarrje objektive në lidhje me trajtimin jashtë vendit. Megjithatë, duke marrë parasysh specifikën e procedurave për trajtim jashtë vendit dhe interesin publik që i shoqëron këto raste, është i nevojshëm monitorim i vazhdueshëm i zbatimit të kriterëve dhe përmirësimi i tyre në bazë të praktikës, si dhe rritje e transparencës dhe llogaridhënies së Fondit për Sigurim Shëndetësor.

Edhe ky sektor është gjithashtu objekt i trajtimit në Strategjinë e re Kombëtare 2026–2030, për shkak të nivelit të lartë të rreziqeve nga korrupsioni në të. Prandaj, rreziqet që nuk u adresuan me Strategjinë dhe që mbetën aktuale gjatë përgatitjes së analizës së vlerësimit të rreziqeve nga korrupsioni për nevojat e Strategjisë së re Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2026–2030, u përfshinë gjithashtu në Strategjinë e re Kombëtare.

Në sektorin e **Arsimit**, gjatë vitit 2025 është vërejtur përparim i dukshëm në normimin e disa proceseve, por problemet kryesore me ndikimin politik dhe kompetencat diskrecionale mbeten të pazgjidhura. Pozitive është se më në fund janë realizuar masat për forcimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit (rritje e buxhetit dhe punësime të reja), janë miratuar rregullore dhe akte nënligjore të reja për furnizimin me tekste shkollore dhe për mbledhjen e mjeteve nga prindërit (ekskursione, ushqime), është rritur ndjeshëm transparenca e ACAL përmes publikimit të qindra vendimeve, ndërsa universitetet kanë vendosur me sukses politika kundër korrupsionit. Nga ana tjetër, ka një ngecje serioze dhe shumëvjeçare në miratimin e ligjeve që duhet të parandalojnë parregullsitë në punësimin e mësimdhënësve dhe shkarkimin e parakohshëm të drejtorëve, mungesë të një mekanizmi efektiv për kontrollin e punës së inspektorëve, mungesë të rregullave për dhënien me qira të pronës shkollore, si dhe moszbatim të plotë të programeve për edukim mbi etikën dhe integritetin të stafit mësimdhënës për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Në kuadër të sektorit **Punë dhe Politikë Sociale**, vërehet përparim i pjesshëm në zbatimin e masave të planifikuara, ku shumica e aktiviteteve lidhur me vendosjen e kornizës ligjore dhe analizave janë realizuar, megjithëse me vonesa të konsiderueshme në raport me afatet e parashikuara. Janë miratuar me sukses ndryshimet në rregullativën ligjore për sigurimin social, Ligji për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara, si dhe analizat dhe ndryshimet e akteve nënligjore lidhur me Komisionin për revizion. Megjithatë, aktivitetet kyçe infrastrukturore dhe operative, si vendosja e plotë e sistemit të digjitalizuar qendror për sigurimin social dhe formimi i trupit për ekspertizë, janë ende në proces dhe finalizimi i tyre është shtyrë deri në vitin 2027. Vonesa më e madhe është evidentuar në forcimin e mbikëqyrjes, ku masat për hartimin e metodologjisë për kontrolle dhe zbatimin e rregullt të tyre nuk janë realizuar, ndërsa mbikëqyrja për të drejtat e ndihmës dhe kujdesit nga personi tjetër është realizuar vetëm në vitin 2025.

Në sektorin e **Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor**, gjatë vitit 2025 është miratuar Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 101/25), në të cilin është shtuar një dispozitë shtesë për shkakun e heqjes së licencave të lëshuara sipas këtij ligji. Me këtë ndryshim ligjor është vendosur një kontroll i përforcuar ex officio (të paktën dy herë në vit) nga ana e Ministrisë së Transportit, me qëllim kryerjen e kontrolleve të rregullta dhe jo vetëm në bazë të ankesave të paraqitura. Në bazë të këtij ndryshimi, Ministria e Transportit ka kryer një revizion të plotë të licencave të lëshuara dhe ka hequr 41 licenca për mbikëqyrje për shkak të parregullsive të konstatuara, gjë që mund të konsiderohet si një sinjal pozitiv për një qasje jo-selektive në luftimin e korrupsionit dhe veprimtarive të paligjshme në realizimin e ndërtimeve.

Duke marrë parasysh nivelin e lartë të rrezikut nga korrupsioni në këtë sektor, KSHPK, në procesin e prioritizimit të fushave dhe sektorëve që do të përfshihen në Strategjinë e re Kombëtare 2026–2030, ka përcaktuar nevojën që planifikimi hapësinor, planifikimi urbanistik dhe ndërtimtaria të përfshihen si një sektor i veçantë edhe në periudhën e ardhshme pesëvjeçare.

Në sektorin e **Mjedisit Jetësor**, për adresimin e problemit të mungesës së një sistemi të integruar rajonal për menaxhimin e mbeturinave është parashikuar masa për krijimin e qendrave rajonale të menaxhimit të mbeturinave, e cila përfshin dy aktivitete: shpalljen e konkursit për përzgjedhjen e koncesionarëve dhe marrjen e vendimeve për dhënien e koncesioneve për menaxhimin e mbeturinave. Në kuadër të të dy aktiviteteve janë ndërmarrë disa hapa, por nuk mund të konfirmohet se ato janë përmbyshur plotësisht. Pozitive është që Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale (NJVL) po realizojnë në mënyrë aktive hapat përgatitorë dhe infrastrukturorë të nevojshëm përmes projekteve të mbështetura nga BERZH dhe fondet IPA, si dhe përmes formimit të bordeve ndërkomunale. Megjithatë, procesi thelbësor i përzgjedhjes së koncesionarëve që do të menaxhojnë qendrat rajonale ende nuk është realizuar, ndërsa një sfidë shtesë paraqet edhe transferimi i dukshëm i përgjegjësiwe midis institucioneve.

Duke pasur parasysh atë që u përmend më lartë, si dhe analizën e vlerësimit të rreziqeve nga korrupsioni, sipas parimit të prioritizimit të sektorëve me rrezik të lartë korrupsioni, KSHPK ka përcaktuar nevojën që sektori i Mjedisit Jetësor, Energjetikës dhe Lëndëve Natyrore të përfshihet edhe në Strategjinë e re Kombëtare 2026–2030.

Në sektorin e **Bujqësisë** mund të vërehet një tejkalim i pjesshëm i disa problemeve prioritare. Megjithatë, ndryshimet thelbësore sistematike kryesisht kanë stagnuar, ndërsa përparim është arritur në fushën e planifikimit strategjik dhe kapaciteteve administrative. Nga njëra anë, masat kyçe për antikorrupsion të lidhura me tokën bujqësore shtetërore, si vendosja e sanksioneve për keqpërdorime, rishikimi i metodologjisë së shitjes dhe krijimi i një organi të pavarur, mbeten të parealizuar plotësisht, me përjashtim të përcaktimit të procedurave të mbikëqyrjes. Gjithashtu, nuk është përcaktuar metodologjia për arsyeshmërinë ekonomike të subvencioneve, dhe mungojnë edhe trajnimet e parashikuara për integritetin e punonjësve. Nga ana tjetër, një hap pozitiv është miratimi i Strategjisë Kombëtare për Bujqësinë 2021–2027 (me të cilën janë përmbyshur aktivitetet për masa të reja dhe indikatorë suksesi), rritja e numrit të të punësuarve në AMFBZHR dhe miratimi i Ligjit për sistemin këshillues për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Edhe pse aktivitetet për adresimin e problemeve prioritare 4 dhe 5 formalisht trajtohen si “të parealizuar”, me ndryshimet dhe plotësimet e Strategjisë Kombëtare 2021–2025, të miratuara nga KSHPK në vitin 2023 dhe të dorëzuara në Kuvendin e RMV-së, por të pa miratuara, ato janë vlerësuar të panevojshme.

Në sektorin e Sportit vërehet një stagnim serioz dhe vonesa në zbatimin e Strategjisë, duke pasur parasysh se zgjidhjet kryesore sistematike, strategjike dhe ligjore mbeten të parealizuar edhe pas disa vitesh. Megjithatë janë bërë disa hapa pozitivë – si realizimi i analizës për mbikëqyrjen inspektuese, mbikëqyrja e parë e jashtzakonshme inspektuese e realizuar në vitin 2025, si dhe aktivitetet “në zhvillim e sipër” lidhur me regjistrimin dhe bazën e të dhënave për objektet sportive (ku të dhëna kanë dorëzuar 90% e komunave) – pjesa më e madhe e reformave thelbësore mbetet e bllokuar. Në veçanti, miratimi i kornizës së re ligjore (Ligji për sportin dhe Ligji për objektet sportive), krijimi i Strategjisë për objektet sportive, formimi i një Inspektorati Shtetëror të pavarur për sportin, si dhe miratimi i programit për edukim dhe integritet mbeten

të përealizuara, kryesisht për shkak të mungesës së burimeve njerëzore ose procedurave të zgjatura për ndryshime ligjore.

Në sektorin e **Ekonomisë dhe Biznesit** vërehet një përparim i dukshëm gjatë vitit 2025, veçanërisht në fushën e menaxhimit të burimeve minerale dhe koncesioneve, ku MEMLP ka realizuar me sukses aktivitete kyçe, si: miratimi i Strategjisë, vendosja e transparencës përmes publikimit të kontratave, miratimi i Tarifores së re për kompensimet e koncesioneve dhe rritja e numrit të inspektorëve. Përkundër kësaj, ngecje serioze vërehet në mjetet digjitale për transparencë sistematike. Regjistri për ndihmën shtetërore është plotësisht i përealizuar për shkak të pengesave financiare dhe koordinuese, ndërsa kërkimi i hapur i pronës shtetërore përmes Kadastrës Shtetërore nuk funksionon. Regjistri i automjeteve shtetërore është ende në fazën e prokurimit të softuerit. Për më tepër, edhe pse ka mbështetje të vazhdueshme për ndërmarrjet e vogla, ndryshimi thelbësor në Metodologjinë për Vlerësimin e Ndikimit të Rregullativës (VNR) mbetet i përealizuar.

Rreziqet e korrupsionit nga ky sektor të lidhura me mineralet dhe koncesionet janë përfshirë edhe në Strategjinë e re Kombëtare 2026–2030 në sektorin e Mjedisit Jetësor, Energjetikë dhe Burimeve Natyrore. Për tejkalimin e tyre janë parashikuar një numër i madh masash dhe aktiviteteve për periudhën e ardhshme pesëvjeçare.

Në sektorin e **Ndërmarrjeve Publike dhe Shoqërive Aksionare në pronësi të shtetit dhe vetëqeverisjes lokale** vërehet nivel shumë i ulët i zbatimit të masave të antikorrupsionit, ku reformat kyçe për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies zbatohen pjesërisht dhe ngadalë. Aktiviteti i vetëm i realizuar është përgatitja e programit për antikorrupsion nga KSHPK, por Qeveria ende nuk e ka miratuar atë, gjë që automatikisht e pamundëson zbatimin dhe monitorimin e tij. Për më tepër, masat thelbësore për vendosjen e transparencës janë të përealizuara ose devijojnë nga qëllimi fillestar i Strategjisë. Regjistri i personave juridikë ende nuk është krijuar (ndërsa projektligji i ri nuk parashikon të dhëna për pronësinë në të), ndërsa procesi për miratimin e një kornize të unifikuar ligjore është ende në zhvillim.

Në sektorin e **Mediave dhe Organizatave të Shoqërisë Civile** vërehet përparim pozitiv në përcaktimin e rregullave për mbështetje dhe vetërregullim, por mjetet kyçe për transparencën e financave publike në këta sektorë ende nuk janë finalizuar. Janë realizuar me sukses masat për përmirësimin e kritereve për ndihmën shtetërore të mediave të shkruara (përmes ndryshimeve të Ligjit për media në vitin 2024), si dhe shumica e aktiviteteve për vetërregullimin e mediave online, të vendosura me Rregulloren e re të ASHMAA-së nga qershori 2025 për regjistrimin e portaleve të internetit. Megjithatë, problemi sistematik i mungesës së transparencës në kontratat midis sektorit publik dhe mediave/agjencive të marketingut mbetet i pazgjidhur, pasi ndryshimet ligjore nuk janë realizuar, por janë pjesë e një procesi më të gjerë të harmonizimit me BE-në. Në mënyrë të ngjashme, krijimi i një baze të vetme të të dhënave për financimin e organizatave të shoqërisë civile mbetet i bllokuar në fazën “në proces”, pasi Ligji i ri për shoqatat dhe fondacionet është ende vetëm projekttekst i publikuar në RVKE.

19. REKOMANDIME

Fusha horizontale Prokurime publike

Duke pasur parasysh faktin se prokurimet publike mbeten një nga fushat horizontale në Strategjinë e re Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2026–2030, KSHPK vlerësoi të nevojshme që në këtë raport përfundimtar të jepen rekomandime vetëm për ato rreze të cilat, për shkak të prioritizimit, nuk janë përfshirë në Strategjinë e re pesëvjeçare, dhe që lidhen me zbatimin e qëndrueshëm të dispozitave të Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik në pjesën e publikimit të të dhënave të lidhura me prokurimet publike, si dhe shqyrtimin e mundësisë për përfshirjen e dispozitave kundërvajtëse që do të sanksiononin mos publikimin e të dhënave relevante për prokurimet publike. Gjithashtu, AQLI duhet të vendosë mekanizma më efikas për monitorimin e publikimit të informacioneve me karakter publik nga fusha e prokurimeve publike, me qëllim ndjekjen sistematike të publikimit dhe disponueshmërisë së informacionit, si dhe të forcohet sistemi i sanksioneve për institucionet që nuk i publikojnë me kohë të dhënat ose nuk i respektojnë obligimet ligjore.

Fusha horizontale Punësime

Duke pasur parasysh statusin përfundimtar të realizimit të aktiviteteve nga fusha horizontale Punësime deri në dhjetor 2025, KSHPK vlerësoi të nevojshme të japë rekomandime për realizimin e aktiviteteve që nuk janë realizuar ose kanë mbetur në proces, e veçanërisht:

- MAP të shqyrtojë mundësinë për ndryshime shtesë në Ligjin për punonjësit në sektorin publik, me qëllim përcaktimin e qartë të kushteve nën të cilat mund të kryhet transformimi i marrëdhënies së punës nga me afat të caktuar në të pacaktuar.
- MAP të bëjë ndryshime përkatëse në aktet nënligjore, me të cilat lloji i arsimit të lartë për vendet konkrete të punës do të përcaktohet në mënyrë më të qartë, me qëllim uljen e mundësisë së interpretimit arbitrar gjatë përcaktimit të kushteve të punësimit.
- MAP, në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Administrativ, të marrë rol më aktiv në gjetjen e një mekanizmi për mbikëqyrje të dispozitave të Ligjit për punonjësit në sektorin publik që kanë të bëjnë me publikimin e analizës funksionale dhe vlerësimin vjetor të vëllimit të punës në institucionet publike, duke vendosur sanksione për institucionet që nuk i respektojnë këto detyrime.
- AQLI të intensifikojë monitorimin e publikimit të akteve për organizimin dhe sistematizimin, si dhe të informacioneve të lidhura me punësimet.
- Qeveria të sigurojë harmonizimin e plotë të statuteve të të gjitha ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi shtetërore me ndryshimet e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare.
- MEP të parashikojë dispozita kundërvajtëse për themeluesin në Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare në rastet e emërimit të vonuar të anëtarëve të organeve drejtuese ose zgjedhjes së paligjshme të personave udhëheqës.
- MEP të parashikojë ndryshime shtesë në Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare, me të cilat do të përcaktohet obligimi për definimin e qartë të llojit të arsimit dhe kompetencave profesionale për të gjitha pozicionet drejtuese dhe mbikëqyrëse, si dhe vendosjen e një procedure transparente për përzgjedhjen e tyre.

- MSH, MASH, MKT dhe MPSDR të përshpejtojnë aktivitetet për miratimin e akteve nënligjore me të cilat do të përcaktohen kriteret dhe procedurat të qarta, objektive dhe transparente për vlerësim në proceset e punësimit dhe avancimit.
- MAP duhet të zbatojë rekomandimet nga analiza e përgatitur nga KSHPK, me qëllim kufizimin e diskrecionit të personave përgjegjës në proceset e punësimit.

Duke pasur parasysh se për disa aktivitete të kësaj fushe institucionet e caktuara si bartëse në Planin e Veprimit të Strategjisë kanë raportuar se nuk kanë kompetencë ligjore për zbatimin e tyre, KSHPK rekomandon që Qeveria t'i marrë parasysh gjatë hartimit të politikave antikorrupsion, duke përfshirë institucionet përkatëse kompetente.

Sektori Sistemi politik

- Kuvendi të parashikojë ndryshime në Rregulloren e punës, me të cilat do të vendosen kriteret të qarta për përcaktimin e kompleksitetit dhe vëllimit të propozim-ligjeve dhe do të definohen kushtet nën të cilat është i justifikuar përdorimi i procedurës së shkurtuar. Njëkohësisht, për iniciativat ligjore të paraqitura në procedurë të shkurtuar duhet të përcaktohet obligimi për arsyetim të detajuar të shkaqeve për shkurtimin e procedurave, me qëllim sigurimin e transparencës më të madhe, llogaridhënies dhe mbrojtjes së interesit publik në procesin e miratimit të ligjeve.
- MSHA të miratojë një Metodologji të re për vlerësimin e ndikimit të rregullativës (VNR), e cila do të jetë e detyrueshme gjatë përgatitjes së të gjitha propozim-ligjeve dhe akteve nënligjore, me qëllim sigurimin e një vlerësimi gjithëpërfshirës dhe objektiv të efekteve të tyre. Metodologjia duhet të parashikojë edhe kontroll të detyrueshëm antikorrupsion të legjislacionit, si dhe një proces transparent vlerësimi që përfshin ekspertë relevantë dhe palë të interesuara.
- MSHA, përmes Akademisë për trajnime dhe zhvillim profesional të nëpunësve administrativë, të parashikojë trajnime për nëpunësit shtetërorë përgjegjës për përgatitjen e rregullativës.
- MSHA të vendosë një sistem për monitorim dhe raportim të rregullt për zbatimin e VNR-së, si dhe analizë të efekteve të zgjidhjeve ligjore të miratuara.
- MSHA të publikojë rezultatet e VNR-së dhe raportet nga konsultimet e realizuara, si dhe të sigurojë informata kthyes nga procesi i konsultimeve publike. Kjo do të kontribuojë në rritjen e besimit në institucione dhe do të sigurojë që zgjidhjet ligjore të bazohen në analiza të kujdesshme dhe gjithëpërfshirëse, duke mbrojtur interesin publik.
- MD të përshpejtojë procesin e miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, me të cilat do të parashikohen dispozita të qarta dhe efektive për sanksionimin e refuzimit për dorëzimin e deklaratës së gjendjes pasurore dhe interesave. Në kuadër të ndryshimeve ligjore duhet të vendosen mekanizma të saktë dhe të zbatueshëm për përcaktimin e përgjegjësisë dhe sanksioneve për personat që nuk e përmbushin këtë obligim ligjor. Gjithashtu, të forcohen mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit të përmbushjes së obligimeve, si dhe të zbatohen aktivitete për ngritjen e vetëdijes së zyrtarëve për rëndësinë e deklaratimit të pasurisë dhe interesave.
- KSHPK të sigurojë zbatim të qëndrueshëm të Ligjit për lobimin përmes trajnimeve dhe edukimeve për lobistët, personat e zgjedhur dhe të emëruar, si dhe nëpunësit, me qëllim zbatimin e saktë të dispozitave ligjore.

- Të vendosen mekanizma transparentë për raportimin e aktiviteteve të lobimit dhe të sigurohet monitorim i rregullt dhe revizione periodike të zbatimit të Ligjit për lobimin dhe efekteve të tij.
- Të forcohet bashkëpunimi midis institucioneve kompetente dhe trupave të pavarur për zbatimin e ligjit, me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit më të madh në proceset e lobimit.
- KSHPK të vazhdojë aktivitetet për ngritjen e vetëdijes të bartësit të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë, me theks të veçantë në edukimin për etikë dhe integritet. Gjithashtu, KSHPK, në bashkëpunim me institucionet relevante, të realizojë vlerësim të efekteve të trajnimeve dhe punëtorive të realizuara, me qëllim përcaktimin e ndikimit të tyre në zbatimin praktik të parimeve të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në procesin e qeverisjes dhe vendimmarrjes.
- Në Kodin Zgjedhor të rregullohet reklamimi në portalet e internetit gjatë fushatave zgjedhore, me qëllim sigurimin e transparencës më të madhe dhe rregullave të qarta për financimin.
- Të vendoset mekanizëm për monitorimin e përfaqësimit mediatik përmes portaleve të internetit.
- MD, në bashkëpunim me MTD, të zhvillojë konsultime me ekspertë relevantë për media dhe transformim digjital, si dhe debat publik para miratimit të zgjidhjeve të reja ligjore, me qëllim sigurimin e një procesi transparent dhe mbështetje më të gjerë për rregullimin e kësaj fushe.

Sektori i Gjyqësorit

Duke pasur parasysh faktin se sektori i Gjyqësorit mbetet një nga sektorët kyç në Strategjinë e re Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2026–2030, KSHPK vlerësoi të nevojshme që në këtë raport përfundimtar të jepen rekomandime vetëm për ato rreziqe të cilat, për shkak të prioritizimit, nuk janë përfshirë në Strategjinë e re pesëvjeçare dhe që lidhen me procesin e miratimit të Ligjit të ri për Avokaturën Shtetërore, me qëllim përmirësimin e efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës në punën e institucionit, si dhe rregullimin më të mirë të kompetencave dhe organizimit të tij.

Sektori Organe për zbatimin e ligjit

Duke pasur parasysh statusin përfundimtar të realizimit të aktiviteteve nga ky sektor deri në dhjetor të vitit 2025, KSHPK vlerësoi të nevojshme të japë rekomandime për realizimin e aktiviteteve që nuk janë realizuar ose kanë mbetur në proces, në përputhje me Ligjin e ri për Punët e Brendshme të miratuar në vitin 2025, dhe veçanërisht:

- MPB, në bashkëpunim me organet kompetente për informacionet e klasifikuara, të përfundojë procesin e deklasifikimit të akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.
- MPB të publikojë rregullisht të gjitha dokumentet dhe vendimet lidhur me punësimet dhe avancimet, si dhe të sigurojë mekanizma për qasje publike në to.
- MF të përshpejtojë procesin e miratimit të ndryshimeve në Ligjin për policinë financiare, me të cilat do të sigurohet formimi i një departamenti për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale, si dhe harmonizimi adekuat i akteve të brendshme.

- MPB të finalizojë harmonizimin e akteve të brendshme me Strategjinë për procedurat disiplinore 2020–2022, duke vendosur mekanizëm për mbikëqyrje të rregullt dhe llogaridhënie, përfshirë pjesëmarrjen e trupave të jashtëm dhe të pavarur.
- DD të hapë një proces debati profesional dhe institucional për nevojën e vendosjes së statusit të policisë gjyqësore në Sektorin për përgjegjësi profesionale në Drejtorinë Doganore (ndryshimi dhe plotësimi i Kodit të Procedurës Penale, neni 47 paragrafi 2), me qëllim balancimin e efikasitetit dhe mbikëqyrjes së jashtme.
- DD të shqyrtojë modele alternative për kontroll të brendshëm, të cilat do të mundësojnë pavarësi dhe kapacitet për veprim në rastet e korrupsionit të brendshëm, nëse ndryshimet në LPP nuk miratohen.
- Të finalizohet analiza e kompetencave ligjore të shërbimeve inspektuese dhe të identifikohen qartë të gjitha mbivendosjet dhe paqartësitë në kompetenca.
- Të vendoset koordinim midis ministrive përkatëse për ndryshimin e ligjeve relevante, me qëllim saktësimin e kompetencave dhe eliminimin e mbivendosjeve midis shërbimeve inspektuese.
- Të përmirësohet koordinimi midis shërbimeve inspektuese për zbatim më efikas të mbikëqyrjes inspektuese.
- MAP të përgatisë metodologji të posaçme për rreziqet e korrupsionit në shërbimet inspektuese, me kritere të qarta për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve në të gjitha inspektoratet.
- Të hartohet protokoll standard për veprimin e inspektorëve, i cili të publikohet në mënyrë që të parandalohet selektiviteti në mbikëqyrje.
- MF të vendosë sanksione të detyrueshme për personat drejtues që nuk zbatojnë rekomandimet e revizionit, përfshirë gjopa financiare, masa disiplinore ose ulje të buxhetit institucional.
- Raporti vjetor për zbatimin e rekomandimeve të revizionit të jetë publikisht i qasshëm në faqet e internetit të MF dhe ESHR-së.
- ESHR të krijojë një bazë të dhënash online për ndjekjen e statusit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit sipas institucioneve.
- MF të shqyrtojë nevojën për ndryshime dhe harmonizime shtesë të akteve nënligjore për auditimin e brendshëm, me qëllim forcimin e pavarësisë dhe autonomisë së tij, si dhe përcaktimin e mekanizmave për mbrojtjen e auditorëve të brendshëm nga ndikimet e jashtme.
- MF të forcojë kapacitetet e auditorëve të brendshëm përmes trajnimeve profesionale dhe zhvillimit të metodologjive të reja.
- MF të përcaktojë kritere të qarta për suksesin e auditimit të brendshëm, përfshirë numrin e rekomandimeve të zbatuara, shpejtësinë e zbatimit dhe ndikimin në përmirësimin e politikave publike dhe kontrollit financiar.

Duke pasur parasysh se një pjesë e madhe e aktiviteteve nga Plani i Veprimit të Strategjisë, të cilat lidhen me shërbimet inspektuese në nivel qendror dhe lokal, me zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese, si dhe me miratimin e Ligjit të ri për revizionin shtetëror, janë përfshirë edhe në Strategjinë e re Kombëtare 2026–2030, KSHPK në këtë raport nuk parashikon rekomandime për to.

Sektori i Shëndetësisë

Sektori i Shëndetësisë është një nga sektorët kyç në Strategjinë e re Kombëtare 2026–2030. Vlerësimi i rreziqeve nga korrupsioni në këtë sektor ka përfshirë edhe rreziqet që ishin objekt i Strategjisë për periudhën 2021–2025, të cilat deri në dhjetor 2025 nuk janë tejkaluar plotësisht. Në këtë drejtim, ky sektor gjatë periudhës së ardhshme pesëvjeçare do të jetë në fokus të kornizës strategjike të antikorrupsionit, ku janë përcaktuar 18 masa dhe 74 aktivitete për adresimin e problemeve prioritare, me qëllim krijimin e një sistemi shëndetësor të drejtë,

transparent, të përgjegjshëm dhe të ndërlidhur digjitalisht, të bazuar në integritet, profesionalizëm dhe besim, në të cilin burimet, vendimet dhe shërbimet janë të gjurmueshme, të menaxhuara në interes publik dhe në shërbim të qytetarëve, të mbështetura nga punonjësit shëndetësorë të përkushtuar dhe të vlerësuar.

Sektori i Arsimit

- MASH të miratojë Ligjin e ri për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë, duke vendosur kritere të rrepta dhe objektive për pikëzimin gjatë punësimit, si dhe ndryshime në Ligjin për inspektoratin arsimor për mbikëqyrje të detyrueshme dhe arsyetim gjatë shkarkimit të parakohshëm të drejtorëve.
- MASH dhe ISHA të operacionalizojnë mekanizmin për kontrollin e punës së inspektorëve (përmes zbatimit të plotë të aplikacionit E-inspektori dhe hartimit të listave kontrolluese), me qëllim parandalimin e sjelljeve korruptive në terren.
- Të sigurohen mjetet e nevojshme financiare për BZHA dhe QSHP që të fillojnë zbatimin e trajnimeve të parashikuara për etikë dhe integritet për drejtorët dhe mësimdhënësit, si dhe për përgatitjen e Udhëzuesit për parandalimin e korrupsionit.
- MASH të miratojë aktet nënligjore dhe udhëzimet për dhënien me qira të pasurisë së paluajtshme të institucioneve arsimore, me çrast do të mbyllet ky boshllëk i madh për korrupsion dhe pasurim të paligjshëm në nivel lokal.
- KSHPK të kryejë vlerësim antikorrupsion të Ligjit të ri për tekstet shkollore (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 3/25), për të verifikuar nëse procedurat e reja realisht eliminojnë rreziqet ekzistuese në furnizimin dhe përdorimin e materialeve arsimore.
- Qeveria të ndryshojë praktikën ekzistuese dhe gjatë emërimit ose shkarkimit të anëtarëve të bordeve në ACAL të publikojë detyrimisht arsyetim të detajuar për vendimin.

Sektori për Punë dhe Politikë Sociale

- MPSDR të intensifikojë aktivitetet për dizajnimin dhe implementimin e sistemit TIK të Regjistrimit për sigurim të detyrueshëm social, me qëllim parandalimin e vonësive të mëtejshme të afatit përfundimtar (2027).
- MPSDR të përshpejtojë procesin e formimit të Trupit Qendror Koordinues për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë sigurimin e stafit të nevojshëm dhe finalizimin e Metodologjisë së ekspertizës para hyrjes në fuqi të ligjit të ri.
- MPSDR të hartojë dhe miratojë Metodologjinë për zbatimin e kontrolleve të rregullta dhe ad hoc, pasi ajo është parakusht për mbikëqyrje efektive.
- MPSDR të sigurojë vazhdimësi në zbatimin e kontrolleve të rregullta dhe ad hoc (jo vetëm në bazë të parashtrësive).

- MPSDR, bazuar në shembullin pozitiv të vitit 2025, të sigurojë burimet e nevojshme (njerëzore dhe teknike) për Sektorin e mbikëqyrjes inspektuese, me qëllim zbatimin e vazhdueshëm të mbikëqyrjeve të jashtëzakonshme dhe kontrolluese.

Sektori për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Sektori për Planifikim Hapësinor, planifikim Urban dhe ndërtimtari është gjithashtu një nga sektorët kyç në Strategjinë e re Kombëtare 2026–2030. Vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit në këtë sektor ka përfshirë edhe rreziqet që ishin objekt i Strategjisë për periudhën 2021–2025 në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, të cilat deri në dhjetor 2025 nuk janë tejkaluar plotësisht. Në këtë drejtim, ky sektor gjatë periudhës së ardhshme pesëvjeçare do të jetë në fokus të kornizës strategjike për antikorrupsion, ku janë përcaktuar 13 masa dhe 33 aktivitete për adresimin e problemeve prioritare, me qëllim mbrojtjen e interesit publik në planifikimin hapësinor dhe urbanistik, si dhe respektimin e standardeve profesionale në të gjitha fazat e ndërtimit.

Sektori i Mjedisit Jetësor

Mjedisi jetësorë është pjesë e sektorit të Mjedisit Jetësor, energjetikë dhe resurse natyror në Strategjinë Kombëtare 2026–2030, në të cilin janë marrë plotësisht dhe janë përshtatur aktivitetet e përfshira nga Plani i Veprimit i Strategjisë për periudhën 2021–2025. Prandaj, KSHPK në këtë raport nuk parashikon rekomandime shtesë.

Sektori i Bujqësisë

- MBPEU të rinovojë iniciativën për ndryshim thelbësor të sistemit të shitjes së tokës bujqësore shtetërore, përmes një metodologjie të re të bazuar në kushtet e tregut dhe transformimit të statusit të Komisionit kompetent në një organ të pavarur, me ç'rast do të zvogëlohet ndikimi politik.
- MBPEU të hartojë metodologjinë për matjen e efekteve të subvencioneve, me qëllim parandalimin e shpërndarjes arbitrare të mjeteve dhe sigurimin që mbështetja financiare të rezultojë në rritje reale të prodhimit bujqësor.
- MF dhe MBPEU të realizojnë aktivitetin për transferimin e punonjësve dhe krijimin e një organi të vetëm kompetent për paraqitjen e kërkesave për subvencione, me ç'rast do të thjeshtohet procedura për fermerët dhe do të reduktohet hapësira për manipulime.
- MBPEU të rishikojë Planin e saj të trajnimeve dhe të përfshijë module të detyrueshme dhe të specializuara për njohjen dhe parandalimin e korrupsionit (integriteti) për të gjithë punonjësit që marrin pjesë në procedurat e ndarjes së tokës dhe subvencioneve.

Sektori i Sportit

- Qeveria të finalizojë procedurën për ndryshimin e Ligjit për Sportin, pasi mosmiratimi i tij përbën pengesë të drejtpërdrejtë për realizimin e një sërë aktiviteteve të tjera nga Strategjia, si miratimi i Ligjit për objektet sportive dhe akteve nënligjore, deri te formimi i Inspektoratit Shtetëror për Sport.
- Të përdoren mekanizmat ligjorë për të detyruar 10% e mbetur e komunave që të dorëzojnë të dhënat e nevojshme, me qëllim mbylljen përfundimtare të regjistrimit dhe

vënien e plotë në funksion të sistemit informativ për evidencën e të gjitha objekteve sportive.

- Të tejkalohet urgjentisht problemi i mungesës së burimeve njerëzore në sektorin për objektet sportive në MS (përmes rishpërndarjes së brendshme ose punësimeve të reja), në mënyrë që të mund të hartohet dhe miratohet Strategjia për objektet sportive në pronësi shtetërore.
- MS të vendosë një plan të vazhdueshëm për kontrolle inspektuese, për të parandaluar përdorimin e paligjshëm ose të papërshtatshëm të objekteve sportive shtetërore dhe komunale.
- MS të miratojë Programin për trajnim dhe edukim për integritet dhe etikë.

Sektori Biznes dhe Ekonomi

- Qeveria dhe MF të ndajnë mjete buxhetore dhe t'i ofrojnë mbështetje teknike KMK-së për krijimin përfundimtar të Regjistrit të ndihmës shtetërore, me qëllim parandalimin e ndarjes jo transparente dhe selektive të fondeve shtetërore.
- AKP të mundësojë kërkim të hapur të pronës shtetërore në portalin e saj, ndërsa Qeveria të obligojë të gjitha organet shtetërore që rregullisht të dorëzojnë vendimet për pronësinë, për të mbajtur të përditësuar bazën e të dhënave.
- MPB të përshpejtojë procedurën e tenderimit dhe implementimin e softuerit për Regjistrin e automjeteve në pronësi të sektorit publik, duke siguruar që ai të jetë i qasshëm publikisht dhe i lehtë për kërkim.
- Të rishikohet kompetenca për aktivitetin 4.2 (Problemi 2), me qëllim që trajnimet për kontrollin gjatë shfrytëzimit të lëndëve të para të realizohen nga institucioni përkatës.
- MEMLP të finalizojë procedurën për Ligjin e ri për minierat, me ç'rast do të mundësohet implementimi i plotë i Metodologjisë për tarifën reale të koncesionit.
- MAP të kalojë nga faza e planifikimit strategjik në hapa konkretë për ndryshimin e Metodologjisë për VNR (vlerësimin e ndikimit rregullator), për të siguruar që komuniteti i biznesit të ketë pasqyrë reale mbi ndikimin e ligjeve të reja në ekonomi. (kjo rekomandim është i përfshirë edhe në sektorin e sistemit politik).

Sektori i Ndërmarrjeve Publike dhe Shoqërive Aksionare në Pronësi të Shtetit

- Qeveria e RMV- së të sigurojë zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara me Programin për Antikorrupsion për ndërmarrjet në pronësi dominuese të shtetit dhe të njërive të vetëqeverisjes lokale (NJVL), pas harmonizimit paraprak të afateve për realizimin e tyre.
- MEP të sigurojë që Regjistri i ardhshëm i ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi të plotë ose të pjesshme të shtetit dhe NJVL-të të përmbajë informacione kyçe për pronësinë. Nëse të dhënat për pronësinë planifikohen të vendosen në një regjister tjetër, duhet të sigurohet ndërveprueshmëri interoperabiliteti midis bazave të të dhënave, në mënyrë që publiku dhe institucionet të kenë qasje të lehtë dhe të unifikuar në të dhënat e pronësisë.

Sektori Media dhe Shoqëri Civile

- MTD në kuadër të procesit të nisur për harmonizim me Aktin Evropian për Lirinë e Medias, si prioritet kryesor të vendosë detyrimin për publikimin e të gjitha kontratave të lidhura nga institucionet publike dhe NJVL-të me media dhe agjenci marketingu.
- ASHMAA të kryejë në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme verifikime nëse mediat online i përmbushin realisht kriteret lidhur me domenin e vet, transparencën e pronësisë, kushtet minimale të stafit, etj.
- Të përshejtohet procedura për miratimin e Ligjit të ri për shoqatat dhe fondacionet.
- Në pritje të miratimit të Ligjit të ri për shoqatat dhe fondacionet, të fillojnë aktivitetet përgatitore për dizajnin teknik të bazës së vetme të të dhënave për fondet e ndara për organizatat e shoqërisë civile, në mënyrë që ajo të jetë funksionale menjëherë pas hyrjes në fuqi të ligjit.
- SHGM dhe KEMM të vazhdojnë me përditësimin e rregullt të Regjistrisë të mediave online profesionale, duke përjashtuar subjektet që shkelin standardet etike dhe profesionale.